

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 414 • MAJ 2025



INTERESI I PËRGJITHSHËM SI BAZË
JURIDIKE ISLAME

SHENJTËRIA E PASURISË DHE
PACENUESHMËRIA E SAJ NË TË
DREJTËN ISLAME

TË DREJTAT E PUNËTORËVE NË MES TË
KONVENTAVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE
REALITETIT AKTUAL



Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës
në bashkëpunim me
Ministrinë e Çështjeve Islame të Arabisë Saudite
organizojnë:



GARAT NDËRKOMBËTARE TË KURANIT KERIM

Data: 1–5 maj 2025 | Vendi: Hotel Emerald, Prishtinë

Kategoritë e garës:

Memorizimi i tërë Kuranit (12–30 vjeç)

10 xhuza (12–30 vjeç)

5 xhuza (12–30 vjeç)

2 xhuza (12–30 vjeç)

Leximi nga pesë xhuza të njëpasnjëshëm (9–12 vjeç)

Aplikimet bëhen deri më 12 prill 2025, përmes e-mailit në:

info@bislame.net, me këto të dhëna:

Emri dhe mbiemri, certifikata e lindjes, foto (formati i pasaportës),
numër kontakti me WhatsApp, adresa e banimit.

KUJDES

1. Kategoria e zgjedhur (vetëm një)
2. Kandidatët e kategorisë së parë nuk duhet të kenë fituar më parë ndonjë garë ndërkombëtare të Kuranit.

Provimi vlerësues: Më 14 prill 2025 përmes telefonit (WhatsApp).
Vlerësimi përcakton pjesëmarrjen në garën ndërkombëtare.

Për informata shtesë:

info@bislame.net | +383 38 224 024 | +383 44 509 111

EDITORIAL

- 4 Krenaria me të kaluarën si alibi për dekadencën tonë

FETARE

- 5 Interesi i përgjithshëm si bazë juridike islame
Dr. Selatin Mehani
- 9 Ndikimi i hytbes dhe i vazit si medime të edukimit islam (1)
Muhamed Sytari
- 12 Dispozitat dhe rëndësia e xhumasë (2)
Lavdrim Hamja
- 17 Shenjtëria e pasurisë dhe pacenueshmëria e saj në të drejtën islame
Bashkim Aliu
- 21 Duaja (lutja) pas namazit nuk është risi
Ajet Aliu
- 24 Tefsiri në veprën e fikhut "Risala" të Imam Shafiut
Dr. Xhemaludin Latiq

FAMILJE & EDUKIM

- 27 E drejta e punësimit për gruan në mes të realitetit të hidhur dhe kornizës juridike islame
Nada Dosti
- 30 "Big Brother" - Shpërfaqja e një mentaliteti të shtypur rreth moralit, kombit dhe fesë së shqiptarëve
Arben Desku



KULTURË

- 32 Të drejtat e punëtorëve në mes të konventave të të drejtave të njeriut dhe realitetit aktual
Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi
- 38 Një ilahi shqip me grafi arabe në fletoren e babës hoxhë
Dr. Besir Neziri
- 42 Përfitimet shëndetësore të ulla sipas Kuranit dhe haditheve të Pejgamberit a.s.
Mr. Njomza Sadriu
- 45 "Në kërkim të identitetit - rrëfimi i jetës sime" – libri autobiografik i presidentit Anwar el Sadat
Nehat Islami
- 47 A mundet Islami ta balancojë etikën me progresin modern?
Alizaman D. Gamon, Mariam S. Tagoranao

HISTORI DHE CIVILIZIM

- 51 Memetika hajdute e poetit Branko Radičević
Nexhat Ibrahim

REPORTAZH

- 54 Vizita e reisit të Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës, dr. Husein ef. Kavazović në Kosovë



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare,
shkencore e kulturore
Nr. 414 • viti 38 • Maj 2025
• Dhul-Kade 1446
• Çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.

Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net

Shtypi:
"Printing Press", Prishtinë.



Krenaria me të kaluarën si alibi për dekadencën tonë

“Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhenete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh.”

(Et Teube, 100)

Në diskursin bashkëkohor të predikimit islam vërehet një ëndje e lartë për të zbardhur lavditë e së kaluarës sonë të ndritshme dhe për të rikthyer në memorie virtytet dhe arritjet që i realizuan brezat e parë të myslimanëve. Në parim kjo “tendencë” është e shëndoshë, sepse synohet mbajtja gjallë e aspiratës për të rimëkëmbur sërish një brez që frymon me Islamin dhe që bëhet shëmbëlltyrë për të tjerët edhe në vazhdim. Pa rikujtuar në formë të ripërtëritshme gjurmët e jetës së virtytshme të tyre, nuk mund ta gjejmë rrugën as ne sot drejt virtytshmërisë. Si mos të jetë kështu ku për brezin e parë dhe dy brezat vijues, gjejmë edhe citate të shumta në Kuran dhe hadithe që vënë theksin te superioriteti i tyre fetar e moral dhe merita që ata të mbesin shembuj tejhistorik. Allahu në Kuran na rrëfeu duke thënë: *“Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhenete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh.”* (Et Teube, 100).

Megjithatë, rikthimi i detajeve dhe virtyteve të jetës së tyre në diskursin dhe predikimin tonë sot, fshehtë brenda vetes edhe një lloj prirjeje për të gjetur një alibi për dekadencën tonë, sikur për të thënë se, nëse doni Islamin e vërtetë dhe praktikuesit e tij të denjë, ja ku i kemi ata breza të denjë që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë tonë. Në rregull, veçse të tjerët, nuk po kërkojnë prej nesh shembuj të njerëzve që para shumë shekujve ata kanë vdekur. Ata po hulumtojnë për praktikë shembullore sot dhe modele të gjalla aktuale, të cilat do të mund të përdorëshin çdo ditë si fanar ndriçues në rrugën e drejtë për secilin njeri.

Me dëshirën më të madhe, siç edhe e vërejmë gjithandej në ligjërimet tona, iu flasim njerëzve për sinqeritetin e Ebu Bekrit, trimërinë dhe drejtësinë e Umerit, diturinë e Ibën Mesudit (Zoti qoftë i kënaqur me ta), pastaj asketizmin e urtësitë e Hasan el Basriut, mendjemprehtësinë e shquar të Imam Ebu Hanifes, e më vonë edhe për heroizmat e rrallë të Salahuddin el Ejubit. Duke i rikujtuar të bëmat e tyre, sikur mbushim zbrazëtinë shpirtërore për krenarinë e munguar në epokën moderne. Ne nuk jemi, por ja i kishim ata!

Ata mbesin një dëshmi e gdhendur në analet e historisë, që rrëfejnë për një epokë të ndritshme për veten e tyre, por edhe për Islamin, andaj jo rastësisht gjëma e të bëmave të tyre kumbon edhe sot. Ndërsa brezi i sotshëm, pos krenarisë me paraardhësit, mbesin thjesht dëshmi e një brezi të ngatërruar me vetveten, që s’po arrijmë të bëhemi epiqendër magnetike që tërheq kureshtjen e një bote në ndryshim. E nga kjo perspektivë historike, shihet qartë se sa e gjatë ka qenë periudha në të cilën myslimanët ishin kontribuues të mëdhenj dhe pjesëmarrës aktivë, si në shkencë e politikë, ashtu edhe në historinë kulturore të njerëzimit dhe sa relativisht e shkurtër është periudha e prapambetjes sonë dhe humbjes së pozitës së shëmbëlltyrës.

Pra, sinqeriteti, devotshmëria, dituria, drejtësia e asketizmi i atyre brezave, na japin premisë të lartë për të qenë edhe ne trashëgimtarë të denjë të tyre, por nuk na bëjnë doemos shembullorë e njerëz të mirë.

Aq i spikatur është ajeti për ta përçarur këtë mesazh, ku Allahu ka thënë: *“Ai ishte një popull që shkoi, të cilit i takoi ajo që fitoi, e juve u takon ajo që fituat, prandaj ju nuk jeni përgjegjës për atë që ata vepruan.”* (El Bekare, 141). Pra, të bëmat dhe arritjet e tyre përbëjnë aset krenarie për ta, dhe te Zoti, ata, për ato veprat sigurisht se do të shpërblehen. Ndërsa veprat tona, na takojnë ne dhe ne për to do të “shpërblehemi”.

Brezat e fundit të myslimanëve rrezikojnë që kapitalin e grumbulluar të arritjeve dhe të bëmave të brezave të shkuar ta shpenzojnë me shpejtësi, për shkak të pafuqisë që të vazhdojnë kontributin në çdo kohë e vend dhe për shkak të braktisjes së pozicionit ndikues në shoqëri. Andaj, jo rastësisht njerëzit përherë e më shumë po bëjnë thirrje për ta shqyrtuar e rishikuar atë panoramën e ruajtur në memoriet e tyre për epokat tona të lavdishme. Kjo, nëse nuk ndryshojmë për të mirë, po që është një mëkat i madh i brezit tonë.

Mr. Driton Arifi

Interesi i përgjithshëm si bazë juridike islame

• Dr. Selatin Mehani

HYRJJE

Shumë prej dispozitave të Sheriatit janë të justifikuara me qëllimet dhe objektivat, të cilat janë të orientuara drejt sjelljes së dobisë për njerëzit dhe largimit të dëmeve nga ta. Për këtë arsye, marrja parasysh e interesit është thelbësore për legjislacionin islam, teksa konsiderimi i realizimit të tij është qëllim i Ligjvënësit.

Juristët dhe usulistët islamë i kanë kushtuar shumë rëndësi interesit të përgjithshëm dhe e kanë përdorur atë si një argument të rëndësishëm në shumicën e çështjeve juridike dhe fetare, veçanërisht kur ka të bëjë me interesin e popullit dhe jo të sundimtarëve. Në ditët e sotme, interesi i përgjithshëm është bërë pothuajse argumenti më i rëndësishëm fetar dhe juridik ndër të gjitha argumentet, dhe pasqyrohet në shumicën e çështjeve dhe gjykimeve.

KONCEPTI I INTERESIT TË PËRGJITHSHËM

Përkufizimi i interesit të përgjithshëm në aspektin gjuhësor dhe terminologjik

Fjala “maslaha” (مصلحة), të cilës i përgjigjet fjala shqipe “interes”, në arabisht vjen nga rrënja “s-l-h” (س-ل-ه), që nënkupton diçka të dobishme, të drejtë, apo që sjell përmirësim.¹ Pra “maslaha” do të thotë dobi, mirësi apo përfitim.

Në terminologjinë islame dhe juridike, “mendimi për interesin e përgjithshëm” i referohet çdo veprimi apo vendimi që nënkupton dobi për shoqërinë në tërësi, të ruajë nevojat thelbësore të jetës (si feja, jeta, mendja, pasuria dhe nderi) dhe të evitojë dëmet.

Në terminologjinë islame dhe juridike, “mendimi për interesin e përgjithshëm” i referohet çdo veprimi apo vendimi që nënkupton dobi për shoqërinë në tërësi, të ruajë nevojat thelbësore të jetës (si feja, jeta, mendja, pasuria dhe nderi) dhe të evitojë dëmet. Në këtë kuptim, interesi nënkupton kujdesin për të mirën e përgjithshme të njerëzve, si dhe largimin e dëmeve që mund t’u kanosen atyre.

Për këtë arsye, gjejmë që Imam Gazaliu e përkufizon interesin si: “Ruajtja e qëllimit të Ligjvënësit”² dhe thotë: “Qëllimi i Sheriatit në lidhje me krijesat është pesë: të ruajë për ta fenë, jetën, intelektin, pasardhësit (nderin) dhe pasurinë. Çdo gjë që i cenon këto baza konsiderohet si prishje (dëm), dhe shmangia e saj është interes (dobi).”³

Boshti i interesit të përgjithshëm realizohet përmes sjelljes së një dobie të vlefshme dhe të përgjithshme, ose përmes shmangies së një dëmi të përgjithshëm, të cilin Sheriati e konsideron si dëm – qoftë ai moral apo material, i kësaj bote apo i botës tjetër – për një shoqëri, një shtet, disa shtete apo për të gjithë njerëzit, secili sipas rastit të tij.

Vlen të theksohet se kuptimi i interesit të përgjithshëm, ashtu siç është i pranuar në Sheriat, përkon në thelb edhe me atë që gjendet në legjislacionet e hartuara nga njerëzit. Megjithatë, dallimi qëndron në përmasat dhe qëllimin e përfitimit: në ligjet njerëzore, dobia

kufizohet vetëm në jetën e kësaj bote dhe ka në qendër vetëm mirëqenien e shoqërisë. Ndërsa, sipas dijetarëve myslimanë, interesi i përgjithshëm ka një dimension më të gjerë – ai përfshin jo vetëm përfitimet e kësaj bote, por edhe ato të botës tjetër. Ky interes i lartë përfshinë fillimisht vetë individin që synon dobinë publike, dhe më pas shtrihet te të tjerët në shoqëri.

KARAKTERISTIKAT E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM NË SHERIAT

Interesi i përgjithshëm (المصلحة العامة) në Sheriat nuk është thjesht një parim abstrakt, por një kriter themelor që ndihmon në ndërtimin e dispozitave ligjore dhe orientimin e vendimeve në drejtim të drejtësisë dhe dobisë kolektive. Dijetarët kanë thënë: “Atje ku ndodhet interesi, ndodhet edhe ligji i Zotit, dhe atje ku ndodhet ligji i Zotit, ndodhet dobia e njerëzve.” Kjo është një nga karakteristikat më të mëdha të interesit të përgjithshëm që e dallon Sheriatin islam nga ligjet e tjera. Nga kjo ka lindur thënia e usulistëve: “Gjykimi i Sheriatit është i lidhur me interesin e përgjithshëm dhe largimin e dëmeve të përgjithshme; dhe nëse nuk ka interes të përgjithshëm ose dëm të përgjithshëm, merret parasysh interesi personal pa dëmtuar të tjerët.”⁴

Ky parim ka disa karakteristika që e veçojnë atë në mënyrë të qartë, dhe ndër më të rëndësishmet janë:

Gjithëpërfshirja dhe universaliteti – Interesi i përgjithshëm në Sheriat ka për qëllim të përfshijë të gjithë shoqërinë dhe jo vetëm individë të veçantë. Ai synon ruajtjen e të mirave bazë që i përkasin çdo njeriu, si feja, jeta, mendja, pasuria dhe nderi.

Lidhja me objektivat e Sheriatit (مقاصد الشريعة) – ‘Maslaha’ (dobia) është thellësisht e lidhur me objektivat dhe qëllimet themelore të Sheriatit. Ajo është në përputhje me ruajtjen e pesë nevojave themelore dhe çdo interes që kontribuon në këtë ruajtje konsiderohet i vlefshëm dhe legjitim.

Shtrirja në të dyja botët, në këtë dhe në botën e amshuar – Ndryshe nga konceptet laike të interesit të përgjithshëm që fokusohen vetëm në përfitimet materiale dhe të kësaj bote, Sheriati përtej kësaj njih edhe përfitimin shpirtëror dhe atë të botës tjetër si pjesë të interesit të përgjithshëm.

Përputhshmëria me tekstet dhe parimet fetare – Çdo interes nuk konsiderohet i vlefshëm nëse bie ndesh me tekstet e qarta të Kuranit dhe Sunetit. Pra, interesi duhet të jetë i pajtueshëm me udhëzimet hyjnore dhe jo në kundërshtim me to.

Dijetarët kanë thënë: “Atje ku ndodhet interesi, ndodhet edhe ligji i Zotit, dhe atje ku ndodhet ligji i Zotit, ndodhet dobia e njerëzve.”


Përcaktimi përmes dijes dhe ekspertizës – Vlerësimi i asaj që përbën interes të përgjithshëm nuk lihet në dorën e perceptimeve të ndryshueshme personale. Ai përcaktohet përmes dijetarëve të fushave përkatëse dhe me kujdes të veçantë ndaj kontekstit dhe pasojave.

Parandalimi i dëmit dhe përparësia e dobisë – Një nga tiparet kryesore të interesit të përgjithshëm është parimi: “Parandalimi i dëmit ka përparësi ndaj sjelljes së dobisë.” Kjo tregon se Sheriati e vendos shmangien e së keqes si një parakusht për sigurimin e të mirës.⁵

ARGUMENTET SHERIATIKE TË LEGJITIMITETIT TË PARIMIT INTERESI I PËRGJITHSHËM

Parimi interesi i përgjithshëm (الاستصلاح) është i ligjshëm dhe i bazuar në Kuran, Sunet, praktikën e sahabëve dhe në logjikën e qëllimeve të Sheriatit. Ai siguron fleksibilitet në legjislacion, duke ndihmuar shoqëritë myslimane të përballen me çështje bashkëkohore, për aq kohë sa nuk cenon parimet themelore të fesë.

Argumentet nga Kurani fisnik: Allahu i Madhërishëm thotë: “Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (Muhamed) veçse si



mëshirë për të gjitha botët.” (El Enbija, 107). Ky citat tregon se ‘mëshira dhe dobitë’ janë interes dhe kërkesë thelbësore nga qëllimet bazë të Sheriatit. Si rrjedhojë, çdo dispozitë që sjell të mirën, largon të keqen, lehtëson dhe ndihmon në realizimin e kësaj mëshire, është interes që duhet ruajtur.

Allahu po ashtu thotë: “Allahu dëshiron për ju lehtësimin dhe nuk dëshiron vështirësim për ju.” (El Bekare, 185). Kjo dëshmon se dëshira hyjnore për lehtësim dhe largimin e vështirësive është bazë për pranimin e çdo veprimi që ndihmon në arritjen e kësaj lehtësie për shoqërinë.

Argumentet nga Suneti i të Dërguarit a.s.: Thënia e të Dërguarit të Zotit a.s., ku thotë: “Nuk ka dëm dhe as kundër dëm.”⁶ Ky parim i përgjithshëm është themel në jurisprudencë dhe ndalon çdo veprim që sjell dëm, dhe ndalon në të njëjtën kohë që dëmi të kthehet me dëm, e shmangia e dëmit është interes siç u theksua në këtë punim.

ARGUMENTET NGA PRAKTIKA E SAHABËVE:

Mbledhja e Kuranit në një mus’haf – Pas vdekjes së të Dërguarit të Zotit dhe rënies dëshmore të shumë hafëzëve në beteja, Ebu Bekri r.a., vendosi të mbledhë Kuranin në një libër të vetëm, megjithëse kjo nuk ishte bërë në kohën e të Dërguarit. Ky veprim bazohej në ‘interesin publik për ruajtjen e shpalljes’.

Krijimi i regjistrave shtetërorë (divaneve) nga Omeri r.a. – Omeri r.a. krijoi një sistem të organizuar administrativ të quajtur divan, që ndihmonte në shpërndarjen e fondeve. Ky ishte një veprim i pastër i bazuar në interesin publik, pa precedent të drejtpërdrejtë nga i Dërguari i Zotit.

ARGUMENTET NGA LOGJIKA DHE QËLLIMET E PËRGJITHSHME TË SHERIATIT:

Sheriati islam synon mbrojtjen e pesë nevojave themelore (feja, jeta, mendja, pasardhësit dhe pasuria). Çdo mjet që ndihmon në ruajtjen e këtyre pesë qëllimeve është i pranueshëm, për aq kohë sa nuk bie ndesh me ndonjë tekst të qartë. Usulistët unanimisht pajtohen se Sheriati është ndërtuar mbi interesin e njerëzve në këtë botë dhe në tjetrën.

NDARJA E INTERESAVE TË PËRGJITHSHME NË SHERIATIN ISLAM

Sheriati islam e ka ndërtuar legjislacionin e tij mbi baza të forta të interesave të njerëzve, në përputhje me tekstet dhe objektivat e tij. Juristët myslimanë i kanë ndarë interesat e përgjithshme në disa ndarje:

Omeri r.a. krijoi një sistem të organizuar administrativ të quajtur divan, që ndihmonte në shpërndarjen e fondeve.

Së pari: Ndarja e interesave sipas rëndësisë së tyre në jetën e njerëzve.

Interesa të domosdoshëm (الضروريات) – Janë interesat pa të cilat nuk mund të qëndrojë jeta e njerëzve, dhe me mungesën e tyre prishet rendi, stabiliteti dhe përhapet shkatërrimi. Këto interesa përbëjnë pesë gjërat esenciale në jetë që duhen ruajtur dhe kultivuar, ato janë: feja, jeta, mendja (intelekti), pasardhësit dhe pasuria. Prandaj, janë ligjësuar vendimet e ndëshkimeve për të ruajtur fenë dhe jetën. Është ndaluar alkooli për të ruajtur mendjen, norma ndaj amoralitetit për të ruajtur pasardhësit, si dhe është ndaluar kamata për ruajtjen e pasurisë, etj.

2. Interesat e nevojshme (الحاجيات) – Janë interesat që lehtësojnë jetën dhe largojnë vështirësitë, por nuk arrijnë nivelin e domosdoshmërisë. Për këtë arsye janë ligjësuar lehtësimet gjatë udhëtimit si falja me shkurtime, etj.

3. Nevojat përmirësuese (التحسينيات) – Janë interesat që e zbukurojnë dhe e plotësojnë jetën dhe lidhen me etikën dhe estetikën, Për këtë arsye janë ligjësuar pastërtia personale dhe veshja, përdorimi i misvakut, etika në ushqim dhe në të folur, zbukurimi në ditët e xhumasë, etj.⁷

Së dyti: Ndarja e interesave sipas vlerësimit dhe konsideratës së Sheriatit.

Interesat e pranuar (المصلحة المعتبرة) – Janë ato interesa që Sheriati i ka pranuar me tekst të qartë ose përmes parimeve të përgjithshme. Si shembull përmendim ruajtjen e jetës duke bërë ndalimin e vrasjes dhe vendosjen e ndëshkimeve, ruajtja e pasurisë me ndalimin e vjedhjes, vendosja e drejtësisë përmes konsultimit dhe të drejtave të garantuara, etj.

2. Interesat e refuzuara (المصلحة الملقاة) – Janë ato që duken si të dobishme në pamje të parë, por Sheriati i ka refuzuar për shkak të kundërshtimit me ndonjë tekst ose parim të tij. Për shembull, kamataria, e cila ndonjëse mund të duket si përfitim, shkakton padrejtësi dhe pabarazi, etj.

3. Interesat e lira (المصلحة المرسلّة) – Janë ato për të cilat nuk ka tekst të drejtpërdrejtë që i pranon apo i ndalon, por përputhen me objektivat e Sheriatit dhe sjellin dobi reale. Për shembull, rregullimi i qarkullimit rrugor për të ruajtur jetën, dokumentimi elektronik i kontratave për të shmangur mosmarrëveshjet, ligje administrative që forcojnë drejtësinë dhe rregullin, etj.⁸

RËNDËSIA E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM NË JURISPRUDENCËN ISLAME

Parimi i interesit të përgjithshëm përbën një shtyllë themelore në jurisprudencën islame, duke ndihmuar në përshtatjen e dispozitave me realitetet bashkëkohore dhe mbrojtjen e

mirëqenies kolektive. Rëndësia e tij në jetën moderne veçohet në pikat në vijim:

Interesi i përgjithshëm luan një rol thelbësor në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave juridike kur tekstet e Sheriatit janë të përgjithshme ose nuk adresojnë drejtpërdrejt raste specifike. Ai i mundëson juristit të nxjerrë gjykime duke u bazuar në parime të gjera dhe të aplikohet në raste konkrete, duke ruajtur frymën dhe objektivat e Sheriatit.

Sipas jurisprudencës islame, vendimet politike dhe ligjore shpesh justifikohen me domosdoshmërinë e mbrojtjes së interesit publik. Ky koncept përdoret si bazë për të ndaluar apo lejuar veprime, varësisht nga rrethanat, me synimin për të shmangur dëmet e mundshme dhe për të promovuar të mirën e përgjithshme.

Jurisprudenca islame karakterizohet nga një fleksibilitet i lartë, i cili i mundëson “devijimin” nga rregullat e përgjithshme kur ekziston një interes i madh publik. Përdorimi i analogjisë (kijasi) dhe i istihsanit (preferimit juridik) janë mjete metodologjike që mbështesin vendimmarrjen ligjore të bazuar në interesa reale dhe konkrete. Ky parim është i dukshëm në raste ku jurisprudenca ka lejuar rregulla të reja për shkak të domosdoshmërisë shoqërore dhe nevojave urgjente, duke ruajtur ekuilibrin mes tekstualitetit dhe kontekstit.⁹

BALANCIMI MIDIS INTERESIT TË PËRGJITHSHËM DHE ATIJ PERSONAL NË SHERIAT

Kur dy ose më shumë interesa bien ndesh dhe nuk mund të realizohen njëkohësisht, është e domosdoshme të bëhet një vlerësim i kujdesshëm dhe një zgjedhje midis tyre. Ky proces përfshin dhënien përparësi njëres prej palëve ose arrijten e një kompromisi, duke ruajtur gjithmonë qëllimet dhe parimet e legjislacionit dhe të Ligjvënësit. Në rast se kjo është e pamundur, *duhet të vihet përparësi interesit të përgjithshëm mbi atë personal*. El Izz ibën Abdiselami lidhur me këtë ka thënë: “Kujdesi i Sheriatit për interesat e përgjithshëm është më i madh dhe më i theksuar sesa kujdesi i tij për interesant personale.”¹⁰ Por që kjo të realizohet duhet plotësuar disa kushte, ndër to:

Interesi personal nuk duhet të jetë më i fortë se ai i përgjithshëm, sidomos kur ai lidhet me nevoja të domosdoshme, ndërsa interesi i përgjithshëm përbën nevoja të tjera më pak urgjente.¹¹ Për shembull, shpronësimi për nevoja publike, gjegjësisht shkatërrimi i një shtëpie për ndërtimin e një stadiumi. Në këtë rast, realizimi i interesit të përgjithshëm do të shkaktonte humbjen e të domosdoshmëve dhe kjo bie ndesh me parimet e Sheriatit.

Interesi personal nuk duhet të jetë i ndaluar për arsye preventive. Nëse ky është rasti, atëherë parimi fetar thotë: “Ajo që është ndaluar për shkak të parandalimit, është e lejuar në rast nevoje.” Ose rregulli: “Dëmi më i vogël pranohet për të shmangur një dëm më të madh.” Ky parim siguron një rend të drejtë dhe të balancuar mes interesave të individëve

dhe shoqërisë, duke respektuar gjithashtu prioritetin e nevojave thelbësore mbi ato që janë më pak të rëndësishme.

Interesi personal nuk duhet të humbasë plotësisht, por mund të arrihet zëvendësimi ose rregullimi i tij. Në këtë rast, interesi i përgjithshëm ka përparësi, pasi interesi personal mund të realizohet në një periudhë tjetër kohore. Nëse ky interes është i domosdoshëm dhe i nevojshëm në një kohë të caktuar, atëherë interesi personal ka përparësi mbi atë kolektiv.¹²

PËRFUNDIMI

Nga shqyrtimi i çështjes së interesave të përgjithshme në jurisprudencën islame, rezulton se këto interesa zënë një pozicion qendror në ndërtimin e normave dhe vendimeve juridike. Jurisprudenca islame i jep përparësi interesit të përgjithshëm ndaj atij personal kur mes tyre ekziston një konflikt i pashmangshëm, duke u mbështetur në parime të mirë përcaktuara të balancimit ndërmjet dobisë së përgjithshme dhe dëmeve. Megjithatë, kjo përparësi nuk zbatohet në mënyrë absolute, por është e kushtëzuar me disa kritere themelore, ashtu që interesi personal të mos jetë më i rëndësishëm në shkallën e nevojës, që të mos ketë mundësi bashkëveprimi mes të dy interesave dhe që interesi personal të jetë i kompensueshëm.

- 1 Muhamed bin Ebi Bekër bin Abdilkadir er Rrazi, *Muhtar es Sihah*, (rec. Mahmud Hatir, Liban, Bejrut, 1995), lënda صلح.
- 2 Ebu Hamid Muhamed el Gazali, *El Mustasfa fi Ilm el Usul*, (rec. Muhamed Abduselam Abdul Shafi, Dar el Kutub el Ilmije, Bejrut, Liban), 1/344.
- 3 Po aty.
- 4 Ebu Ishak Ibrahim bin Musa esh Shatibi, *El Muvafekat*, (Dar bin Affan), 1/51.
- 5 Shih: Dr. Mustafa Ibrahim ez Zelmi, *El med'hal li diraseti esh Sheriati el Islamiye*, (bot. 6, Kurdistan, Irak, 2010), fq. 61.
- 6 Ebu Abdilah Muhamed bin Jezid el Kazvini, *Sunen Ibën Maxhe*, (rec. Shuajb Arnauti dhe të tjerë) nr. 2340, dhe të tjerë.
- 7 Shih: Ebu el Hasen Ali bin Muhamed el Amidi, *El Ihkam fi Usul el Ahkam*, (rec. Abdurrezak Afifi, bot. El Mekteb el Islami, Bejrut, Liban), 3/274-275. Shatibiu, *el-Muvafekat*, po aty, 2/17.
- 8 Shih: Er Rrazi, *El Mahsul*, po aty, 6/162. El Amidi, *El Ihkam fi Usul e Ahkam*, po aty, 4/161.
- 9 Shih: Alaudin bin Abdilaziz el Bezdevi, *Keshf el Esrar*, (rec. Abdullah Mahmud Muhamed, Dar el Kutub el Ilmije, Bejrut, Liban, 1997), 4/4. Shatibiu, *el-Muvafekat*, po aty, 10/282.
- 10 El Izz ibën Abdiselam, *Kavaid el Ahkam fi mesalih el Enam*, (rec. Taha Abdurreuf Sad, bot. Mektebet el Kulijati el Ez'herije, Kairo, 1991), 2/89.
- 11 Esh Shatibi, *El Muvafekat*, po aty, fq. 3/271.
- 12 Po aty, 3/57.

Ndikimi i hytbes dhe i vazit si mediume të edukimit islam (1)

• Muhamed Sytari

“Hytbeja (ligjërata) ka qenë mënyra thelbësore me ndihmën e së cilës i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., ka thirur në Islam gjatë qëndrimit të tij në Meke. Me kalimin e të Dërguarit të Allahut në Medinë, hytbeja fitoi dimensione të tjera, kurse diç më vonë u bë detyrë obligative (farz) në namazin e xhumasë, në bajrame dhe në kohën e haxhit.”¹

Në Fjalorin e Orientalizmave të poliglotit dhe eruditit të shquar shkodran Tahir beg Dizdari (1900-1972), lexojmë: “HYTBË –JA f. dhe hutbé; në Dibër hütbe: recitim i ndonji nga pjesët e Kuranit, me predk të posaçëm të



Në shtypin elitar të vitit 1928, lexojmë se: “Hytbe quhet këshilla, bindja, fjala që mbahet për të zgjuar popullin nga gjumi i harrimit dhe i errësirës.”

mbështetun në ajete dhe hadithe bashkë me lutje invokacioni që mban hoxha (hatibi) në të falunit e detyrueshëm të ditës së premte dhe në dy bajramet në xhami, maje minberit.”²

Në shtypin elitar të vitit 1928, lexojmë se: “Hytbe quhet këshilla, bindja, fjala që mbahet për të zgjuar popullin nga gjumi i harrimit dhe i errësirës.”³

Nga këtu duhet të theksohet se: “Ç’do njeri ka nevojë për këshillat e më të dijshtmit, për arsye se njerëzit qi përbajnë shoqërinë njerzore nuk janë në të njajten shkallë në pikpamje dijtunore”⁴, sikurse shkruan H. Ismet Dibra, në vitin e largët 1930.

Nga këndvështrimi i fesë, hytbeja e xhumasë mbetet përherë si tribunë e mendimit të pjekur e të veshur me urtësi, që ndërton dhe jep zgjidhje për të sotmen dhe të ardhmen e individit dhe shoqërisë islame. Është tribunë e përhapjes së vlerave të besimit dhe detajeve të fesë, që njeriu besimtar të mos ngelet larg burimeve të fesë, përtej angazhimeve të tij ditore. Nëpërmjet predikimeve të xhumasë, ai ka përherë një dritare të hapur, prej ku merr dritë besimi dhe zhvillon mendimin e tij, të ngritur mbi bazat e pastërtisë, ndershmërisë dhe dobisë për veten dhe tjetrin.

Nga këtu, vlen të theksohet se dijetarët tanë e kanë krahasuar namazin e xhumasë dhe

hytben e tij, me adhurimin e haxhit. Dr. Nedhir el Mektebi, dijetar dhe orator i shquar bashkëkohor nga Damasku, kur trajton pozitën dhe vendin që ka hytbeja e xhumasë, shkruan: “Namazi i xhumasë dhe haxhi janë dy shtylla të forta prej shtyllave të (predikimit) të Islamit, nëse zhduken, Islami sinjalizohet për rrezik. Kështu, hytbeja e xhumasë ka një rëndësi të veçantë dhe një ndikim të madh në përhapjen e Islamit dhe ngulitjen e parimeve të tij të larta në shpirtrat e myslimanëve, të cilët mbliidhen për të çdo javë. Ajo formon me ta një shfaqje të mrekullueshme prej formave të forcës së Islamit dhe palëkundshmërisë së fjalës së tij në jetë, njësoj si në rastin e haxhit. Detyrimi i xhumasë i tubon myslimanët në shtëpitë e Allahut në rang lokaliteti, fshati a lagjeje, ndërsa detyrimi i haxhit i tubon myslimanët në rang të botës islame, ku vijnë nga cepa të ndryshëm të tokës dhe mbliidhen në një kohë të caktuar, në një vend të caktuar, rreth një adhurimi, që e kryejnë në një formë të caktuar.”⁵

Më herët, në revistën “Zani i Naltë”, lexojmë se: “Predikimet gjithmonë kanë për qëllim që ndigjusve t’u nepet dritë, t’u lëvizin ndjenjat, t’u mbushet mendja e t’u shkoqiten nevojat shkullore tue preferue më të randësishmen mbi atë me randsië (kaddimul-ehem alal-muhim)... Per hytbet të zgjedhen teze të nalta e të shpjegohen në gjuhën popullore.”⁶

Dhe, si shembull ilustrues të hytbes me vlera që përhapin në masë frymën e ndërtimit, nxitjen për zgjim dhe thirrjet drejt lartësimin nëpërmjet kuptimit të fesë, do të sjellë disa mesazhe nga një hytbe e mbajtur në Shkodër, nga hafëz Sheuqet Boriçi (1884-1965), në vitin 1940. Fjala kryesore e hytbes është thirrja e hoxhës: “O njerëzit e Zotit...” dhe thelbi i saj është nxitja drejt punës, si mjet drejt jetesës me dinjitet e krenari. Ndër të tjera thotë: “Dhe, vetëm me anë përpjekje, mundimi dhe pune mund të plotësohet të ngrehunit e një ndërtese madhështore përparimi si edhe të nxjerrunit e thesarevet dhe të depozitimevet, të mshehuna në gjirin e dheut. Prà, kush nuk punon, nuk ep dobí dhe nuk áshit i dobishëm, dhe ai i cili nuk áasht i dobishëm, áshit më i ulët se shtaza e egër. Në qoftë se ka ndonji popull, të cilin e shtyn dhe e mpron Feja e tij mos me qëndruë statik në pikëpamje materjale, ai popull do t’ishin muslimanët, të cilët Feja e tyre i thërret për me i dhanë randësinë e duhur nevojave materjale, dhe i shtyn për me punuë për botën e tyre, me qëllim të plotësimit t’egzistencës së tyre

botnore, tue kërkue me formue me ‘ta një ideal, një shëmbëll për popujt e tjerë, qi rrojnë mbi faqe të tokës. Këtë gjà e vërtetojnë edhe disa prej versetevet të naltë kuranor...”⁷

Xhamia është një vend i rëndësishëm në jetën e myslimanit, është vendi ku ai kryesisht, realizon plotësimin e shtyllës kryesore të fesë së tij, namazin, të cilin e shoqëron me lutje, adhurime të ndryshme, sikurse merr dhe jep në një marrëdhënie të shkëlqyer të ndërtuar mbi bazat e paqes, harmonisë dhe vëllazërisë, me pjesëtarët e tjerë të komunitetit.

Që xhamia të ketë një funksion sa më të mirë dhe në mënyrë që ajo të shërbejë jo vetëm për kryerjen e namazit, por që të kthehet në një qendër të mirëfilltë edukuese me virtytet më të larta islame, shoqëruese e njeriut në jetën e tij,

siç ishte në kohën e të Dërguarit të Allahut a.s., duhet medoemos të ketë një prijës të aftë e të përkushtuar, të ditur e të urtë. Detyra e tij është që ta bëjë atë “pikënisje të jetës tonë, vendin e kërkimit të dashamirësisë ndaj njëritjetrit, vendin e studimit të çështjeve të jetës tonë, gjendjes tonë sociale, ekonomike dhe politike”⁸.

Vetëm në këtë mënyrë, kur xhamia jonë të ketë njeriun e standardeve të kërkuara, prijësin e aftë për të kuptuar realitetin dhe për të përvetësuar mënyrën e “përkthimit” të mësimave të fesë në jetën e përditshme të njerëzve, vetëm atëherë xhamia do të mund të jetë vendi më i rëndësishëm në jetën e një shoqërie, sikurse ishte.

“Detyra e predikuesve duhet të jetë: Me ndritsue mëndjen e popullit, me ia mësuem parimet e sakta të fesë e me i dhanë një edukatë qytetnore e shoqnore jo të bastardueme. Duhet me dijtë se shekulli i sotshëm e sidomos perjudha pas luftës botnore, i kanë dhanë shkak përhapjes të shumë sëmundjeve morale në botë dhe kanë pertrimë ndryshime fort paradoksale në mentalitetin botnuer. Kshtu sot per predikuesin bâhet më e vështirë detyra se tjera herë.”⁹ Këto fjalë janë shkruar në vitin 1930. Po sot, pas sa e sa dekadash dhe sa e sa zhvillimesh nga më paradoksale në botën islame dhe në mbarë njerëzimin?!

Për këtë, nuk ka pse të na vijë i habitshëm fakti se aktiviteti i parë shoqëror që ndërmori i Dërguari i Allahut a.s., kur erdhi në Medinë, ishte ndërtimi i xhamisë dhe ndërtimi i vendbanimit të tij ngjitur me të. Ajo u kthye në bërthamën e shoqërisë. Ajo ishte vendtakimi, vendorganizimi, vendedukimi,

Që xhamia të ketë një funksion sa më të mirë dhe në mënyrë që ajo të shërbejë jo vetëm për kryerjen e namazit, por që të kthehet në një qendër të mirëfilltë edukuese me virtytet më të larta islame, shoqëruese e njeriut në jetën e tij, siç ishte në kohën e të Dërguarit të Allahut a.s., duhet medoemos të ketë një prijës të aftë e të përkushtuar, të ditur e të urtë.



qendra kryesore, ku të gjithë kishin mendjen dhe zemrën; aty gjenin qetësinë e prehjen, aty diskutonin e aty merrnin zgjidhjen e krejt dilemave të jetës.

Nga viti 1992 e deri më sot, kam krijuar një përvojë në raport me ndikimin e hytbes dhe vazit si mediume të edukimit islam, për ç'ka dëshiroj të ndalem te disa stacione, që gjykoj se kanë një rëndësi të veçantë në misionin e predikuesve të xhamive tona.

1) Që hatibi i xhumasë të jetë sa më i suksesshëm në ligjërimin e tij, duhet pikësëpari ta konsiderojë veten shëmbëlltyrë para njerëzve dhe të mundohet që vepra e tij të mos bie ndesh me fjalën e thënë nga tribuna e të Dërguarit të Allahut a.s., ku ai ligjëron javë pas jave.

Është shumë e rëndësishme që të tjerët të mos zhgënjehen nga prijësi i tyre fetar, në këtë rast hatibi i xhumasë, a vaizi i xhamisë. Është shumë e rëndësishme që hatibi, si udhëzues fetar, t'i paraprijë xhematit të tij në veprimin e urdhëresave dhe në largimin nga ndalesat, me sa të ketë mundësi.

2) Hatibi nuk duhet të harrojë në asnjë moment seriozitetin e pozitës së tij, prej nga u flet njerëzve. Ai, nga minberi ku mban hytbenë e javës, zëvendëson Resulullahun a.s., të Dërguarin e Allahut. E, vetëm ky fakt mjafton për të dëshmuar peshën dhe përgjegjësinë e hytbes së xhumasë në raport me dëgjuesit e saj.

Në simbolikën e tij, minberi i jep kurajë të vazhdueshme hatibit për të kuptuar shekujt e mëparshëm, për të marrë prej tyre misionin e vendosmërisë dhe për të rrezatuar dritë dashurie për të Dërguarin a.s. dhe mesazhet e pranisë së tij ndritshme në këtë jetë.

3) Hatibi duhet të jetë mik i vazhdueshëm i librit dhe i tesbihëve njëkohësisht. Me të parin, duhet të ketë një marrëdhënie të pandarë, një "vird" ditor, me anën e të cilit shton dije dhe njohuri; mbetet realist e bashkëkohor; ndjek zhvillimet e kohës dhe pasuron bagazhin e tij kulturor, intelektual.

Nga këtu, predikuesi duhet të jetë përherë në kontakt me dijen, me leximin e hulumtimin, me zhvillimet shoqërore

dhe çdo detaj që lidhet me punën dhe misionin e tij. Këtu më vijnë ndër mend përfytyrimet e një teologu në optikën e një intelektual bashkëkohor shkodran, që shkruan: "Si e përfytyroj unë një teolog apo një intelektual mysliman? E shoh mes librave, ku më kryesori është Kurani i madhërishëm, si një interpretues e shpjegues i rëndësishëm i fjalës së Allahut xh.sh. e i haditheve të Pejgamberit Muhamed a.s.. E shoh si predikues të moralit të pastër islam, si përçues i dijes dhe i përparimit të shkencës, të artit, të kulturës. Një njeri i devotshëm që në tryezën e tij ka rreshtuar fjalorë shumë-gjuhësh. Tek ai shoh..."¹⁰

Me të dytin, tesbihët, duhet të ketë një takim të përditshëm, nën hijen e dhikrit, përmendjes së Allahut, sikurse urdhëron Kurani.

Nuk e imagjinoj një hatib (a prijës fetar) që nuk ulet për çdo ditë në virdin e tij, i drejtuar me zemër e mendje nga Krijuesi Fuqiplotë, duke kërkuar prej Tij e duke shpresuar në Të. E kur, të vijë nata e xhuma dhe dita që e pason, hatibi, më tepër se kurrë ka nevojë për t'u veçuar prej njerëzve në mihrabin e lutjes e përgjërimit, para duarve të Fuqiplotit, duke kërkuar mbarësi e sukses në udhëzimin e njerëzve.

4) Asnjëherë nuk duhet që hytbeja e xhumasë të konsiderohet si një referat a diskutim i rëndomtë, me anën e të cilit do të prezantohet para të tjerëve, jo. Hytbeja nuk është referat, as diskutim, as bisedë e çfarëdoshme. Është mesazh i urtë, që duhet të karikojë zemrën, të ndriçojë mendjen dhe të gjallërojë dinamikën e jetës, në një prezantim relativisht të shkurtër kohor. Asnjëherë nuk duhet që hytbeja e xhumasë të nënvlehtësohet e të konsiderohet si një përshëndetje e rëndomtë në një takim të zakonshëm, ku rëndësi ka plotësimi i një numri pjesëmarrësish dhe kryerja robotike e kushteve të saktësisë së aktivitetit nga pikëpamja e jashtme juridike.

- 1 Dr. Jusuf Ramiq, *Hutbe të zgjedhura të Muhamedit a.s.*, botimi i dytë, Stamboll, maj, 2003, f. 7.
- 2 Tahir N. Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, botimet AIITC dhe ISESCO, Tiranë, 2005, f. 405.
- 3 Z. H. Aliu, *Hytbe e xhumasë a ç'është Xhumaja?*, në revistën "Zani i Naltë", nr. 12, dhetuer, 1928, viti V, Shkodër, 1928, f. 702.
- 4 H. I. Dibra, *Predku e predikuesat*, në revistën "Zani i Naltë", nr. 4, marc, 1930, viti VI, Shkodër, 1930, f. 951.
- 5 Nedhir Mektebi, *Khasaisul-khutbeti vel-khatib*, botimi i pestë, Bejrut, 2007, f. 187-188.
- 6 H. Isa Domni, *Program mbi detyrat e Myderriz – Vaizave per predikime qi do t'apin neper Faltore*, në revistën "Zani i Naltë", nr. 6, kallnur, 1927, viti IV, Shkodër, 1927, f. 180-181.
- 7 H. Sheuqet, *Përmbi mundimin, përmbi punën*, në revistën "Kultura Islame", viti 1, fruer-mars, 1940-XVIII, (Muh.-Safer, 1358), nr. 6-7, f. 270-271.
- 8 Dr. Mahmud Akkam, *Sebilul-ma'rif*, botimi i parë, Haleb 1996, f. 161.
- 9 H. I. Dibra, *Predku e predikuesat*, në revistën "Zani i Naltë", nr. 4, marc, 1930, viti VI, Shkodër, 1930, f. 953-954.
- 10 Nuh Topçia, *Si e përfytyroj unë një teolog*, në gazetën e përmuajshme "Udhë Islame", viti i parë i botimit, nr. 3, f. 5, Shkodër, dhjetor, 2002.

Dispozitat dhe rëndësia e xhumasë (2)

DISPOZITA PLOTËSUESE RRETH XHUMASË

- Lavdrim Hamja

SUNETI PARA XHUMASË

Hanefitë¹ dhe shafitë² kanë thënë se suneti para xhumasë është sikurse suneti para namazit të drekës, në kohë dhe në numër rekatesh.

Malikitë kanë thënë se nuk është e pëlqyeshme për një njeri, i cili ndiqet nga të tjerët, si. p.sh, dijetari, të falë nafile pas ezanit të parë, por jo edhe përpara ezanit për atë që është ndenjur në xhami, e as për atë që është duke hyrë, nga frika se njerëzit e thjeshtë mendojnë se është i detyrueshëm. Pas ezanit të dytë, është e ndaluar (haram) të falet, kjo edhe për dijetarët apo prijësit.³

Hanbelitë kanë thënë se xhumaja nuk ka sunet përpara, por pëlqehet të falen katër rekate, si nafile në përgjithësi.⁴

Argumentet në të cilat mbështeten ata që mendojnë se përpara xhumasë ka sunet:

Transmetohet se Ibën Mesudi r.a. falte përpara xhumasë dhe pas saj, katër rekate.⁵ Ibën Abasi r.a. transmeton se: “Pejgamberi a.s. falte katër rekate përpara xhumasë, e nuk i ndante me asgjë mes tyre.”⁶ Këtë hadith, edhe pse dijetarët e kanë dobësuar, për të dëshmojnë hadithe të tjera të sakta.

Transmetohet se Ibën Omeri r.a., falej gjatë përpara xhumasë dhe pas saj falte dy rekate në shtëpinë e tij. Ai ka thënë se Pejgamberi a.s. bënte një gjë të tillë.⁷

Koha e namazit të xhumasë është koha e namazit të drekës, kështu që sunetet e saj janë si sunetet e drekës. Për këtë arsye, edhe Imam Buhariu, në Sahihun e tij ka vendosur kapitullin: “Namazi pas xhumasë dhe para saj”. Pastaj ka sjellë hadithin e Ibën Omerit r.a., se: “I Dërguari i Allahut a.s. falte përpara drekës dy rekate dhe pas saj dy rekate; pas akshamit dy rekate në shtëpinë e tij; pas jacisë dy rekate dhe pas xhumasë nuk falte, derisa të largohej dhe falte dy rekate.”⁸



Pra, Imam Buhariu r.h. e shikonte xhumanë sikurse drekën, megjithëse Ibën Omeri r.a. ka përmendur dy rekate pas xhumasë dhe nuk ka përmendur gjë përpara saj. Imam Buhariu ka qenë i mendimit se përpara xhumasë është ajo, që Ibën Omeri ka përmendur përpara drekës, prandaj ka thënë: “Namazi pas xhumasë dhe para saj”.

SUNETI PAS XHUMASË

Të katër medhhebet⁹ janë të mendimit se pas xhumasë ka sunet, e argumenti i tyre është hadithi i Pejgamberit a.s.: “Kur ndonjëri prej jush falë xhumanë, le të falë pas saj katër rekate.”¹⁰

Ibën Abasi r.a., transmeton se: “Pejgamberi a.s. falte pas xhumasë dy rekate në shtëpinë e tij.”¹¹

Shtëpia e tij ishte pjesë e xhamisë dhe se namazi aty ishte sikurse brenda xhamisë. Nëse mblidhen transmetimet, atëherë kuptohet se ai falte gjashtë rekate, katër plus dy.

Dispozita e faljes së tehiyetul-mesxhid (përsëritjes së xhamisë) teksa imami është në hytbe

Rreth kësaj dispozite, dijetarët e katër medhhebeve kanë mendime të ndryshme:

Shafitë dhe hanbelitë thonë se namazi tehiyetul-mesxhid (përsëritja e xhamisë) është sunet. Këtë e mbështesin në hadithin e transmetuar nga Xhabir ibën Abdilahu, i cili ka thënë se kur Sulejk el Gatafani shkoi për xhuma, ndërkohë që i Dërguari i Allahut a.s., po mbante hytben, Sulejku u ul. Pejgamberi a.s., i tha: “O Sulejk, ngrihu dhe fal dy rekate, por mos i zgjatë shumë.” Pastaj tha: “Nëse ndonjëri prej jush vjen për xhuma, ndërkohë që imami po mban hytben, le t’i falë dy rekate namaz, por të mos i zgjatë shumë.”¹²

Hanefitë dhe malikitë thonë se nëse dikush hyn në xhami, ndërkohë që imami po mban hytben, atëherë ai nuk duhet të falë dy rekate tehiyetul-mesxhid. Madje, kjo gjë është e papëlqyeshme. Ky mendim është transmetuar nga Aliu, Ibën Umeri, Ibën Abasi r.a. dhe nga sahabët dhe tabiinët.

Hanefitë dhe malikitë e mbështesin mendimin e tyre në argumentet e mëposhtme:

Nëse dikush hyn në xhami, ndërkohë që imami po mban hytben, atëherë ai nuk duhet të falë dy rekate tehiyetul-mesxhid. Madje, kjo gjë është e papëlqyeshme. Ky mendim është transmetuar nga Aliu, Ibën Umeri, Ibën Abasi r.a. dhe nga sahabët dhe tabiinët.

Ajeti kuranor: “E kur të lexohet Kurani, atëherë dëgjojeni me vëmendje dhe heshtni, në mënyrë që të mëshiroheni.” (El Araf, 204).

Hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejra r.a., i cili ka thënë se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Nëse teksa imami është duke mbajtur hytben, ti i thua shokut tënd që e ke pranë, hesht, atëherë ke folur kot.”¹³

Në hadithin e transmetuar nga Abdullah ibën Busri, i cili ka thënë: “Erdhi një njeri ditën e xhuma dhe kaloi mbi kokat e njerëzve, ndërkohë që Pejgamberi a.s., mbante hytben. Pejgamberi a.s., i tha: “Ulu (zë vend), sepse lëndove.”¹⁴

Në hadithin e transmetuar nga Ibën Umeri r.a., se e ka dëgjuar Pejgamberin a.s., duke thënë: “Nëse ndonjëri prej jush hyn në xhami teksa imami po mban hytben në minber, atëherë nuk ka namaz dhe as fjalë, derisa imami ta mbarojë.”¹⁵

Sido që të jetë, duhet të kihet parasysh se që të dyja mendimet mbështeten në sunetin e Pejgamberit a.s. dhe se për qëllim kanë pasimin e tij. Megjithatë, duhet që askush të mos tregohet fanatik në mendimin e tij, por të gjejë mirëkuptim dhe të jetë i arsyeshëm. Nëse dëshiron që të falë dy rekate tehiyetul-mesxhid, atëherë le të mos kalojë mbi kokat e njerëzve për t’i falur ato në safin e parë, por të gjejë ndonjë vend bosh në fund të xhamisë, e të mos bëhet shkak për tërheqjen e vëmendjes së askujt.

NË PREHRIN E SURES EL XHUMA

Ashtu siç e kemi cekur edhe më parë, për rëndësinë dhe vlerën e xhumasë, Allahu i Madhëruar, ka zbritur një sure me emrin El Xhuma. Në të, i Madhëruari ka thënë: “O ju që keni besuar, kur të thirret për namazin e xhumasë, nxitoni për te përmendja e Allahut dhe lini shitblerjen. Kjo është më e mirë për ju, nëse jeni që e dini.” (El Xhuma, 9).

Ky ajet pa dyshim që tregon për rëndësinë e madhe që ka prezantimi në namazin e xhumasë dhe është e vetmja dispozitë në Islam, e cila e bën punën të ndaluar, për të gjithë ata, të cilët e kanë obligim xhumanë, përkundrajt tërë dispozitave të tjera.

Ajo që me të vërtetë tërheq vëmendjen është se Allahu xh.sh., po në këtë sure, po na

tregon për Beni Israilët, të cilët nuk ditën ta mbajnë dhe ta ruajnë Shpalljen e Tij. Ai i krahason ata, duke thënë: “Shembulli i atyre që u obliguan me Tëvrat, e pastaj nuk e zbatuan, i shëmbëllen gomarit që bartë libra. E, sa të këqij janë ata, të cilët i mohojnë argumentet e Allahut! Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e padrejtë.” (El Xhuma, 5).

Në këtë ajet, Allahu i Madhëruar, na tregon për neglizhencën e Beni Israilëve, por në të njëjtën kohë, na bën thirrje dhe na tërheq vëmendjen që të mos e nënvlerësojmë dhe mos ta neglizhojmë rëndësinë dhe vlerën e xhumasë. Sikur Allahu i Madhëruar po na thotë që, mos u bëni si Beni Israilët, të cilët nuk ua ditën vlerën mësimave hyjnore, sikurse ajo kafsha që bartë libra, por që nuk ka dobi prej tyre. Sikur po na thotë që, prezantimi në namazin e xhumasë nuk duhet të jetë rutinë dhe i pavlerë, por duhet të jetë përfitim, mësim, dobi, përqendrim, këshillim, bashkëpunim, si dhe çdo gjë e cila na bën që të përfitojmë prej saj, në dynja dhe ahiret.

HADITHE PËR MIRËSINË E XHUMASË

“Dita më e mirë në të cilën lind dielli është dita e xhuma. Në këtë ditë është krijuar Ademi, në këtë ditë ka hyrë në Xhenet dhe po në këtë ditë është nxjerrë nga Xheneti.” (Muslimi);

“Prej ditëve tuaja, dita më e mirë është dita e xhuma, prandaj bini sa më shumë salavate për mua, sepse salavati juaj ekspozohet tek unë.” (Ebu Davudi);

“Pesë vaktet e namazit dhe xhumaja deri në xhumanë tjetër janë pastruese të gjynaheve të bëra mes tyre.” (Muslimi);

“Kush pastrohet ditën e xhuma, e pastaj shkon herët në xhami, ai njeri konsiderohet sikur të ketë bërë kurban një deve. Kush shkon i dyti, konsiderohet sikur të ketë bërë kurban një lopë. Kush shkon i treti, konsiderohet sikur të ketë bërë kurban një dash të madh. Kush shkon i katërti, konsiderohet sikur të ketë bërë kurban një pulë, dhe kush shkon i pesti, konsiderohet sikur të ketë bërë kurban një vezë. Kur imami të fillojë ta mbajë hytben, atëherë melaqet vinë dhe e dëgjojnë ligjëratën.” (Buhariu dhe Muslimi);

“Do të ndalen disa njerëz nga largimi i tyre prej faljes së xhumasë, o Allahu do t’ua vulos zemrat e tyre dhe pastaj do të bëhen prej gafilëve (njerëzve të papërgatitur për Ditën e Gjykimit)” (Muslimi);

“Në ditën e xhuma, ka një moment, në të cilin, po që se myslimani është duke i kërkuar diçka të mirë Allahut, Allahu do t’ia japë atë.” (Buhariu);

“Kërkoje momentin në të cilin shpresohet (të pranohet lutja) në ditën e xhuma, pas namazit të ikindisë deri në perëndim të diellit.” (Tirmidhiu);

“Çdo mysliman që vdes në ditën apo në natën e xhuma, Allahu e mbron prej sprovës së varrit.” (Imam Ahmed i dhe Tirmidhiu);



“Nuk ka një melaqe të afërt, ose qiell, tokë, erë, mal dhe det, përveçse është i përmalluar për ditën e xhuma.” (Imam Ahmed i);

“Nëse tekta imami është duke mbajtur hytben, ti i thua shokut tënd që e ke pranë, hesht, atëherë ke folur kot (dhe kush flet kot, ai nuk ka xhuma).” (Buhariu);

“Kush e lexon në ditën e xhuma suren El Kehf, atë do ta ndriçojë drita mes dy xhumave.” (Hakimi dhe Bejhak i);

“Do të ndalen disa njerëz nga lënia e xhumasë, dhe Allahu ka për t’i vulosur zemrat e tyre, e pastaj ata do të bëhen prej të hutuarve.” (Muslimi);

“Shtojeni sa më shumë salavat mbi mua në ditën dhe natën e xhuma, sepse kush bie një herë salavat mbi mua, Allahu bie dhjetë herë salavate mbi të.” (Bejhak i);

“Kjo është ditë bajrami (feste), e ka bërë Allahu për myslimanët, prandaj kush vjen në xhuma, le të pastrohet.” (Ibën Maxhe).

EDUKATA E DITËS SË XHUMA (SUNETET E KËSAJ DITE)

Duke qenë dita e xhuma si dita më e mirë e javës, ka disa gjëra, të cilat besimtari duhet t’i ketë parasysh dhe t’i realizojë ato, në mënyrë që të përfitojë prej kësaj dite të begatë.

LARJA E PLOTË E TRUPIT (GUSLI) DHE PARFUMIMI

Abdurrahman ibën ebi Seid el Khuduriu transmeton nga babai i tij, se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Gusli (larja e plotë) në ditën e xhuma është obligim për çdo të rritur, ndërsa misvaku dhe parfumimi, sa të ketë mundësi.”¹⁶

Gjithashtu, në dy librat e saktë, transmetohet se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Kush pastrohet ditën e xhuma, e pastaj shkon herët në xhami, ai njeri konsiderohet sikur të ketë bërë kurban një deve. Kush shkon i dyti, konsiderohet sikur të ketë bërë kurban një lopë. Kush shkon i treti, konsiderohet sikur të ketë bërë kurban një dash të madh. Kush shkon i katërti, konsiderohet sikur të ketë bërë kurban një pulë, dhe kush shkon i pesti, konsiderohet sikur të ketë bërë kurban një vezë. Kur imami të fillojë ta mbajë hytben, atëherë melaqet vinë dhe e dëgjojnë ligjëratën.”¹⁷

SHKUARJA HERËT NË XHAMI

Ebs ibën Ebi Evsi r.a., transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kur ndonjëri prej jush lanë kokën dhe merr gusël (pastrohet plotësisht), pastaj shkon herët në xhami, pastaj ulet dhe dëgjon me vëmendje dhe hesht, ai për çdo hap që ka bërë ka shpërblim si agjërimin e vitit dhe faljen e vitit.”¹⁸

Ebu Hurejra r.a., transmeton se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Në çdo derë të xhamisë, në ditën e xhuma, ka melaqe që shkruajnë ardhjen e njerëzve. Kur imami ulet (në hytbe) regjistrat mbyllen. Ai që ka ardhur herët, është sikurse të ketë bërë kurban një deve, ai që ka ardhur pas tij, sikur të ketë bërë kurban një lopë, ai që ka ardhur pas tij, sikur të ketë bërë kurban një dash, ai që ka ardhur pas tij, sikur të ketë bërë kurban një pulë dhe ai që ka ardhur pas tij, sikur të ketë bërë kurban një vezë.”

ZGJERIMI I VENDIT DHE MOS KALIMI PËRMES NJERËZVE

Duke ditur se në ditën e xhuma ka prezantim të madh nga besimtarët duhet që askush të mos zgjerohet shumë, por të bëjë vend për të tjerët dhe ndërkojë, ai që vjen më vonë, nuk duhet të kalojë përmes njerëzve, por të zërë vend apo t'i thotë atij që ka afër t'i bëjë pak vend, sa për t'u ulur.

Xhabiri r.a. transmeton se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Asnjëri prej jush të mos ngrejë nga vendi vëllain e tij ditën e xhuma, pastaj të zërë vendin e tij e të ulet aty, por t'i thotë: “Më bëj pak vend!”¹⁹

Përsëri, Xhabiri r.a. tregon se një njeri hyri në xhami në ditën e xhuma, teksa i Dërguari

“Kur ndonjëri prej jush lanë kokën dhe merr gusël (pastrohet plotësisht), pastaj shkon herët në xhami, pastaj ulet dhe dëgjon me vëmendje dhe hesht, ai për çdo hap që ka bërë ka shpërblim si agjërimin e vitit dhe faljen e vitit.”

(Muhamedi, a.s.)

i Allahut po mbante hytben. Ai filloi të kalojë përmes njerëzve dhe i Dërguari i Allahut a.s. i tha: “Zë vend (ulu), sepse lëndove dhe u vonove!”²⁰

HESHTJA DHE DËGJIMI I HYTBESË

Ebu Hurejra r.a. transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Nëse teksa imami është duke mbajtur hytben, ti i thua shokut tënd që e ke pranë, hesht, atëherë ke folur kot (dhe kush flet kot, ai nuk ka xhuma).”²¹

Ibën Umeri r.a. transmeton se e ka dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: “Nëse ndonjëri prej jush hyn në xhami dhe imami po mban hytben në minber, atëherë nuk ka namaz dhe as fjalë, derisa imami të mbarojë.”²²

SHTIMI I LUTJES DHE I DHIKRIT

Allahu i Madhëruar në Kuranin famëlartë, në suren El Xhuma, thotë: “E, kur të mbarojë namazi, shpërndahuni nëpër tokë, kërkon mirësitë e Allahut dhe përmendeni Allahun shumë, në mënyrë që ju të shpëtoni.” (El Xhuma, 10).

Ebu Hurejra r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Dita e xhuma e ka një moment, në të cilin, në qoftë se myslimani është duke i kërkuar diçka të mirë Allahut në atë moment, Allahu ia jep atë gjë.”²³

LEXIMI I SURES EL KEHF

Ebu Seid el Kudriu r.a. transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush e lexon suren El Kehf në ditën e xhuma, e ndriçon drita mes dy xhumave.”²⁴

SHTIMI I SALAVATIT PËR PEJGAMBERIN A.S.

Evs ibën Evsi r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Prej ditëve tuaja, dita më e mirë është dita e xhuma; në të është krijuar Ademi, në të është fyerja (e surit) dhe në të është kiameti, prandaj bini sa më shumë salavat mbi mua, sepse salavati juaj ekspozohet tek unë.” Dikush i tha: “O i Dërguar i Allahut, si të ekspozohet salavati jonë ty, ndërkojë që je tretur?” Tha: “Allahu ia ka bërë haram tokës, që të tretë trupat e pejgamberëve!”²⁵

Enesi r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Shtojeni sa më shumë salavat



mbi mua ditën e xhuma dhe natën e xhuma, sepse kush bie një salavat mbi mua, Allahu bie dhjetë salavate mbi të!”²⁶

PËRFUNDIMI

Xhumaja, jo vetëm që është obligim, por është prej obligimeve më të veçanta dhe më të rëndësishme të Islamit. Nëse ymeti islam është në gjendje t'i japë vendin dhe pozitë e saj, të cilën ia ka dhënë Zoti i gjithësisë, Pejgamberi a.s. dhe brezat e parë të devotshëm, nuk ka dyshim, se ky ymet, do të zërë përsëri edhe një herë tjetër, vendin e merituar në mesin e popujve të kësaj bote, madje do të bëhet udhëheqësi i mbarë njerëzimit, siç ka qenë dikur në periudhën e mesjetës, periudhën e lavdishme të tij.

Muhamed el Gazali, në lidhje me rëndësinë tubimeve në xhami dhe veçanërisht xhumasë, ndër të tjera është shprehur: “Xhamia është zemra e shoqërisë islame dhe vendtakimi i besimtarëve, nga mëngjesi deri në darkë gjatë kryerjes së të drejtave të Allahut, kërkimit të udhëzimit dhe marrjes së ndihmës prej Tij xh.sh.. Ajo është burim i energjisë emocionale dhe intelektuale, veçanërisht ditëve të tubimeve, kur masat e besimtarëve rrinë në heshtje me qetësi e përkushtim për “imamin”, ndërkohë që ai u shpjegon atyre mësimet e Islamit, u sqaron kufijtë e Allahut dhe i bën të kuptojnë atë që është në Librin e Allahut dhe sunetin e të Dërguarit të Tij a.s. prej këshillave dhe moralit. Hytbeja e xhumasë është prej ritualeve të mëdha të Islamit dhe kuptimet e saj derdhen në zemra, që nga momenti i kthimit tek Allahu dhe pranimit të porosive të Tij. Prej këtu kuptojmë se, tema e saj ka ndikim të lartë dhe rëndësi të madhe. Imami, i cili studion temën e saj dhe arrin ta përcjellë mirë atë, ai ka kryer një punë të madhe në pasurimin e kulturës së ymetit, udhëzimin drejt rimëkëmbjes, mbështetjen e strukturës së tij materiale e shpirtërore dhe lidhjen e të nesërme së tij të shpresës me të kaluarën e tij të lavdishme.”²⁷

Patjetër, bile është detyrë, në radhë të parë e hatibëve, t'i kthejnë funksionin xhumasë dhe të arrijnë përmes saj të ndërgjegjësojnë xhematin dhe t'i ushqejnë me ligjërimet e

tyre fetare, shkencore, edukative, shoqërore, etj., dhe të bëhet xhumaja tribuna javore e përsosur, në të cilën trajtohen në mënyrë kompetente çështjet dhe problemet që e shqetësojnë bashkësinë islame.

- 1 Shih: El Ikhtijar, 1/228.
- 2 Shih: El Minhaxh, 1/216.
- 3 Shih: Esh Sherh es Sagir, 1/511.
- 4 Shih: Nil el Mearib, 1/70 dhe El Kafi, 1/300.
- 5 Transmetuar nga Tirmidhiu.
- 6 Transmetuar nga Ibën Maxhe.
- 7 Transmetuar në Sunenin e Bejhakiut dhe në Sahihun e Ibën Hibanit.
- 8 Shih: Sahihul-Buhari.
- 9 Shih: Për hanefitë, El Ikhtijar, 1/228; për malikitë, El Istidhkar, 1/630; për shafitë, El Minhaxh të Imam Neveviut, 2/215; për hanbelitë, El Kafi, 1/302.
- 10 Transmetuar nga Muslimi.
- 11 Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
- 12 Transmetuar nga Muslimi.
- 13 Transmetuar nga Muslimi.
- 14 Transmetuar nga Ebu Davudi, hadith i saktë.
- 15 Transmetuar nga Hejthemiu dhe Ibën Hibbani.
- 16 Transmetuar nga Imam Ahmedi.
- 17 Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
- 18 Transmetuar nga Imam Ahmedi.
- Transmetuar nga Imam Ahmedi dhe Buhariu.
- 19 Transmetuar nga Imam Ahmedi dhe Muslimi.
- 20 Transmetuar nga Ibën Maxhe.
- 21 Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
- 22 Transmetuar nga Hejthemiu dhe Ibën Hibbani.
- 23 Transmetuar nga Buhariu.
- 24 Transmetuar nga Hakimi dhe Bejhakiu.
- 25 Transmetuar nga Imam Ahmedi, Daremiu, Ebu Davudi dhe Ibën Maxhe.
- 26 Transmetuar nga Bejhakiu.
- 27 Shejh Muhamed el Gazali, “E vërteta e hidhur 2”, f. 13, përktheu Lavdrim Hamja, botim i Myftinisë Shkodër, prill 2018.

Shenjtëria e pasurisë dhe pacenueshmëria e saj në të drejtën islame

• Bashkim Aliu

HYRJE

Mbrojtja e pasurisë, si dhe e domosdoshmërive të tjera jetësore, është synim thelbësor dhe krucial i të Drejtës Islame, gjegjësisht Islamit si fe. Lumturia e njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër, që Islami e promovon si qëllim të tij final, nuk do të mund të realizohej pa mbrojtjen e domosdoshmërive jetësore, përfshirë këtu edhe mbrojtjen e pasurisë dhe pacenueshmërinë e pronës së njeriut, pasi pambrojtja e këtyre domosdoshmërive gjeneron probleme serioze ekzistenciale për njeriun edhe shoqërinë, gjegjësisht shkakton kaos dhe anarki në shoqëri. Në fakt, mbrojtja e pasurisë dhe pronës nga çdo shkelje dhe nëpërkëmbje, i referohet mbrojtjes së dinjitetit të llojit njerëzor, pasi çdo gjë

që e cenon një të drejtë të njeriut, në këtë rast pasurinë dhe pronën, është cenim i dinjitetit të tij.¹ Kjo, dhe Kurani qartë shprehet se Zoti i Madhërishëm e ka dekoruar njeriun si qenie dhe e ka dalluar nga të gjitha krijesat e tjera. Në Kuran qëndron: “*Ne, vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësua të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësua ata (i lartësua) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam.*” (El Israë, 70). Kjo, ngase Islami e sheh njeriun si tërësi, e jo në mënyrë parciale, gjegjësisht e ka për objektiv realizimin e nevojave të tij shpirtërore dhe materiale, e jo vetëm të njërës palë, që për rrjedhojë, mbrojtja e pasurisë dhe pacenueshmëria e pronës, është objekt kyç në objektivin e të Drejtës Islame.

Këtë objektiv thelbësor dhe madhor të së Drejtës Islame e kanë theksuar edhe dijetarët islamë, duke e shpjeguar dhe nënvizuar me këtë, përcaktimin sistematik të Islamit si fe, dhe të dispozitave islame si legjislacion, që t’i mbrojnë dhe afirmojnë domosdoshmëritë jetësore, ku pa dyshim bën pjesë edhe mbrojtja e pasurisë dhe pacenueshmëria e pronës. Në këtë drejtim, Imam Shatibiju, një jurist i shquar islam, shprehet: “Myslimanët, bile edhe komunitetet e tjera fetare, janë të pajtimit se legjislacioni është legalizuar që t’i mbrojë pesë domosdoshmëritë, të cilat janë: feja, jeta, gjeneza, pasuria dhe mendja. Njohja e këtyre gjërave për popullin është si diçka e domosdoshme. Kjo nuk na është vërtetuar neve me një argument të caktuar...por, kompatibiliteti i kësaj me legjislacionin islam, është njohur me një varg argumentesh të cilat nuk kufizohen vetëm në një kapitull...”²



UDHËZIME TË PËRGJITHSHME KURANORE PËR MBROJTJEN E PASURISË

Në burimin e parë të së Drejtës Islame, Kuranin famëlartë, ka disa ajete që udhëzojnë në mënyrë të përgjithshme në mbrojtjen e pasurisë dhe shenjtërinë e pronës. Kështu, në ajetin vijues lexojmë: “*Mos iu afroni pasurisë së jetimit derisa ai ta arrijë pjekurinë, (mund t’i afroheni) vetëm në mënyrën më të mirë, dhe zbatoheni me drejtësi masën dhe peshoren...*”, (El En-amë, 152). Në këtë ajet është nënvizuar mbrojtja e pasurisë në dy raste: duke e ndaluar që të keqpërdoret pasuria e jetimit, si dhe duke urdhëruar që të peshohet në mënyrë të drejtë dhe korrekte.

Në fakt, në këtë pjesë të ajetit, mbrohet pasuria si një nga domosdoshmëritë jetësore të njeriut, ndërsa ajeti paraprak u qaset disa domosdoshmërive të tjera jetësore, si: mbrojtja e fesë, mbrojtja e jetës, mbrojtja e gjenezës dhe mbrojtja e mendjes.

Po ashtu, Allahu i Madhërishëm ka thënë: “*Dhe jepja çdo të afërmi të drejtën që i takon, e edhe të varfrit dhe atij në kurbet, mirëpo mos shpenzo tepër e pa rrugë! Ata që shpenzojnë tepër janë vëllezër të djajve e djalli është përbuzës i madh i Zotit të vet.*” (El Israë, 26-27); “*Mos e përdorni pasurinë e jetimit ndryshe, vetëm se në mënyrën më të mirë (për t’ia shtuar), derisa ai ta arrijë pjekurinë. Premtimin zbatoheni, sepse për premtimin ka përgjegjësi. Kur matni, masën mbusheni, dhe peshoni me peshore të drejtë (të saktë). Kjo është më e dobishme dhe ka përfundim më të mirë.*” (El Israë, 34-35). Edhe në këto ajete vihet në spikamë mbrojtja e pasurisë si një e drejtë e cila nuk guxon të shkelet, të keqpërdoret dhe të shpenzohet vend e pa vend.

UDHËZIME SPECIFIKE

Në burimet bazë të së Drejtës Islame, hasim një varg tekstesh specifike që i referohen mbrojtjes së pasurisë dhe shenjtërisë së pronës, gjë që më së miri e pasqyron përcaktimin e të Drejtës Islame për mbrojtjen e domosdoshmërive jetësore të njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtën e pronës dhe paprekshmërinë e pasurisë së individëve. Në

Në të Drejtën Islame është sanksionuar jo vetëm cenimi apo përvetësimi i paligjshëm i pasurisë së tjetrit, por edhe humbja, harxhimi vend e pa vend dhe mos kujdesi edhe ndaj pasurisë personale.

vazhdim do të përmendim disa nga këto argumente specifike.

NDALOHET CENIMI I PASURISË SË TË TJERËVE

Në burimet primare islame, në Kuran dhe në trashëgiminë pejgamberike, ka shumë tekste që në mënyrë të drejtpërdrejtë e ndalojnë cenimin dhe përvetësimin e paligjshëm të pasurisë së tjetrit. Sanksionimi i këtij veprimi me tekste fetare tregon për shenjtërinë e pasurisë dhe pacenueshmërinë e pronës në të Drejtën Islame. Në vazhdim do të përmendim disa tekste fetare sa për ilustrim, për ta mbështetur këtë konstatim:

- Allahu i Madhërishëm ka thënë: “*Dhe mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, e as mos u paraqitni me të (me rrysh-fet) te gjykatësit për të grabitur në mënyrë të padrejtë një pjesë të pasurisë së njerëzve, kur ju e dini (se pa të drejtë po e hani atë).*” (El Bekare, 188); “*Ata që e hanë pa të drejtë pasurinë e jetimëve, në të vërtetë ata hanë atë që mbush barkun e tyre zjarr dhe do të futen në zjarrin e Xhehenemit.*” (En Nisaë, 10).

- I Dërguari i Allahut ka thënë: “Çdo mysliman e ka të ndaluar që myslimanit t’ia cenojë: jetën (gjakun), pasurinë dhe nderin.” (Muslimi, 32).³

Këto tekste fetare dhe shumë të tjera që nuk i kemi përmendur këtu për shkak të hapësirës, qartë e potencojnë përkushtimin e Islamit në mbrojtjen e pasurisë së njeriut dhe pacenueshmërinë e pronës së tij, pasi ndalesa për cenimin e pasurisë është theksuar qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekstet fetare, gjegjësisht në ajetet e Kuranit dhe në thëniet e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të.

NDALIMI I HUMBJES SË PASURISË

Në drejtim të përkufizimit të qartë të mbrojtjes së pasurisë dhe pronës, në të Drejtën Islame është sanksionuar jo vetëm cenimi apo përvetësimi i paligjshëm i pasurisë së tjetrit, por edhe humbja, harxhimi vend e pa vend dhe mos kujdesi edhe ndaj pasurisë personale. Edhe pse njeriu është titullar i pasurisë në këtë botë, megjithatë, pronar i vërtetë i saj është Krijuesi i Madhërishëm, i Cili ia ka mundësuar njeriut që të fitojë pasuri duke i shfrytëzuar të

mirat materiale që i ka krijuar në këtë botë për njeriun. Nisur nga kjo, njeriu nuk i ka duart e lira të veprojë me pasurinë e tij si të dojë, në kuptim negativ, por prej tij kërkohet që ta menaxhojë pasurinë në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me parimet fetare. Nisur nga kjo, harxhimi i pasurisë në mënyrë të tepruar, edhe nëse është për gjëra të lejuara, është veprim i urryer. Ndërkaq, shpenzimi i saj për gjëra të ndaluara, edhe nëse është në sasi të vogël, është veprim i ndaluar. Kështu, Allahu i Madhërishëm në Kuran ka thënë: *“O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz (lutje), hani dhe pini e mos e teproni, pse Ai (Allahu) nuk i do ata që e teprojnë (shkapërderdhin).”* (El Arafë, 31).

Po ashtu, i Dërguari i Allahut është shprehur në mënyrë taksative se është e ndaluar që të humbet pasuria, gjegjësisht të përdoret në mënyrë të padrejtë dhe të harxhohet vend e pa vend. (Muslim, 10).⁴

MBROJTJA E PASURISË ME ÇDO MJET LEGJITIM ËSHTË VEPRIM LEGAL

Mbrojtja e pasurisë dhe pacenueshmëria e pronës në të Drejtën Islame, vërtetohet edhe me faktin se i Dërguari i Allahut e ka legalizuar mbrojtjen e pasurisë nga grabitësit dhe përvetësuesit e paligjshëm, qoftë edhe nëse kjo kërkon përballje fizike me grabitësin. Bile, i Dërguari i Allahut është shprehur se nëse pronari i pasurisë ndodh të pësojë gjatë mbrojtjes së pasurisë së tij, e ka tretmanin e dëshmorit. Kështu, është transmetuar se një person e ka pyetur të Dërguarin e Allahut: “Çka të bëj nëse një person vjen dhe dëshiron ta rrëmbejë pasurinë time?” I Dërguari i Allahut i ka thënë: “Mos ia jep!” Personi në fjalë e ka pyetur përsëri: “Po çka të bëj nëse ai përleshet me mua?” I Dërguari i Allahut i ka thënë: “Përleshu me të!” E ka pyetur përsëri: “Çka ndodh

nëse ai mua më vret?” I Dërguari i Allahut i është përgjigjur: “Në atë rast ti je dëshmor!” E ka pyetur përsëri: “E nëse unë e vras atë?” I Dërguari i Allahut është përgjigjur: “Ai është në zjarr”. (Muslim, 226).⁵

Klasifikimi i personit i cili pëson nga grabitësit në mbrojtje të pasurisë dhe pronës së tij, si dëshmor, është dëshmi decisive për shenjtërinë e pasurisë dhe pacenueshmërinë e pronës në të Drejtën Islame.

VËNIA E KUJDESTARISË NDAJ DISA PERSONAVE NË MENAXHIMIN E PASURISË

Në drejtim të mbrojtjes së pasurisë dhe pacenueshmërisë së pronës, në të Drejtën Islame është miratuar instituti i kujdestarisë ndaj personave të caktuar, të cilët nuk kanë aftësi të menaxhojnë me pasurinë e tyre, qoftë për shkak të moshës, ose për ndonjë defekt të tjetër në aftësitë e tyre menaxheriale me pasurinë. Në këtë kategori personash mund të përmenden: fëmijët, njerëzit me të meta mentale dhe njerëzit që tregojnë simptome të papjekurisë. Për këtë shkak, në të Drejtën Islame është miratuar institucioni i kujdestarit, të cilin legjislacioni islam e obligon që ta mbrojë pasurinë e personave të këtillë, mos të lejojë që të nëpërkëmbet, dhe t’ua dorëzojë personave të cilët janë pronarë të saj, atëherë kur do të vërtetohet se janë të aftë të menaxhojnë me të. Në këtë drejtim, Kurani shprehet: *“Mendjelehtëve (të papjekurve) mos u jepni pasurinë tuaj që Allahu e bëri për ju mëkamje, e ata ushqeni nga ajo, vishni dhe u thoni fjalë të mira. Provoni bonjakët derisa të bëhen për martesë, e nëse vëreni te ta pjekuri, atëherë dorëzoni atyre pasurinë e tyre. Mos e hani atë duke e shkapërderdhur dhe duke u ngutur para se të rriten ata. Kush është i pasur le të ruhet (shfrytëzimit të pasurisë së jetimëve), e kush është i varfër, le të hajë me maturi. E kur t’ju dorëzoni atyre pasurinë e vet,*



dëshmoni atë (që ju dorëzoni). Mjafton që Allahu është llogaritës.” (En Nisaë, 5-6). Po ashtu, instituti i kujdestarisë ndaj personave të cilët nuk janë të aftë të menaxhojnë me pasurinë e tyre, përmendet edhe në ajetin vijues: “... E në qoftë se ai që ngarkohet me borxh është i paaftë mentalisht, është i mitur ose nuk është në gjendje të diktojë, atëherë le të diktojë drejt kujdestari i tij...” (El Bekare, 282).

Instituti i kujdestarisë është mishërim i përkushtimit të së Drejtës Islame për mbrojtjen e të drejtave të individëve, ku bën pjesë edhe e drejta e pronës dhe pasurisë. Me këtë institut i cili është përmendur në mënyrë taksative në tekstet fetare të Kuranit, e Drejta Islame e vë në spikamë shenjtërinë e pasurisë dhe pacenueshmërinë e saj. Në këtë drejtim, dijetarët islamë kanë dhënë shpjegimet e tyre se në cilën moshë kategorive të tyre u dorëzohet pasuria. Sipas Ebu Hanifes, kur kategoritë e këtilla e arrin moshën njëzetepesë vjeçare, u dorëzohet pasuria ta menaxhojnë, pasi në këtë moshë e arrin pjekurinë. Ndërkaq, shumë dijetarë të tjerë, këtë nuk e kufizojnë me moshë të caktuar, por me arritjen e pjekurisë, dhe shprehen se kjo mund të zgjasë derisa personat e këtillë të plaken.⁶

Instituti i kujdestarisë në të Drejtën Islame, nuk i referohet vetëm kategorive të këtilla, siç janë: fëmijët, njerëzit me të meta mentale, por i referohet edhe kategorisë së të bankrotuarve, të cilët nuk kanë të meta psikike për menaxhimin e pasurisë, por u kanë marrë njerëzve borxhe, pastaj kanë bankrotuar dhe nuk mund t’ua kthejnë borxhet për shkak të keq menaxhimit të pasurisë. Në rastet e këtilla, instituti i kujdestarisë vlen edhe për ta, derisa organet kompetente të marrin vendim për t’ua lejuar të menaxhojnë me pasurinë, pas procedurave të caktuara që ndjekin në këtë drejtim.⁷

MASA NDËSHKUESE PËR VJEDHJE

E Drejta Islame e ka betonuar mbrojtjen dhe shenjtërinë e pasurisë dhe pacenueshmërinë e pronës për të ndaluar çdo lloj shkelje të saj, duke miratuar masa ndëshkuese ligjore. Në këtë drejtim, më i theksuar është dënimi për vjedhje, që e potencon edhe vetë Kurani, duke mos lënë hapësirë për inter-

prezim ndryshe në këtë segment. Kjo, krahas asaj se vjedhja, në aspektin moral, konsiderohet mëkat i madh, dhe për të pason ndëshkim në botën tjetër. Po ashtu, çdo përvetësim i pasurisë përmes mashtrimit në tregti, shitblerje apo forma të tjera të biznesit, konsiderohet tradhti dhe manipulim, që i Dërguari i Allahut e ka cilësuar si shkelje të rëndë, saqë personin e tillë e ka cilësuar si njeri që nuk është në rrugën e duhur të një myslimani. I Dërguari i Allahut ka thënë: “Kush na mashtron, nuk është prej nesh.” (Muslim, 101).⁸

KONKLUZION

Thënë përmbledhtas, shenjtëria e pasurisë dhe pacenueshmëria e saj në të Drejtën Islame janë dy parime themelore që garantojnë drejtësinë ekonomike dhe sociale. Islami ndalon çdo formë cenimi të pronës private dhe përvetësimit të padrejtë të pasurisë së tjetrit duke vendosur masa të rrepta për të mbrojtur atë. Megjithatë, Islami nuk e sheh pasurinë vetëm si një të drejtë ekskluzive të njeriut, por edhe si një amanet që njeriut ia ka mundësuar Krijuesi duke ia përshtatur kushtet dhe resurset për ta arritur atë, e që për rrjedhojë, duhet ta përdorë me ndershmëri dhe përgjegjësi. Për këtë arsye, pasuria në Islam nuk është thjesht një mjet për të realizuar dëshira të natyrës materiale, por një mundësi për të kontribuar në të mirën e shoqërisë dhe për të fituar kënaqësinë e Zotit.

Shenjtëria e pasurisë dhe pacenueshmëria e saj në të Drejtën Islame janë dy parime themelore që garantojnë drejtësinë ekonomike dhe sociale.

1 Muhamed Saëd ibën Ahmed ibën Mesud el Jeubij, *Mekasidu esh sheria el islamijje ve alakatuha bil edil-leti esh sheri'ijje*, (botimi i parë, Rijad, Darul hixhre, 1998/1418h), f. 248.

2 Ibrahim ibën Musa esh Shatibijj, *El Muvafeqat*, (vëll. I, botimi i parë, Fas-Maroko, El Beshir bi Naëtijje, 2017), f. 31.

3 Muslim ibën el Haxhxhaxh el Kushejrijj, *Sahihu Muslim*, (Kajro, Daru Ihjail kutubil ilmije, vëll. IV, pa vit botimi), fq. 1986.

4 Muslim ibën el Haxhxhaxh el Kushejrijj, *Sahihu Muslim*, (Kajro, Daru Ihjail kutubil ilmije, vëll. III, pa vit botimi), fq. 1340.

5 Muslim ibën el Haxhxhaxh el Kushejrijj, *Sahihu Muslim*, (Kajro, Daru Ihjail kutubil ilmije, vëll. I, pa vit botimi), fq. 124.

6 Abdullah ibën Ahmed ibën Muhamed ibën Kudame, *El Mugnij*, (vëll. IV, Kajro, Mektebetul Kahire, pa vit btimi), f. 344.

7 Po aty, f. 306.

8 Muslim ibën el Haxhxhaxh el Kushejrijj, *Sahihu Muslim*, (Kajro, Daru Ihjail kutubil ilmije, vëll. I, pa vit botimi), fq. 162.

Duaja (lutja) pas namazit nuk është risi

- Ajet Aliu

Çështja e duasë pas namazeve është një temë për të cilën kanë diskutuar shumë dijetarët islam. Disa nga dijetarët pretendojnë se duaja pas namazeve nuk ka bazë në fe dhe si e tillë është risi (bidat), ndërsa shumica absolute e dijetarëve janë të mendimit se duaja pas namazeve është sunet. Të dyja grupet e dijetarëve qëndrimet e tyre i mbështesin në fakte dhe argumente.

ARGUMENTET E ATYRE TË CILËT MENDOJNË SE DUAJA PAS NAMAZIT ËSHTË RISI

Argumenti i parë – Këta dijetarë si argument e marrin hadithin të cilin e transmeton Aisheja r.a., ku thotë: “I Dërguari i Allahut kur jepte selam nuk qëndronte më tepër sesa që

Çdo sahabi ka treguar atë që ka parë dhe ka dëgjuar, kështu që Aisheja r.a. është e justifikuar nëse ka treguar vetëm atë që ka ditur dhe nuk mund të justifikohet ai që ka marrë hadithe të tjera nga sahabët.

thoshte: “Allahumme entes-selamu ve min-kes-selamu, tebarekte jadhel xhelali vel ikram.” (Muslimi).¹

Si përgjigje ndaj këtij argumentimi, shumë dijetarë i janë përgjigjur duke e kundërshtuar një argumentim të tillë, duke thënë se ky është mohim i njohurisë së Aishes r.a. dhe jo i realitetit. Sahabët kanë transmetuar nga Pejgamberi a.s. më shumë se kaq, siç është transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.² Çdo sahabi ka treguar atë që ka parë dhe ka dëgjuar, kështu që Aisheja r.a. është e justifikuar nëse ka treguar vetëm atë që ka ditur dhe nuk mund të justifikohet ai që ka marrë hadithe të tjera nga sahabët.

Argumenti i dytë – Interpretimi i shumë haditheve të cilat e përmendin duanë pas namazit duke thënë se fjala “dubur” e përmendur në hadithe i referohet fundit të diçkaje dhe është pjesë përbërëse e saj. Kështu që duatë duhet të bëhen para selamit dhe pas teshheudit.

Si kundërpërgjigje ndaj këtij argumentimi, i janë përgjigjur se, nëse fjala “dubur” përdoret në dy kuptimet e saja të vërteta, sipas parimit të atyre që e mohojnë përdorimin figurativ, nuk lejohet të kufizohet në kuptimin e parë, përveç nëse japin një argument që e favorizon atë mbi kuptimin tjetër, apo të pranojnë përdorimin figurativ dhe ta konsiderojnë “dubur” si të vërtetë në pjesën e fundit të një



gjëje dhe figurative për pjesët pasuese, sepse kuptimi i vërtetë nuk ka nevojë për argument mbështetës.³ Megjithatë, interpretimi i këtyre haditheve nuk sjell asnjë dobi përveç, lënies anash të argumentimit me hadithe të cilat mund të kanë dy kuptime e të cilat argumentojnë se duaaja pas namazit është sunet, sepse argumentet e tjera e vërtetojnë këtë dhe hedhin poshtë këtë interpretim. Gjithashtu është vërtetuar në sunet se fjala “dubur” përdoret për të treguar veprimet pas namazit dhe kjo në mënyrë unanime të dijetarët, siç ka ardhur në urdhrin për të bërë dhikër pas namazi, po kështu qëndron edhe për duanë deri sa të vërtetohet e kundërta e saj. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Thoni pas namazi 33 herë subhanallah, elhamdulillah dhe Allahu ekber!” (Buhari dhe Muslimi).⁴

Argumenti i tretë – Thënia e tyre se, si mund të lërë lutësi kërkesën e tij kur është në namaz para Krijuesit të Tij dhe të kërkojë atë kur të përfundoi namazin?

Përgjigje ndaj këtij argumentimi:

Kjo është një përpjekje për të nxjerrë një mendim në një çështje ku ekzistojnë tekste të qarta. Nuk është e nevojshme për përpjekje të tilla, sepse duaaja është e vërtetuar nga veprat e Pejgamberit a.s. në shumë hadithe të sakta.

Është transmetuar dhikri pas namazit dhe duaaja është njësoj si dhikri, prandaj ashtu siç është i dobishëm dhikri pas namazit, po ashtu është e dobishme edhe duaaja pas namazit.⁵

Fjala estagfirullah është transmetuar pas namazit dhe ajo nuk është diç tjetër vetëm se dua. Duatë të cilat transmetohen nga Aisheja r.a., i ka transmetuar po ashtu Muslimi nga Thevbani r.a. para hadithit të Aishes r.a., ku ai shton fjalën estagfirullah, duke thënë: “I Dërguari i Allahut kur përfundonte namazin, kërkonte falje tri herë (estagfirullah) dhe thoshte: “Allahumme entes-selamu ve min-kes-selamu, tebarekte jadhel xhelali vel ikram.”(Muslimi).⁶ Ky hadith është një argument i qartë kundër mospranimit të duasë pas përfundimit të namazit, sepse kërkimi i faljes nga Allahu xh.sh. është lutje, qoftë ajo me fjalët e kërkesës si “O Allah më fal!” apo me fjalë të tjera si “Kërkoj falje nga Allahu!”. Nuk është e nevojshme për ndonjë argument tjetër, sepse mohimi i saj është një

bidat (risi) dhe kundërshton thjeshtësinë e sunetit, veçanërisht kur mohimi është për çdo lutje, siç thonë ata.

Pejgamberi a.s. e ka inkurajuar ymetin e tij që të lutet para namazit, siç ka ardhur në tekst: “Lutja në mes të ezanit dhe ikametit nuk refuzohet.”(Tirimidhiu).⁷ Kështu pyetjes së tyre se si mund të kërkojë nga Zoti pasi të largohesh prej Tij?, ne i përgjigjemi me atë se si mund të kërkojë prej Tij para se të qëndrosh para Tij?!

Argumenti i katërt – Thënia e tyre se nuk ka argument nga Pejgamberi a.s. se ai vetë është lutur pas namazit.

Ndaj këtij pohimi, dijetarët iu përgjigjën me faktin se, ky mohim në mënyrë të përgjithshme është i pavend dhe i refuzuar, sepse ka argumente nga thëniet dhe veprimet e Pejgamberit a.s., që tregojnë të kundërtën e këtij pretendimi.⁸ Por dhe nëse supozojmë se ajo që thonë kundërshtarët është e vërtetë, pra që duaaja pas namazit nuk është sunet, përveç nëse vije ndonjë argument specifik nga veprat e Pejgamberit a.s., që e vërteton këtë, sikur ngushtojnë mënyrën e argumentimit se argumenti në fe nuk është i mjaftueshëm që të jetë vetëm nga fjalët e tij, apo vetëm miratimi i tij. Ky mendim padyshim është i pasaktë. Të gjithë dijetarët janë pajtuar se çdonjëra prej tyre është e mjaftueshme në argumentim. Kjo është shumë e qartë se miratimi i Pejgamberit a.s. për një çështje të caktuar është argument, jo se Pejgamberi a.s. e ka bërë atë çështje, as se ai ka folur për të, por sepse ai e ka parë dhe nuk ka thënë asgjë për të. A mund të thuhet për dikë që e kryen një veprim të mbështetur në miratimin e Pejgamberit a.s., se ajo është një bidat, sepse Pejgamberi a.s. nuk e ka vepruar atë?! Për më tepër, ka veprime që ai urdhëroi të veprohen, por nuk ka ndonjë argument që ai vetë i ka vepruar ato, siç është hadithi ku Pejgamberi a.s. ka thënë: “Falni dy rekate para namazit të akshamit.” (Buhariu).⁹ A mund të thuhet: “Si mund të urdhërojë diçka dhe vetë ai të mos e veprojë atë?!” Në këtë mënyrë, nëse Pejgamberi a.s. e ka lënë një veprim të caktuar që ka të bëjë me çështjen e adhurimeve, ne duhet të kërkojmë një argument tjetër sheriatik, jo vetëm nga veprimi i tij, por çfarëdo argumenti sheriatik qoftë ai, pavarësisht a është ajet kuranor,

Është transmetuar dhikri pas namazit dhe duaaja është njësoj si dhikri, prandaj ashtu siç është i dobishëm dhikri pas namazit, po ashtu është e dobishme edhe duaaja pas namazit.



thënie e Pejgamberit a.s., miratim nga ai etj.. Nëse nuk gjejmë asnjë argument tjetër, atëherë mund të themi se veprimi i saj është një bidat.

ARGUMENTET E PËRGJITHSHME JANË TË MJAFTUESHME NË MUNGESË TË ATYRE SPECIFIKE

Mjafton që argumenti të jetë i përgjithshëm dhe të përfshijë në përgjithësi veprën për të cilën kërkojmë gjykim mbi të dhe nuk është e domosdoshme që kjo vepër të përmendet decidivisht në atë argument, dhe kushdo që pretendon se vepra e cila futet brenda argumenteve të përgjithshmërisë është risi, fjala e tij është e pavend dhe refuzim ndaj të Dërguarit të Allahut a.s..

Përkundrazi, ky pretendim bën që të gjitha argumentet e përgjithshme të jenë të pavlefshme, sepse mund të pretendohet kështu për çdo pjesë të përgjithshmërisë, dhe kështu përgjithshmëria do të ishte e pasigurt për argumentim. Ndërkohë që shumica e çështjeve futen brenda argumenteve të përgjithshme. Kështu, fjala e Allahut xh.sh: *“Dhe bëni mirë”* (El Haxh, 77) është argument për ligjshmërinë e çdo veprimi që ka të bëjë me mirëqenien e robërve, përderisa nuk bie në kundërshtim me ndonjë argument të Sheriatit.

Po kështu, Omeri r.a. u mbështet në këtë qëndrim kur i propozoi Ebu Bekrit r.a. tubimin e Kuranit të madhërisëm, ku Ebu Bekri r.a. tha: *“Si mund të bësh diçka që nuk e ka bërë Pejgamberi a.s?”* Omeri iu përgjigj: *“Për Allahun, kjo është më e mirë.”* Po ashtu, Ebu Bekri r.a. u mbështet në këtë qëndrim kur Zejd bin Thabiti r.a. i tha atij: *“Si mund të bëni diçka që nuk e ka bërë Pejgamberi a.s?”* Ebu Bekri iu përgjigj: *“Për Allahun, kjo është më e mirë.”* (Buhariu). ¹⁰Duke iu referuar kësaj, çdo individ që bën vepra të mira, nuk ka nevojë për një argument të veçantë që t'i mbështesë ato, mjafton që ato të mos bien në kundërshtim me ndonjë argument të Sheriatit.

PËRFUNDIMI

Kështu qëndron edhe çështja e duasë, e cila është urdhëruar në mënyrë të përgjithshme, pa kufizime në kohë, vend, ose kërkesë që duhet të bëhet. Allahu xh.sh. thotë: *“Lutuni Zotit tuaj...”* (El Araf, 55). Nuk mund të thuhet për ndonjë prej këtyre se është bidat pa një argument që e përjashton këtë, kështu që për aq kohë sa është një urdhër i përgjithshëm, askush nuk ka të drejtë ta kufizojë atë pa një argument që e përjashton këtë çështje të veçantë. Allahu i Lartësuar ka urdhëruar që t'i lutemi Atij dhe na ka premtuar përgjigje për të në çdo kohë, me fjalët e Tij: *“Dhe kur robërit e Mi të të pyesin për Mua, unë jam afër, i përgjigjem lutjes së lutësit kur më lutet.”* (El Bekare, 186). Ai na ka premtuar përgjigje dhe e ka bërë lutjen një kusht të përgjithshëm: *“I përgjigjem lutjes së lutësit kur më lutet.”* Sikur të thoshte Ai: *“Përgjigjem lutjes së lutësit në çdo kohë.”* Pra, nuk është e drejtë të kufizohet lutja në një kohë të caktuar pa një argument që e përjashton atë nga ky përgjithësim. Lutja pas selamit nga namazi dhe çdo kohë tjetër është një nga rastet e përgjithshme që përmendet në ajetin kuranor që na nxit për dua. Në nivelin më të ulët, ajo është e preferuar, dhe nëse bashkëngjitet me argumente specifike, të cilat i kemi përmendur me lart është e mjaftueshme që të argumentohemi se lutja pas namazi është sunet.

Lutja pas selamit nga namazi dhe çdo kohë tjetër është një nga rastet e përgjithshme që përmendet në ajetin kuranor që na nxit për dua.

- 1 Muslimi në Sahih, nr. i hadithit 136 (592), Tirmidhiu në Sahih, nr. 300 dhe thotë se hadithi është hasen-sahih.
- 2 Shiko “Fet’hul Bari” 11/ 133, Muslimi 1/492 numër 709.
- 3 Dr. Mahmud Ahmed ez Zejjin, fq. 18 “Dua ja pas namazit obligativ sunet apo bidat?”
- 4 Buhariu në Sahihun, v.1, f.168 nr. 843, Muslimi në Sahih, 595.
- 5 Abdullah ibën Abdurrahman el Xhibrin “Risalet fi meshruijet ed Dua bades-salah” fq. 38-39.
- 6 Muslimi në Sahih, nr.135 (591), Ibën Hibani nga Aliu r.a. me titull: “Dhikri i rekomanduar që t'i kërkohej Allahu xh.sh. pas namazi” duke thënë: Pejgamberi a.s. kur e përfundonte namazin thoshte: “O Zot më fal...” Ebu Davudi, 1509 në kapitullin: “Çfarë thotë njeriu pas selamit?”
- 7 Tirmidhiu 212 dhe thotë se hadithi është hasen-sahih, Ebu Davudi 251, Ahmedi 3/115, Nesaiu në Kubra 9895.
- 8 Muslimi në Sahih, nr. 137, Buhariu në Sahih nr. 844, Ebu Davudi në Sunen, nr. 1505.
- 9 Muslimi në Sahih, nr. 137, Buhariu në Sahih nr. 844, Ebu Davudi në Sunen, nr. 1505.
- 10 Buhariu në Sahih, kapitulli “Feda’ilul Kuran” nr. 4986.

Tefsiri në veprën e fikhut “Risala” të Imam Shafiut¹

• Dr. Xhemaludin Latiq


BIOGRAFI E SHKURTËR E IMAM SHAFIUT²

Ebu Abdullah Muhamed b. Idris esh Shafi u lindi në Gaza (Palestinë) në vitin 150 h./767 - po atë vit kur ka vdekur fakihu që do të përcaktonte në mënyrë të konsiderueshme rrugën e tij të mendimit dhe të jetës, Ebu Hanife. I përkiste fisit Kurejsh. Ishte Hashimij dhe i afër i largët i Muhamedit a.s. Në fëmijërinë e tij të hershme u bë hafëz i Kuranit, pas së cilës ai mësoi përmendsh edhe librin e famshëm të së drejtës islame nga Malik b. Enesi – *El Muvetta'*. Kaloi shumë kohë me beduinët dhe u njoh rrënjësisht me poezinë e lashtë arabe. Dashuria e tij për Imam Malikun e çoi atë në Medinë, para mësuesit të tij të parë të madh, nga i cili mësonnte dhe u avancoi deri në vdekjen e Imam Malikut. Vdiq në vitin 204 h./820, kurse u varros në Fustat.

NISMA DHE BURIMET E “RISALAS”

Sipas biografëve të Shafiut, duket se kishte dy versione të “Risalas” së tij, versioni i vjetër dhe i ri. Me sa duket, Shafi u plotësonte, korrigjonte dhe redaktonte vetë pjesët e tekstit ose kapituj të tërë. I pyetur për këtë çështje lidhur me veprën e shënuar të Shafiut, Ibën Hanbeli ka thënë: “Librat që i shkroi Shafi u në Irak janë shumë larg përsosmërisë; vetëm kur u vendos në Egjipt, i rishkroi dhe i ripunoi.”³ Diskutimet e versioneve të këtij dhe librave të tjerë të Shafiut janë të gjata dhe të hollësishme, gjë që nuk është temë e këtij shkrimi. Një pyetje më e rëndësishme është frymëzimi i Shafiut për të shkruar këtë libër dhe burimet që ai përdori për ta shkruar atë. Biografët e tij pohojnë se Imam Shafi u njoh me veprat e pothuajse të gjithë juristëve të kohës së tij, dhe vetë Shafi, veçanërisht në veprën e tij *Kitabu'l-um*, thotë se ai kishte diskutime shkencore me fukahatë e tjerë, si *Evzaiu*, *Maliku*, *Ebu Jusufi* dhe *Muhamed esh Shejbani*.

Burimet kryesore të “Risalas” së tij janë *Kurani*, të cilin ai e mësoi përmendsh në moshën shtatë vjeçare, dhe *Muvetta'* e Imam Malikut, të cilën ai e mësoi përmendsh kur ishte dymbëdhjetë vjeç. Kurani ishte një frymëzim për Shafiun mbi dy baza: si një burim themelor i legjislacionit, Kurani i



siguroi atij materiale për legjislacion, dhe i paraqiti atij një ideal frymëzues sipas të cilit ky dijetar formësoi sistemin e tij juridik duke e harmonizuar atë sipas atij ideali. Shafiu në “Risalan” e tij trajtoi 220 ajete të Kuranit në të cilat gjen rregulla ligjore specifike ose shembuj nga të cilët nxori parime ligjore.

Burimi i dytë mbi të cilin mbështetet Imam Shafiu është suneti i të Dërguarit të Allahut a.s.. Versioni i vjetër i “Risalas” ishte shkruar, ndër të tjera, me qëllim të mbrojtjes së shkollës tradicionale juridike, kurse në versionin e ri të librit të tij, Shafiu jo vetëm që hulumton në sunetin si burim të dytë të së drejtës islame, por edhe për të nxjerrë prej tij parimet e veta dhe parimet juridike. Shafiu citon mbi njëqind hadithe, kurse disa prej tyre i përsërit si shembuj për pikëpamje të ndryshme. Shumica e këtyre haditheve, duket se Shafiu i kishte marrë nga mësuesit e tij, para të cilëve kishte mësuar në Medinë. Më i madhi prej tyre është, sigurisht, *Maliku*, pastaj *Suffan b. Ujejni*, *Abdulaziz Daravardi*, *Ibën Ebi Fudejku* etj.

Pasi u transferua në Egjipt, Imam Shafiu pranoi borxhin e tij shkencor ndaj *Ebu Hanifes* dhe *Muhamed esh Shejbanit*.

IDETË THEMELORE TË “RISALAS”

“Risala” fillon me kapitullin në të cilin flitet për themelet fetare të jurisprudence islame. Pas falënderimit ndaj Allahut xh.sh. dhe salavateve e selameve mbi Muhamedin a.s., familjen dhe sahabët e tij, Shafiu thekson se njerëzimi, në kohën para thirrjes së Muhamedit a.s., ishte i ndarë në dy klasa. Klasa e parë përbëhej nga ata që nuk besonin në Zot dhe që adhuronin idhujt, bustet prej guri dhe objekte të tjera në natyrë, dhe klasa e dytë përbëhej nga “njerëzit e Librit”, të cilët besonin në Zot dhe në mësimet e pejgamberëve të mëparshëm të Zotit, por i kishin ndryshuar dhe shtrembëruar parimet që u shpallën nga Zoti. Për shkak të këtij besimi të shtrembëruar, i Plotfuqishmi vendosi të dërgojë pejgamberin e Tij të fundit, Muhamedin a.s., detyra e të cilit ishte që të ripërtërijë besimin e drejtë dhe të rikonstruktonte njerëzimin në një komunitet që do t’i bindej Krijuesit të tij duke përmbushur parimet e ndryshuara të Zotit.

Shafiu shkurtimisht diskuton qëndrimin e Kuranit në Islam dhe detyrimin e myslimanëve për t’iu përmbajtur rregullave të Allahut xh.sh., dhe Pejgamberit a.s., dhe është obligim

për secilin që kërkon njohuri juridike ta nxjerrë atë nga Libri i Allahut dhe suneti i pejgamberit të Tij.

Kapitulli i dytë i “Risalas” i kushtohet një diskutimi mbi natyrën e dispozitave juridike në Kuran me titull *El Bejan* (Shpjegimi i qartë). Shafiu thotë se *El Bejan* është një term kolektiv që përfshinë parimet e përgjithshme si dhe parimet e hollësishme të së drejtës islame dhe e ndan atë në pesë kategori. Në kategorinë e parë përfshihen dispozitat specifike në tekstin e Kuranit, të cilat janë obligimet bazë ndaj Allahut xh.sh. (*deklarimi i shehadetit, namazi, agjërimi, zekati dhe haxhi*); në kategorinë e dytë përfshihen dispozitat, mënyrat e kryerjes së të cilave i shpjegoi Pejgamberi a.s., në sunetin e tij (si numri i namazeve të përditshme, shuma e cila duhet të ndahet si zekat, etj.); në kategorinë e tretë përfshihet një numër i madh dispozitash që Pejgamberi a.s., i shpjegoi në detaje; në kategorinë e katërt përfshihen të gjitha dispozitat që Pejgamberi a.s., i mori në mungesë të një teksti specifik kuranor për to; dhe në kategorinë e pestë, kategorinë përfundimtare janë dispozitat deri në të cilat është arritur me *ixhtihad* përmes *kijasit* apo analogjisë.

Vetëm një studim i mprehtë i tekstit kuranor nga pikëpamja juridike, siç ka treguar Imam Shafiu, mund të çojë në gjykimin se parimet dhe principet kuranore mund të klasifikohen në kategori të ndryshme. Në fillim, Shafiu i ndau të gjitha këto parime në përgjithësi dhe ato me një shtrirje individuale. Disa prej tyre, thotë Shafiu, janë të përgjithshme dhe kanë synimin e përgjithësimit, dhe ato përfshijnë rregulla specifike, individuale. Por ka edhe ato parime kuranore sipas të cilave bien edhe parimet e përgjithshme ashtu edhe ato individuale, ashtu siç ka dispozita të tilla kuranore që kanë për intencë të jenë individuale.

Pas kësaj, Shafiu e ndau legjislacionin kuranor në një grup të ndryshëm kategorish. Sipas mendimit të tij, ka parime të përgjithshme, kuptimi i të cilave bëhet i qartë nga konteksti në të cilin gjenden, dhe ka nga ato në të cilat teksti i tyre tregon për kuptimin e tyre implicit. Në kategorinë e tretë bëjnë pjesë ato dispozita kuranore që vetëm suneti mund t’i specifikojë si të përgjithshme ose si të veçanta.

Duke i ndarë ajetet legjislative kuranore në këtë mënyrë, Shafiu dha një kontribut të madh në kuptimin e Kuranit si burim i së drejtës islame. Menjëherë pas një vështrimi të tillë fakih në Kuran, ai u dha në një klasifikim të ngjashëm të sunetit të Pejgamberit a.s., ku tregoi edhe origjinalitetin e jashtëzakonshëm

Vetëm një studim i mprehtë i tekstit kuranor nga pikëpamja juridike, siç ka treguar Imam Shafiu, mund të çojë në gjykimin se parimet dhe principet kuranore mund të klasifikohen në kategori të ndryshme.

të mendimit. Mexhid Huduriu madje thotë se, sipas pikëpamjes së tij fakihe ndaj sunetit, Shafiu e dha kontributin më të madh në jurisprudencën islame. Suneti, sipas mendimit të Shafiut, së pari shfaqet si shpjegues i disa ajeteve të qarta dhe atyre të dykuptimta dhe më pak të qarta. Pikërisht në sunet, Shafiu bënë një distancë të barabartë ndaj shkollës irakiane ashtu edhe ndaj shkollës juridike hixhaze. Sipas mendimit të tij, të dyja shkollat shpesh i kanë pranuar hadithet ose sunetin e Pejgamberit a.s., në legjislacionin e tyre, të cilat bazohen në zakonet lokale, Shafiu beson se vetëm një traditë autentike nga Pejgamberi a.s., mund të jetë e detyrueshme dhe të përdoret për të përbërë një burim legjislativ autoritativ. Shafiu bën një dallim të qartë midis transmetimit autentik të Pejgamberit a.s. dhe atij narrativ, i cili lindi si rezultat i mendimit të njërit prej sahabëve apo fukahave kryesorë; ky i fundit mund të merret vetëm për të shpjeguar kuptimin e tekstit, por ai nuk mund të merret si detyrues.

Për sa i përket *nes'hit* (derogimit, abrogimit ose shfuqizimit të dispozitave), Shafiu jep gjithashtu një kontribut origjinal në shkencën e përgjithshme të Islamit.

Në një pjesë të legjislacionit të tij, Kurani me të vërtetë shfuqizon disa nga dispozitat që kishte miratuar më parë, duke ruajtur ende këto ajete dhe ato dispozita në tekstin e tij. Suneti, konsideron Shafiu, mund të sqarojë vetëm shfuqizimet ose ajetet në të cilat një dispozitë e caktuar është shfuqizuar, por ai refuzon mendimin e Ebu Hanifes se suneti (autentik) mund ta derogojë ndonjë dispozitë në Kuran.

Sipas Shafiut, as Kurani nuk e derogon direkt sunetin, por Pejgamberi a.s., gjithmonë nxjerr një sunet të ri, në përputhje me legjislacionin kuranor në ato raste kur legjislacioni kuranor ishte në kontradiktë me sunetin e mëparshëm.

Koncepti i sunetit të Shafiut përfshin thëniet dhe vendimet e Pejgamberit a.s. Megjithatë, suneti nuk është në të njëjtin nivel sikur shprehja kuranore. Prandaj, përkundër kësaj, Krijuesi na kërkon t'i bindemi Pejgamberit të Tij sikur që i bindemi Atij, dhe anasjelltas - mosbindja ndaj Pejgamberit a.s., është mosbindja ndaj Allahut xh.sh..

Në "*Risalan*", në një kapitull të veçantë, diskutohet për sunetin autentik që është transmetuar nëpërmjet një zinxhiri autentik transmetuesish. Një risi e veçantë në pikëpamjen e tij për sunetin është se Shafiu beson se nuk ka asnjë kontradiktë midis traditave të Pejgamberit a.s. Kontradiktë mes tyre shfaqet tek ata që nuk i dinë rrethanat në të cilat janë shqiptuar këto tradita dhe që nuk e kuptojnë se disa tradita i përcaktojnë të tjerat më nga afër. Kështu që, Shafiu kontribuon në faktin se ka të ngjarë që shumë dyshime në lidhje me sunetin e që kanë brengosur mendimin juridik islam mund të zgjidhen.

Metoda e tij është pajtuese, e quajtur *te'vil* (interpretim), me anë të së cilës studiuesit inkurajohen të pranojnë shumë nga transmetimet e Pejgamberit a.s., pa pasur frikë se mos refuzohen.

Në kapitujt vijues të "*Risalas*" së tij, Shafiu, me jo më pak kujdes, diskutoi për *ixhma'ain* (konsensusin), *kijasin* (analogjinë), *ixhtihadin* (mendimin personal), *istihsanin* (preferencën juridike ose përparësinë për diçka) dhe *ihtilafin* (mosmarrëveshjen shkencore). Lidhur me konsensusin, Shafiu evoluoi nga mendimi i Imam Malikut, sipas të cilit *ixhma'* është marrëveshja e dijetarëve lokalë për ndonjë çështje, deri në atë mendim (i cili, për shekuj më vonë, do ta marrë Muhamed Ikbali) për cilin *ixhma'*ja është pëlqimi i të gjithë komunitetit mysliman për ndonjë çështje. Duke interpretuar hadithin e mirënjohur "ymeti im nuk do të pajtohet kurrë në gabim", Shafiu thotë se - sipas pikëpamjes së tij për *ixhma'* - kjo i referohet parimeve themelore, dhe kurrësi në detaje dhe atyre pyetjeve që u lihen dijetarëve.

Dhe si përfundim, Shafiu i reziston dhe i afrohet Ebu Hanifes kur diskuton për *ixhtihadin* dhe *kijasin*. Shafiu, në jurisprudencën islame, kufizon përdorimin e rezonimit të vet duke hedhur poshtë atë arsyetim që nuk është kufizues. Ai i përdor konceptet e *ixhtihadit* dhe *kijasis* në mënyrë të ndërsjellë dhe jo me shumë kujdes, por, përkundër kësaj, është mjaft e qartë se ai lejon rezonimin e tij vetëm nëpërmjet analogjisë, por analogjia (*kijasi*) duhet të jetë gjithashtu në përputhje me frymën dhe dispozitat dhe parimet e përgjithshme të Sheriatit. Në këtë mënyrë, Shafiu ka arritur një ekuilibër shumë të nevojshëm midis atyre që e përdorin gjerësisht *kijasin* dhe atyre që e refuzojnë atë krejtësisht.

Përktheu dhe përshtati nga gjuha boshnjake:

Dr. Azmir Jusufi

1 <https://islam.ba/teme/islamske-nauke/tefsir-u-fikskim-djelima-osnivaca-mezheba-imam-i-safi-i-njegova-risala>.

2 Më gjerësisht për biografinë dhe bibliografinë e Shafiut, shih në: Maxhid Hadduri, *Jurisprudence – Shafi'i's Risala*, Translated with an Introduction, Notes and Appendices, Baltimore, 1961. (Studimi i Hadduriut na shërbeu si burim kryesor për të shkruar këtë punim). Shih gjithashtu burimet klasike islame për të njëjtën temë: Ibën Ebi Hatim er Razi, *Kitab Adab esh Shafi'i ve Manakibuh*, Kajro, 1953; Ebu Bekër Ahmed b. el Husejn b. Ali el Bejheki, *Kitab Manakib el Imam esh Shafi'i*, Kajro; El Fahr er Razi, *Kitab Manakib el Shafi'i*, Kajro; Ibën Haxher el Askalani, *Tavali el Ta'sis bi Me'ali ibën Idris*, Kajro, 1301/1883, etj.

3 Hadduri, *vep. e cit.*, 25, sipas Ibën Ebi Hatim er Raziut, 60.

E drejta e punësimit për gruan në mes të realitetit të hidhur dhe kornizës juridike islame

• **Nada Dosti**

Ai lejohet gruas të punojë jashtë shtëpisë? Përgjigja e shkurtër është *po* dhe hukmi për të është *mubah*, sipas shumicës së dijetarëve, por sipas rrethanave mund të kthehet në *e pëlqyeshme*; *e këshillueshme*, nëse ajo kthehet në përgjegjësen financiare të vetes, apo ka nën kujdestari pasardhës; mund të kthehet edhe në *e ndaluar*, në rast se burri vetë ia ndalon (por në të njëjtën kohë ai i përgjigjet gjithashtu për nevojat bazike). Përgjigja e gjatë është shumë herë më komplekse dhe ka të bëjë me rrethanat dhe kushtet, rendin social, rolet gjinore në shoqërinë ku jeton, rreziqet që i kanosen etj..

Së pari duhet të sqarojmë se, përkundër ideologjisë feministe e cila “e detyron” gruan të dalë jashtë shtëpisë, dhe sipas së cilës një grua patjetër duhet të ketë karrierën dhe punën e saj, qoftë e punësuar diku, qoftë e vetëpunësuar për t’u konsideruar e fuqizuar si grua, në konceptin islam fuqizimi i gruas nuk matet me punësimin e saj, por me parametra dhe vlera të tjera.

Në Islam, gruaja nuk e ka për detyrë të punojë, por është e lirë të zgjedhë nëse dëshiron të ushtrojë njohuritë e veta dhe profesionin e vetë. Për t’ia larguar këtë detyrim gruas si kontribuuese në financat e

shtëpisë ekzistojnë institucione të ndryshme që teorikisht ia largojnë këtë barrë për të qenë bukë-fituese e plotë ose e pjesshme (50-50), siç janë e drejta e trashëgimisë, detyra e burrit për të qenë “kauam” – përgjegjësi financiar i saj; përfituesja primare e sadaksë së burrit, kjo mbështetur në hadithin që sadakaja më e mirë është ndaj familjes. Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a., se Profeti a.s., ka thënë: “*Dinari më i mirë është ai që ia jep familjes tënde.*”

Por disa dijetarë të medhehbit hanefi kanë lejuar daljen për punë nëse nuk ka ndonjë dëm apo rrezik, sepse në këtë rast (pra nëse do të kishte rreziqe), kjo do të kufizonte të drejtën e saj dhe do të komprometonte statusin e saj. (En Nevevi, 1392 hixhri).

Sipas imam Malikut dhe imam Shafiut, burri ka të drejtë ta ndalojë gruan së punuari nëse natyra e punës është fyese ose rrezikuese dhe në këtë rast, nëse ia kërkon bashkëshorti i saj që ta lejë punën, ajo duhet ta lejë, sepse cenon të drejtën e burrit (El Mudawana el Kubra, 2005). Nga ana tjetër, hanbelitë janë të mendimit se gruas nuk i lejohet të punojë pa lejen e valiut (kujdestarit) të saj edhe kur ka nevojë të madhe për këtë, sepse ajo nuk është përgjegjëse për ta mbajtur barrën financiare.

Islami, si fe universale, përpiqet të vendosë balancë në bazë të rrethanave, llojit dhe mentalitetit të shoqërisë, si dhe botëkuptimit të secilit individ dhe preferencave personale.



Gratë nuk lejohen t'i ofrojnë shërbimet e tyre askujt pa lejen e valiut (kujdestarit). (El Nevevi, 1392 hixhri).

Në mbështetje të këtij mendimi ata argumentohen se: “Edhe në rituale të ndryshme, të cilat kërkojnë daljen nga shtëpia, veçanërisht atyre që janë të detyrueshme për meshkujt, për gratë u është lënë në dorë të zgjedhin, si për shembull, falja e namazit të xhumasë, pesë vaktet në xhami, namazi i xhenazes, apo edhe xhihadi, të cilat nuk janë obligim për gratë.” Nga ana tjetër çdo përpjekje për ta ndaluar gruan që të vizitojë xhaminë dhe të falet në të më xhemat ose jo, çka nënkupton edhe daljen nga shtëpia në këtë rast, është e qortuar. Kjo sipas hadithit: “Mos i ndaloni robërshat e Allahut nga vizita e shtëpive të Zotit.” (Sahih Buhari, 900). Këto nuk janë mendime kundërthënëse, por mënyra se si Islami, si fe universale, përpiket të vendosë balanca në bazë të rrethanave, llojit dhe mentalitetit të shoqërisë, si dhe botëkuptimit të secilit individ dhe preferencave personale.

Le të përqendrohemi pak tani te realitetit i hidhur i krijuar nga të ashtuquajtur rend liberal, i ngjyer me politika feministe dhe kapitaliste. Duke marrë parasysh angazhimet dhe përgjegjësitë e grave në shoqëri të tilla, sindikata dhe punëdhënësit në ShBA dhe Britani kanë pas bërë disa përpjekje në lidhje me punën fleksibile në vitet 1960, si një mënyrë për t'ua lejuar grave profesioniste të qëndronin në fuqinë punëtore të paguar pas lindjes së fëmijëve. Nga mesi i viteve 1970, hulumtimet nga Komuniteti Ekonomik Evropian sugjeruan se orët fleksibile ishin masa e vetme që kishte më shumë gjasa të përmirësonte mundësitë profesionale të grave. Ndërkohë, një valë e re presioni shoqëror për të drejtat e grave po përfshinte si Evropën ashtu edhe ShBA-të. Në këtë kontekst, aktivistet feministë, kuptuan për herë të parë në

mënyrë të qartë praktikat e punës fleksibile me shpresën për një shoqëri më të barabartë. Mirëpo në vitet 1970, rritja e kostove të jetesës dhe stanjacioni i pagave nënkuptonin që të ardhurat e një burri të vetëm që siguronte bukën e gojës për familjen po bëheshin të pamjaftueshme për të mbështetur një familje të tërë, dhe gjithnjë e më shumë gra nisën punë për të siguruar jetesën. Midis viteve 1951 dhe 1971, përqindja e grave të martuara që ishin në fuqinë punëtore shkoi nga 22 në 42%. Kjo vazhdoi të rritej vetëm në vitet 1980 dhe më tej.

Ndërsa gratë u bashkuan me grupe aktivistesh, reflektuan gjithashtu mbi vështirësinë e kombinimit të punës së paguar me punën e përkujdesjes në shtëpi, pra ajo që njihej me “turni i dytë”. Gjatë viteve 1970 dhe 1980, feministët mbështetën futjen e orareve fleksibël, për punën nga shtëpia dhe për ide të tilla si “puna me orar të shkurtuar” dhe “punë e ndarë me të tjerët”. Ato shpresonin që këto politika të reja do të rrisnin barazinë në mundësitë e punësimit për gratë, do të përmbysnin ndarjen gjinore të punës në shtëpi dhe do të sfidonin pikëpamjet tradicionale rreth punës së paguar. Programi ishte njëkohësisht pragmatik dhe utopik. Ideja ishte të hapej punësimi me kohë të pjesshme në një gamë teorikisht të pakufizuar profesionale. Punë e ndarë me të tjerët (kur dy persona mbulonin një punë full time) do të thoshte më pak orë pune dhe mundësi që nënat të qëndronin në punë të paguar pa humbur përfitimet ose statusin. Në të njëjtën kohë, kjo do të sfidonte hegjemoninë e asaj që aktivistet e shihnin si një javë pune 40-orëshe nga ora 9 deri në 5, e cila i akomodonte mirë shumicën e burrave, por që në thelb kishte dështuar në raport me kujdesin për fëmijët. Si atëherë, si ndoshta edhe në ditët e sotme, meshkujt të cilët punojnë full time, pra 9 me 5, pasi kthehen në shtëpi nuk bëjnë punë shtëpie, as nuk kujdesen për fëmijët dhe as për prindërit që kanë në kujdestari. Kjo detyrë i përkiste dhe vazhdon në shumicën e rasteve t'i përkasë grave. Nëse do të donim të bënim avokatin e feministëve, mund të themi se nijeti (qëllimi) i tyre mund të ketë qenë i mirë, problemi çalonte se në vend që të merrej vetëm me gratë duke i “detyruar” apo nxitur ato të dalin nga shtëpia, të mendojnë për një karrierë të tyre, dështuan së ndryshuari një sistem të tërë. Një sistem ku politikat dhe mentaliteti dhe sidomos sjelljet e një shoqërie nuk e përkrahin daljen e gruas në punë. Po të kishte kopshte dhe çerdhe falas, dado falas, shërbim infermierik falas për prindër ose vjehrrin nën kujdestari, baballarë dhe gjyshër të përkushtuar për punët e shtëpisë apo bashkërritjen e fëmijëve apo shërbim falas pastrimi për gratë në punë, pra thënë shkurt një botë utopike, e cila e mbështet

në çdo detaj gruan që punon jashtë, atëherë reforma dhe politika të tilla nxitëse edhe mund të kishin pasur sukses. E njëjta gjë nuk vlen për meshkujt, sepse nëse një mashkull do të dojë të përparojë në karrierë, i gjithë sistemi është aty gati për ta bërë për të. Nëse është ende beqar për të përkujdesen gratë e shtëpisë si nëna dhe motrat, duke iu ofruar “shërbime” si pastrim shtëpie, larje hekurosje rrobash, gatim ushqimi. Pasi martohet, të njëjtat ia ofron bashkëshortja, e cila gjithashtu përkujdeset edhe për persona të tjerë nën kujdesje, qofshin këta fëmijët e tyre, prindërit e saj apo prindërit e tij.

Qendra Kërkimore Peë, zbuloi se 56% e grave thonë se e kanë të vështirë të balancojnë përgjegjësitë e punës dhe të jetës në shtëpi. Duke përhapur mitin se gratë “mund t’ia dalin me të gjitha” pa bërë kompromise, lëvizja feministe e minimizoi faktin se të qenit nënë është një punë me kohë të plotë, jashtëzakonisht e vështirë dhe kuptimplote, veçanërisht në vitet e para të një fëmije, të cilës nëna i dedikohet shpirtërisht, psikikisht dhe fizikisht. Ndërsa babai mund të kujdeset vetëm për shpenzimet financiare, nëna është aty prezentë duke sakrifikuar nga trupi vetë, gjumi i vetë dhe duke ia dedikuar të gjitha energjitë kësaj qenie të re që varet prej saj 7/24.

Për këtë arsye, duke marrë parasysh të gjithë këta faktorë, mund të arrijmë në përfundimin se mes një rendi liberal, i cili e detyron gruan të dalë nga shtëpia, të sakrifikojë familjen dhe mbi të gjitha fëmijët, thjesht për të pasur një karrierë duke dështuar në krijimin e një sistemi dhe shoqërie të tërë, e cila e ndihmon dhe e përkrah në këtë karrierë, rendi islam përpiqet të vendosë një balancë. Gruan nuk e detyron, por e lejon nëse ajo dëshiron, të dalë nga shtëpia dhe të kontribuojë në shoqëri me talentet e saja dhe njëkohësisht të jetë një burim shtesë të ardhurash për familjen e saj. Gjithmonë nëse ajo dëshiron, përndryshe fitimet e veta mund t’i mbajë për vete dhe t’i shpenzojë si do ajo, qoftë dhe nëse dëshiron t’i dhurojë të gjitha në bamirësi. Madje dhe në bamirësi ajo nuk është e nxitur që ta bëjë këtë të familja e saj, ashtu siç është i nxitur burri.

Pavarësisht se çfarë praktikohet në vendet islame, për shkak të kulturës dhe traditave përkatëse, në Islam, teorikisht gruaja nuk është e detyruar të bëjë punët e shtëpisë. Nëse i kanë mundësitë financiare, burri obligohet të paguajë një ndihmëse, madje edhe një mëkonjëse për gjdhënie e fëmijës. Në traditën islame, burrë e grua janë të dy të angazhuar me punët e shtëpisë, argument për këtë kemi

Mes një rendi liberal, i cili e detyron gruan të dalë nga shtëpia, të sakrifikojë familjen dhe mbi të gjitha fëmijët, thjesht për të pasur një karrierë duke dështuar në krijimin e një sistemi dhe shoqërie të tërë, e cila e ndihmon dhe e përkrah në këtë karrierë, rendi islam përpiqet të vendosë një balancë.

faktin se në transmetime të ndryshme tregohet se vetë Profeti a.s. ka pas bërë punë shtëpie si për shembull arnojsa e rrobave të veta (që ditët e sotme në mungesë të një nevojë të tillë mund të përkthehet si palosja apo hekurosja e rrobave të veta), pritja dhe qerasja e mysafirëve, përkujdesja ndaj fëmijëve madje dhe ndaj nipërve. Në rastin e historisë kur Fatimja dhe Aliu r.a. iu ankuan për punët e shumta dhe të rënda, ai iu drejtua të dyve duke thënë: “Do t’ju tregoj se si t’u lehtësohet kjo barrë.” Pra jo vetëm që të dy iu drejtuan atij, pra jo vetëm Fatimja (çka nënkupton se barrën e punëve e ndanin të dy), por dhe kur iu drejtua Profeti, nuk iu drejtua veç Fatimes, por të dyve (çka përsëri e përforcon faktin se të dy janë përgjegjës për këto punë).

Një tjetër ngjarje në kohën e kalifit Omer r.a., vërteton mungesën e roleve gjinore në shoqërinë islame të asaj kohe. Bëhet fjalë për rastin kur një natë, gjatë inspektimeve të rrugëve të Medinës përballet me një çift në nevojë. Vetë kalifi nis të rrëmbëjë kazanin e të gatuarë ushqim, ndërsa bashkëshortja e tij bën maminë për gruan, e cila do të priste një foshnje shumë shpejt. Kështu i ndau punët

kalifi me gruan e tij, njëri gatimin, e tjetri infermierinë. Shembuj të tillë ka plot dhe na bëjnë të reflektojmë se kultura islame, parimet dhe praktika islame, ndryshojnë shumë nga tradita që aplikohet në vendet islame. Dhe si gjithmonë Islami mund të ishte zgjidhje në çdo fushë të jetës, sikur vetëm të mund ta aplikonim atë si duhet.

Autorja është hulumtuese pranë Institutit të Mendimit Islam (IDE).

Bibliografia:

- Al Nawawi, *Al-Minhaj fi Sharh Sahih al Muslim, Dar Ihya al-Turath al-Arabi, Bejrut, 1392, AH.*
- Parker, K., & Parker, K. (2024, April 14). *Modern parenthood. Peë Research Center.*
- *Sahih al Bukhari, hadithi 900.*
- *Sahñun, Abd as Salām al Mudawwana al-kubrā li-āl-Imām Mālik Dar Sader, Bejrut, 1433, AH.*
- Stoller, S. (2021, April 8). *How did flexible work turn from a feminist ideal to a trap? | Aeon Essays.*

“Big Brother” – Shpërfaqja e një mentaliteti të shtypur rreth moralit, kombit dhe fesë së shqiptarëve

• Arben Desku

Shqiptarët thuhet se tradicionalisht janë njohur si popull tolerant. Epo, ndoshta janë njohur si popull tolerant, por ata që praktikisht kanë bartur në supet e tyre barrën e tolerancës shqiptare kanë qenë myslimanët shqiptarë gjithandej Gadishullit. Thellësisht, sado e kanë ditur sa jo tolerante janë grupet e tjera fetare në popullin shqiptarë, myslimanët shqiptarë si “vëlla i madh”, si shumicë, kanë zgjedhur t’i durojnë, mos përfillin, të bëjnë veshin shurdh ndaj ndasisë, fyerjeve, nënçmimit e poshtërimit që grupet fetare të shqiptarëve jomyslimanë i kanë bërë ndaj tyre. Por, a po del kjo gjë nga kontrolli?

Shqipëria dhe Kosova organizojnë “Big Brother”. Një nga emisionet më degjeneruese që mund t’i servohet një populli në ekran. Një “reality show” që dështon në shoqëritë e emancipuara dhe lulëzon në shoqë-

Shqipëria dhe Kosova organizojnë “Big Brother”. Një nga emisionet më degjeneruese që mund t’i servohet një populli në ekran. Një “reality show” që dështon në shoqëritë e emancipuara dhe lulëzon në shoqë-





ritë në tranzicion. Në Japoni dështoi qysh në sezonin e parë, pasi interesimi për ta parë dhe votuar ishte nën minimale. Ndërkohë ky program lulëzon në Brazil. Paramendoni sa larg Japonisë jemi si shoqëri, dhe sa afër Brazilit! Përveçqë ky emision promovon degjenerim moral, nuditet (zhveshje), keqinterpretim dhe devijim të qëllimshëm të temave të rëndësishme shoqërore, shqiptarët, si ndjekës të “devotshëm” të këtij programi, i goditi dhe u nxori për lëndinë urrejtjen krahinore e fetare. E nxori kështu aq hapur, sa në internet gjithandej vlonin e vazhdojnë të vlojnë komentet e shqiptarëve nga Kosova, si: “Ne jemi kosovarë, jo shqiptarë. Këta janë grekë. Nuk e duam Shqipërinë. Bojkotoni Shqipërinë...”, etj., dhe pastaj mirditorët “hiper-kombëtar” shpërfaqën urrejtjen fetare ndaj myslimanëve shqiptarë të Kosovës, si: “Rracë turku e arabi. Mirë ua ka bo shkau që u ka vra fminë e dhunu gratë. Ju jeni serbë. Ju nuk jeni shqiptarë...”, etj.. Tmerr, por realitet. Tingëllonte më shumë si një urrejtje e akumuluar, jo e momentit.

Ajo që u pa, ishte se shqiptarët e Kosovës nuk sulmuan “mirditorët” sepse ishin të krishterë, në asnjë rast. Ndërkohë të krishterët e Shqipërisë (disa e sigurisht se jo në tërësi e as të gjithë prej tyre), sulmuan myslimanët e Kosovës për shkak të fesë së tyre, madje duke kaluar në ekstrem, duke u renditur në anën e serbëve, madje duke

Përdhosja me apo pa qëllim e simboleve fetare të kujtdo është gjë e dënueshme. Po ashtu, rreptësisht e dënueshme është edhe tërheqja e paraleles mes “Allahu ekber - Zoti është më i Madhi” me thirrje terroriste. Këto na i solli ky “reality show”, na i servoi dhe dogji një popull të tërë në zjarrin që ndezi.

arsyetuar dhe duartrokitur mizoritë e tyre ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Sidoqoftë, përdhosja me apo pa qëllim e simboleve fetare të kujtdo është gjë e dënueshme. Po ashtu, rreptësisht e dënueshme është edhe tërheqja e paraleles mes “Allahu ekber - Zoti është më i Madhi” me thirrje terroriste. Këto na i solli ky “reality show”, na i servoi dhe dogji një popull të tërë në zjarrin që ndezi. Zjarr ky nga i cili duhet pasur kujdes, pasi po shihet që nga momenti në moment mund të shndërrohet në një fatkeqësi shoqërore që mund ta rrëmbejë kombin.

Programet e tilla degjeneruese, që po tregohen të rrezikshme për mirëqenien kombëtare dhe fetare të popullit, duhet të ndalohen orë e më parë. Populli duhet shëruar, jo sëmurë. Njerëzit kanë nevojë t'i mbajnë interesin dhe shpresat në gjëra përparimtare, jo të burgosen në çeli të problemeve mendore, dramave të stisura televizive, dhe problemeve të përçarjes dhe urrejtjes që servohen në këto programe. E nëse shtetet tona nuk i ndalojnë, ndaloj ti! Mos i shiko!



Të drejtat e punëtorëve në mes të konventave të drejtave të njeriut dhe realitetit aktual

• Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi

Të drejtat e njeriut janë të drejta universale, ato të janë të pandashme dhe janë të patjetërsueshme me të cilat lind njeriu si qenie sociale – biologjike. Të drejtat e njeriut janë të drejta të qenësishme për të gjitha qeniet njerëzore, pavarësisht nga raca, gjinia, kombësia, etnia, gjuha, feja ose çdo status tjetër. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, në nenin 1 të saj, nënvizon se “të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me frymë vëllazërimi”.¹ Sipas profesorit Stephen P. Marks nga Universiteti i Harvardit, të drejtat e njeriut “përbëjnë një grup normash që rregullojnë trajtimin e individëve dhe grupeve nga shtetet dhe aktorët joshitetërorë... Këto norma janë të inkorporuara në sistemet ligjore kombëtare dhe ndër-kombëtare, të cilat specifikojnë mekanizmat dhe procedurat për t’i mbajtur përgjegjësit përgjegjës dhe për të siguruar dëmshpërblim për viktimat e supozuara të shkeljeve të të drejtave të njeriut.”² Të drejtat e njeriut përshkruhen si ato të drejta “që gëzohen nga njerëzit për shkak të humanizmit të tyre. Ato janë të drejta pa të cilat ekzistenca e një personi do të konsiderohej më e vogël se njerëzore”.³ Sot të drejtat e njeriut mund të ndahen në lloje të ndryshme, të cilat mund të kenë epitete të ndryshme, por që kanë një emërues të përbashkët, pra respektimi dhe avokimi për to. Grupimi i tyre mund të jetë në disa kategori: të drejtat civile, të drejtat politike, të drejtat ekonomike, të drejtat sociale dhe kulturore, si dhe të drejtat e njeriut të orientuara në zhvillim.

Ato kanë parimet dhe segmentet e tyre përmes së cilave karakterizohen, si:

Universale, pasi ato u përkasin të gjithë njerëzve në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga statusi dhe janë të njëjta për të gjitha qeniet njerëzore kudo në botë;

Patjetërsueshme, pasi ato nuk mund të hiqen ose transferohen; njerëzit ende kanë të drejta të njeriut edhe kur qeveritë e tyre i shkelin ato të drejta;



Të ndërlidhura-të ndërvuarura, pasi që përmbushja ose shkelja e një të drejte ndikon në përmbushjen e të gjitha të drejtave të tjera; së bashku të drejtat e njeriut formojnë një kornizë plotësuese;

Të pandashme, pasi asnjë e drejtë nuk mund të trajtohet veçmas; asnjë e drejtë nuk është më e rëndësishme se një tjetër;

Jodiskriminuese, pasi që të drejtat e njeriut duhet të respektohen pa dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në bazë të racës, ngjyrës, moshës, gjinisë, origjinës kombëtare ose etnike, gjuhës ose çdo statusi tjetër”.⁴

Duke u nisur nga këto karakteristika, mund të shohim se të drejtat e njeriut janë ato të drejta përmes së cilave shquhet qenia njerëzore, janë të rëndësishme pasi përmes respektimit dhe promovimit të tyre, fuqizohet kohezioni social dhe shoqëria ecë tutje, janë vlera dhe norma, pasi respektimi i tyre do të thotë respektim ndaj akteve vendore dhe ndërkombëtare, si dhe instrument matës i demokracisë së një shteti në raport me qytetarët e tyre.

SKALITJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Të drejtat e njeriut janë “të ngulitura thellë në vetëdijen tonë politike. Në përgjithësi sot është quajtur e sigurt se ka gjëra të mira, të cilat njerëzit kanë të drejtë t’i kenë dhe gjëra të këqija, të cilat ata mund t’i shpresojnë apo aspirojnë t’i shmangin”.⁵ Sot të drejtat e njeriut janë të rëndësishme, sepse janë pjesë e pandashme e shoqërisë. Ato mbrohen përmes konventave ndërkombëtare dhe kombëtare. Skalitja e të drejtave të njeriut që nga historia e deri më sot është përcjellë në vazhdimësi me shumë ndryshime, duke ngritur shumë pyetje dhe dilema filozofike, të cilat kohë pas kohe njerëzit dhe shoqëria në përgjithësi e kanë sakrifikuar edhe jetën, që ne sot t’i kemi këto të drejta dhe të njihen jo vetëm në aspektin lokal, por edhe në atë global. Sot një mori e organizatave joqeveritare anembanë botës i monitorojnë këto të drejta përmes mekanizmave të ndryshëm, përfshirë këtu organizatat, si: *Amnesty International*, *Human Right Watch*, etj.. Në kuadër të të drejtave të njeriut mund të ketë ndarje sipas grupeve apo

Në maj të vitit 1886, rreth 400,000 punëtorë në shumë pjesë të ShBA-së dolën në grevë, duke kërkuar një ditë pune tetorëshe.

llojeve të cilat sot promovohen, avokohen dhe respektohen ato nga shtetet amë.

TË DREJTAT E PUNËTORËVE DHE KONVENTAT NDËRKOMBËTARE

Kur flasim për të drejtat e punëtorëve, ato janë edhe të drejta të punës dhe në përgjithësi të drejta të njeriut, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punës në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit. Si të drejta janë të kodifikuara dhe normativizuar në legjislacionin vendor dhe atë ndërkombëtar. Këto të drejta kanë të bëjnë me punëtorët dhe fokus kanë kushtet e punës dhe raportin me punën, kjo pasi që koncepti i punës lidhet ngushtë me veprimtarinë, sigurinë, hapësirën dhe mjetet e punës. Të drejtat e punëtorëve janë të normuara përmes akteve dhe konventave ndërkombëtare. Kështu, të drejtat e punëtorëve në nivel ndërkombëtar janë përcaktuar në një sërë konventash dhe traktatesh për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (Nenet 23 dhe 24, 1948) dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966), të cilat parashikojnë:

E drejta e secilit (individ) për mundësinë për të fituar jetesën e tij me punë të cilën ai/ ajo e zgjedh ose e pranon lirisht;

Të drejtën për gëzimin e kushteve me të drejta dhe të favorshme të punës, në veçanti shpërblimin që u siguron të gjithë punëtorëve, si minimum, paga të drejta dhe shpërblim të barabartë për punë me vlerë të barabartë dhe një jetë të denjë për veten dhe familjet e tyre;

KUSHTET E SIGURTA DHE TË SHËNDETSHME TË PUNËS;

Mundësi të barabarta për këdo që të promovohet në punësimin e tij në një nivel të duhur më të lartë, duke mos pasur parasysh konsideratat e tjera përveç atyre të vjetërsisë dhe kompetencës;

Pushimi, koha e lirë dhe kufizimi i arsyeshem i orarit të punës dhe pushimeve periodike me pagesë, si dhe shpërblimi për festat publike;

E drejta e secilit për të formuar dhe anëtarësuar në sindikatat e zgjedhura të tij dhe e drejta për grevë, me kusht që ajo të ushtrohet në përputhje me ligjet e vendit të caktuar”.⁶

Me fjalë të tjera, mund të shohim se të drejtat e punës janë të drejta të njeriut të cilat kanë hy në funksion në shekullin XIX dhe XX, sidomos pas krijimit të organizatave të tilla si sindikata, të cilat rrodhën pas proceseve të periudhës së industrializimit. Duke parë rolin dhe rëndësinë e të drejtave të punëtorëve, kushteve të punës dhe proceseve të tjera, në maj të vitit 1886, rreth 400,000 punëtorë në shumë pjesë të ShBA-së dolën në grevë, duke kërkuar një ditë pune tetorëshe. Edhe pse protestat filluan në mënyrë paqësore, dhuna shpërtheu më vonë në Çikago, duke rezultuar me vrasjen e disa personave dhe dënues me vdekje ose burgim. Kjo ngjarje, e njohur si Çështja Haymarket, u bë një simbol ndërkombëtar i luftës për të drejtat e punëtorëve. Në fillim të vitit 1889, 1 maji u shpall Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve nga Kongresi i Dytë Ndërkombëtar i Punëtorëve Socialistë të mbajtur në Paris, si një datë për të shënuar këto ngjarje dhe për të demonstruar të drejtën për një ditë pune tetorëshe.⁷ Qysh nga ajo kohë e deri më tani, lëvizjet e punëtorëve në të gjithë botën kanë vazhduar të luftojnë dhe të fitojnë këtë të drejtë, dhe dita është zgjeruar duke u bërë një festë globale që feston arritjet e punëtorëve, përpjekjet për kushte të drejta pune dhe njohjen e rolit kritik të punëtorëve në shoqëri. Sot, Dita Ndërkombëtare e Punëtorëve, e njohur edhe si Dita e Punës ose Dita e Majit, festohet në mbi 160 vende dhe kryesisht mbahet më 1 maj, ose të hënën e parë të atij muaji. Pavarësisht faktit që sot konventat ndërkombëtare dhe legjislacionet vendore kanë avancuar dukshëm, punëtorët e profileve të ndryshme në shumë shtete, përballen me sfida dhe probleme të theksuara që nga: mungesa e të drejtave elementare të tyre e deri te format e vrazhda, diskriminimi, madje edhe përfundimi me fatalitet si rezultat i mungesës së sigurisë në punë. Deklarata e ILO-s mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë, e miratuar në vitin 1998 dhe e ndryshuar në vitin 2022, është një shprehje e angazhimit nga qeveritë, organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve për të mbështetur vlerat themelore njerëzore - vlera që janë jetike për jetën tonë sociale dhe ekonomike. Këto janë instrumente ligjore të hartuara nga përbërësit e ILO-s (qeveritë, punëdhënësit dhe punëtorët) përcaktojnë parimet dhe të drejtat bazë në punë. Organi Drejtues i ILO-s ka identifikuar tetë konventa si “themelore”, të cilat trajtojnë lirinë e shoqërimit, negociatat kolektive, shpërblimin e barabartë, mosdiskriminimin dhe eliminimin e punës së detyruar dhe të fëmijëve.⁸ Gjithashtu, Konventa të tjera jothemelore të ILO-s, mbulojnë çështje që nga pagat, orët e punës, shëndeti në punë deri te siguria, mbrojtja e amësisë dhe sigurimi social. ILO ka zhvilluar disa standarde të barazisë gjinore, duke përfshirë: Parimin e shpërblimit të barabartë për punëtorët burra dhe gra për punë me vlerë të barabartë (Konventa për shpërblim të barabartë); Ndalimi i diskriminimit në bazë të, ndër të tjera, gjinisë (Konventa për Diskriminimin (Punësimi dhe Profesioni)); Sigurimi i

mundësive të barabarta dhe trajtimi i barabartë për punëtorët me përgjegjësi familjare për t'u angazhuar në punësim (Konventa e Punëtorëve me Përgjegjësi Familjare); Dispozita për mbështetjen e të drejtave riprodhuese të grave (Konventa për Mbrojtjen e Maternitetit).⁹ Në anën tjetër, edhe Parimet Udhëzuese të OKB-së për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut (UNGP) theksojnë përgjegjësinë e shtetit për të pasur ligje adekuata për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve, për t'u dhënë udhëzime bizneseve se çfarë pritët prej tyre dhe për të siguruar zbatimin e duhur të këtyre ligjeve (UNGPs 1-3). UNGP 12 thotë se “përgjegjësia e sipërmarrjeve të biznesit për të respektuar të drejtat e njeriut i referohet të drejtave të njeriut të njohura ndërkombëtarisht - të kuptuara, së paku, si ato të shprehura në Ligjin Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut dhe parimet në lidhje me të drejtat themelore të përcaktuara në Deklaratën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Parimet Themelore dhe të Drejtat në Punë”. Udhëzuesi gjinor për UNGP-të thekson se “për të respektuar të drejtat e njohura ndërkombëtarisht të grave, sipërmarrjet e biznesit duhet të marrin në konsideratë, midis instrumenteve të tjera, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijëve të rëndësishme në të gjitha rrethanat dhe gjatë gjithë veprimtarisë së tyre”.¹⁰ Bashkimi Evropian ka disa rregulla strikte për sa i përket të drejtave të punëtorëve. Kështu, që çdo punonjës i BE-së ka disa të drejta minimale në lidhje me: shëndetin dhe sigurinë në punë: të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme, vendet e punës, pajisjet e punës, rreziqet specifike dhe punëtorët e cënueshëm, mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat: trajtimi i barabartë në punë, shtatzënia, pushimi i lehonisë, pushimi prindëror, mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të seksit, racës, fesë, moshës, paafetësisë, etj., e drejta e punës: punë me kohë të pjesshme, kontrata me afat të caktuar, orari i punës, punësimi i të rinjve, informimi dhe konsultimi i punonjësve. Në Kosovë, çështja e të drejtave të punës, respektivisht punëtorëve është e bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] 1. E drejta e punës garantohet. 2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”.¹¹ Gjithashtu, Ligji i Punës, nënvizon se “Ky ligj ka për qëllim të rregullojë të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, siç përcaktohen me këtë ligj”.¹² Në kuadër të këtij ligji, si dhe akteve të tjera nënligjore janë të përcaktuara raportet në mes të punëdhënësit dhe punë-marrësit, të drejtat dhe detyrimet, kontrata kolektive, pushimet, shpërblimet, si dhe një mori e çështjeve të tjera, të cilat pothuajse shumë pak respektohen.

PROBLEMET DHE SFIDAT E PUNËTORËVE KUNDREJT KONVENTAVE DHE LIGJEVE

Padyshim se punëtorët janë shtylla kryesore e zhvillimit të shoqërisë dhe vetë shtetit, pasi përmes zellit, dijes,



veprimtarisë së tyre fizike, psikike, intelektuale dhe teknologjike zhvillojnë segmentet e ndryshme të shtetit. Sot, në shumë vende të zhvilluara dhe jo të zhvilluara, të drejtat e punëtorëve shkelen, dhe se punëtori nuk e ka dinjitetin të cilin duhet të ketë. Dallimi në mes të vendeve të zhvilluara dhe jo të zhvilluara është, se të parat kanë standard dhe rregulla strikte, të cilat dënimet dhe penalizimet janë goxha të larta, përderisa vendet jo të zhvilluara, në shumicën e rasteve përveç aspektit deklarativ, praktika lë shumë për të dëshiruar. Konventat kryesore ndërkombëtare dhe ato vendore lidhur me çështjen e të drejtave të punëtorëve, e të cilat janë: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR), Konventa për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (GJEDNJ), Kushtetuta e Republikës së Kosovës, dhe Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Të gjitha këto dokumente, por edhe dokumente të tjera, janë hartuar me qëllim të jenë në funksion të të drejtave të punëtorëve si pjesë fundamentale e të drejtave të njeriut. Sipas një raporti të vitit 2023 nga Organizata Ndërkombëtare e Punës

Të dhënat tregojnë se prej vitit 2013 deri në vitin 2023 kanë humbur jetën 237 punëtorë në vendet e tyre të punës, kurse janë lënduar 1.780 punëtorë. Shumica e këtyre rasteve kanë ndodhur në sektorin privat.

(ILO), i cili u publikua gjatë Kongresit Botëror për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, jo vetëm që humbën jetën rreth 3 milionë punëtorë, por 395 milionë punëtorë në mbarë botën pësuan edhe lëndime jo fatale në punë.¹³ Kjo do të thotë se miliona njerëz përballen me lëndime dhe sëmundje vetëm duke bërë punën e tyre. Disa prej faktorëve padyshim se janë: mungesa e sigurisë në punë, sulmet në zemër dhe goditjet në tru, rrëzimet nga lartësia, aksidentet, dhuna në vendin e punës, ekspozimi ndaj substancave ose mjediseve të dëmshme, kontakti me objekte dhe pajisje elektrike, zjarret dhe shpërthimet, incidentet gjatë transportit, etj.. Sa i përket variabël të mes të gjinisë, të dhënat tregojnë se prijnë burrat me lëndime dhe vdekje në raport me gratë. Kështu, të dhënat tregojnë se “burrat kanë më shumë gjasa të vdesin nga shkaqe të lidhura me punën, me një shkallë vdekshmërie prej 108.3 për 100,000 punëtorë, krahasuar me 48,4 për 100,000 për gratë. Rajoni i Azi-Paqësorit është më i godituri, duke llogaritur pothuajse 63% të vdekjeve globale të lidhura me punën për shkak të popullsisë së tij të madhe të punës”.¹⁴ Në kuadër të vendeve të Bashkimit Evropian, lëndimet dhe vdekjet në vendet e punës janë të shumta, sidomos tek imigrantët të cilët nuk e kanë edhe

dokumentacionin në rregull. Shpeshherë inspektimet janë strikte, por ka raste edhe kur punëtorët përballen me shumë sfida dhe probleme. Në Kosovë, kemi parë që pavarësisht aspektit të legjislacionit, i cili në fakt ka nevojë që të amandamentohet me disa nene shtesë, respektimi i të drejtave të punëtorëve lë për të dëshiruar. Të dhënat tregojnë se prej vitit 2013 deri në vitin 2023 kanë humbur jetën 237 punëtorë në vendet e tyre të punës, kurse janë lënduar 1.780 punëtorë. Shumica e këtyre rasteve kanë ndodhur në sektorin privat. Përfaqësues të Sindikatës së sektorit privat konsiderojnë se këto shifra duhet të jenë alarm për institucionet dhe kompanitë që të veprojnë për t'i rritur masat e sigurisë në vendin e punës”.¹⁵ Sipas një raporti të publikuar nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet – IKS, “kur flitet për të drejtat e punëtorëve, punonjësit në Kosovë, sidomos ata të sektorit privat, jo vetëm që nuk gëzojnë një ndër të drejtat themelore të garantuara me ligj, si pajisja me kontratë të punës, por në shumicën e rasteve punojnë në kushte të papërshtatshme që nuk përkojnë as me standardet minimale të punës. Tregu i punës në Kosovë, përveç punës pa kontratë, gjithashtu karakterizohet edhe me shkelje të tjera si: puna jashtë normave të lejuara, mjedis i pasigurt i punës, mos respektimi i pushimeve të garantuara, pagesat me para në dorë dhe përjashtimi nga puna pa kriter. Tek aksidentet me fatalitet problem paraqesin edhe mangësitë në legjislacion”.¹⁶ Ndërsa kompensimi për familjarët në rast aksidenti me fatalitet i lihet në përgjegjësi punëdhënësve, të cilët në mënyrë vullnetare mund të vendosin për kompensim, apo në të kundërtën familjes i mbetet që t'i drejtohet gjykatës në mënyrë të pavarur me padi civile. Ka një mungesë transparence mbi vdekjet në vendin e punës pasi që raportimet janë të mangëta, të pashoqëruara me të dhënat e kompanive dhe raporteve publike zyrtare, si dhe me mungesë reagimi dhe të masave konkrete të përgjegjësisë. Raportimi i lëndimeve nga ana e bizneseve është shumë i vogël, kurse institucionet janë komplet të mbyllura në lancimin e të dhënave”.¹⁷ Kjo lë të kuptohet se pavarësisht faktit që Kosova ka inkorporuar një mori të konventave ndërkombëtare në kuadër të Kushtetutës së

Respektimi, promovimi, mbrojtja dhe përmbushja e të drejtave dhe obligimeve ndaj punëtorëve, është obligim jo vetëm ligjor, por edhe moral e social, pasi është në pyetje edhe jeta dhe dinjiteti i njeriut si qenie sociale – biologjike.

saj, është hartuar edhe legjislacioni i cili specifikohen të drejtat dhe detyrimet ndaj punëtorëve, megjithatë në praktikë ka shumë probleme të theksuara të cilat si rezultat i mos zbatimit të legjislacionit janë rritur dukshëm lëndimet në vendet e punës dhe fatalitetet të cilat kanë përfunduar me vdekjen e punëtorëve.

TË DREJTAT E PUNËTORËVE DHE FOKUSI NË TË ARDHMEN

Të drejtat e punëtorëve janë të drejta të cilat janë nën domenin e të drejtave të njeriut dhe si të tilla ato janë thelbësore jo vetëm për punëtorët, por edhe për institucionet, shoqërinë dhe vetë mjedisin e punës. Madje, Objektivi 8 i Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm titullohet “Punë e Denjë dhe Rritje Ekonomike”, me synim “Promovimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë”. Respektimi, promovimi, mbrojtja dhe përmbushja e të drejtave dhe obligimeve ndaj punëtorëve, është obligim jo vetëm ligjor, por edhe moral e social, pasi është në pyetje edhe jeta dhe dinjiteti i njeriut si qenie sociale – biologjike. Në njërin anë punëdhënësi duhet të fokusohet në: masat parandaluese, bashkëpunimi i punëdhënësve në zbatimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë, shërbimet për mbrojtjen dhe parandalimin, të punësuarit e ngarkuar për siguri dhe shëndet në punë, ndihma e parë, fikja e zjarreve, evakuimi i të punësuarve, rreziqet serioze dhe të mundshme, detyrimet e punëdhënësit për caktimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale, përdorimi i mjeteve të punës dhe pajisjeve mbrojtëse individuale gjatë procesit të punës, objektet/ndërtesat, vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës, punët me kushte të veçanta, informimi i të punësuarve, konsultimet dhe pjesëmarrja e të punësuarve, trajnimi i të punësuarve”.¹⁸ Në përputhje me trajnimin, udhëzimet e dhëna nga punëdhënësi, doracakët, udhëzimet dhe rregulloret teknike, i punësuarit është i detyruar të: përdorë me korrektësi makineritë, aparaturat, veglat, pajisjet e transportit mjetet e tjera për punë dhe të veprojnë me kujdes me substancat e rrezikshme; të respektojë të

gjitha detyrimet e përcaktuara prej punëdhënësit nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, në të kundërtën do të jetë përgjegjës për dëmin ose aksidentin e shkaktuar. Po ashtu, i punësuar do ta lajmërojë inspektorin e punës, nëse punëdhënësi nuk i ka ndërmarrë masat përkatëse për mënjanimin, evitimin dhe eliminimin e rrezikut të bazuar në ligj. I punësuar mund të refuzojë urdhëresën për punë, nëse e ka lajmëruar punëdhënësin, personin për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesin e të punësuarve për rrezikun që i kanoset atij/asaj nëse punon në ato kushte të punës, derisa nuk evitohet rreziku dhe nuk krijohen kushtet normale për punë.¹⁹ Në përgjithësi, mund të themi se sot jo vetëm në Kosovë, por edhe në shumë vende të tjera, të drejtat e punëtorëve, sidomos në sektorin privat shumë pak zbatohen. Në Kosovë, kemi parë se punëtorët përballen me shumë sfida të natyrave të ndryshme përfshirë këtu: mungesën e kontratave, organizimin sindikal, pushimet, paga, shpërblimet, siguria në punë, kompensimet me rastin e vdekjeve në vendin e punës, procedurat e tejzgjatura në gjykata, mungesa e mjeteve të punës, mungesa e inspektiveve, si dhe një mori e shkaqeve të tjera. Institucionet e vendit, së bashku me mekanizmat e tjerë qeveritar dhe joqeveritar, mund të kenë ndikim në ndryshimet së pari në legjislacion, pastaj edhe në fazat e implementimit të legjislacionit, në mënyrë që të krijohet siguria, shëndeti dhe mirëqenia për punëtorët në vendet e tyre të punës.

Literatura:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 49.
- Ahmeti, Nadije: “Kompensimi i munguar për vdekjen në vendin e punës”, Radio Evropa e Lirë, publikuar më 10 gusht 2023, shih: <https://www.evropaelire.org/a/vdekje-ne-vendin-e-punes-kompensim-32552703.html>
- Danish Institute for Human Rights: “National Action Plans on Business and Human Rights - Workers' rights”, DIHR, shih: <https://globalnaps.org/issue/workers-rights/>
- Drewniowska, Kinga: “Introduction to human rights Human Rights in Criminal Justice Context 2020/2021”, University of Wroclawski, Ppt.
- Dupre, Ben: “Ide Politike – që duhet t'i dijë çdo njeri”, Plejad, Tiranë, 2012, fq. 17.
- European Commission: “Rights at work”, EU, Bruksel, 2024.
- Hussain, Adil, at al: “Islam and the Issue of Human Rights: Compatibility or Contradiction”, East Asian Journal of Multidisciplinary Research (EAJMR) Vol 2, No.2, 2023.
- ILO: “ILO Declaration on Fundamental Principles and Rights at Work”, ILO, Geneva 22, Switzerland, 2023.
- Iniciativa Kosovare për Stabilitet: “Vdekjet e Heshtura – 2018”, IKS, Prishtinë.
- Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, neni 1.
- Minir, Curri: “Siguria dhe Shëndeti në Punë - Ngrija e kapaciteteve dhe forcimin e rolit të organizatave regjionale të shoqërisë civile për përmirësimin e kushteve të punës dhe dialogut me institucionet shtetërore – Studimi në Kosovë”, Balkanosh.net, Shkup, 2018.
- OKB: “Deklarata e përgjithshme mbi të drejtat e njeriut”, OKB, 1948: https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf
- Stephen P. Marks: “Human Rights: A Brief Introduction”, Harvard University, 2016, fq. 2.
- The Bridge Group: “What does May Day mean for workers and

employees in 2024?”, The Bridge Group, Research Action Quality: <https://www.thebridgegroup.org.uk/blog-posts/2024/04/25/may-day-in-2024#:~:text=The%20origins%20of%20International%20Workers'%20Day&text=Early%20in%201889%2C%201%20May,an%20eight%20hour%20working%20day.>

- Youfactors: “How Many People Die at Work Each Year? (2024)”, publikuar në Shtator, 2024, shih: <https://www.youfactors.com/statistics/how-many-people-die-at-work-each-year-2024-edition>
- 1 OKB: “Deklarata e përgjithshme mbi të drejtat e njeriut”, OKB, 1948: https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf
 - 2 Stephen P. Marks: “Human Rights: A Brief Introduction”, Harvard University, 2016, fq. 2.
 - 3 Hussain, Adil, at al: “Islam and the Issue of Human Rights: Compatibility or Contradiction”, East Asian Journal of Multidisciplinary Research (EAJMR) Vol 2, No.2, 2023, fq. 599-612.
 - 4 Drewniowska, Kinga: “Introduction to human rights Human Rights in Criminal Justice Context 2020/2021”, University of Wroclawski, Ppt, fq. 2.
 - 5 Dupre, Ben: “Ide Politike – që duhet t'i dijë çdo njeri”, Plejad, Tiranë, 2012, fq. 17.
 - 6 Danish Institute for Human Rights: “National Action Plans on Business and Human Rights - Workers' rights”, DIHR, shih: <https://globalnaps.org/issue/workers-rights/>
 - 7 The Bridge Group: “What does May Day mean for workers and employees in 2024?”, The Bridge Group, Research Action Quality: <https://www.thebridgegroup.org.uk/blog-posts/2024/04/25/may-day-in-2024#:~:text=The%20origins%20of%20International%20Workers'%20Day&text=Early%20in%201889%2C%201%20May,an%20eight%20hour%20working%20day.>
 - 8 Danish Institute for Human Rights: “National Action Plans on Business and Human Rights - Workers' rights”, DIHR, shih: <https://globalnaps.org/issue/workers-rights/>
 - 9 Po aty.
 - 10 Po aty.
 - 11 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 49.
 - 12 Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, neni 1.
 - 13 Youfactors: “How Many People Die at Work Each Year? (2024)”, publikuar në shtator 2024, shih: <https://www.youfactors.com/statistics/how-many-people-die-at-work-each-year-2024-edition>
 - 14 Po aty.
 - 15 Ahmeti, Nadije: “Kompensimi i munguar për vdekjen në vendin e punës”, Radio Evropa e Lirë, publikuar më 10 gusht 2023, shih: <https://www.evropaelire.org/a/vdekje-ne-vendin-e-punes-kompensim-32552703.html>
 - 16 Iniciativa Kosovare për Stabilitet: “Vdekjet e Heshtura – 2018”, IKS, Prishtinë, fq. 15.
 - 17 Po aty.
 - 18 Minir, Curri: “Siguria dhe Shëndeti në Punë - Ngrija e kapaciteteve dhe forcimin e rolit të organizatave regjionale të shoqërisë civile për përmirësimin e kushteve të punës dhe dialogut me institucionet shtetërore – Studimi në Kosovë”, Balkanosh.net, Shkup, 2018, fq. 44.
 - 19 Po aty, fq. 44-45.

Një ilahi shqip me grafi arabe në fletoren e babës hoxhë

• Dr. Besir Neziri

Brenda tij, të radhitura me kujdes, qëndronin qitapët e babës hoxhës – fletë të zverdhura nga koha, por të gjalla në shpirtin e të mbushura me njohuri, ndjenja e histori.

Në anën e djathtë qëndronte një dollap i vjetër druri, i mbushur me histori. Brenda tij, të radhitura me kujdes, qëndronin qitapët e babës hoxhës – fletë të zverdhura nga koha, por të gjalla në shpirtin e të mbushura me njohuri, ndjenja e histori. Aty ishin edhe librat e babait dhe agallarëve të mi, dëshmi e dijes dhe urtësisë që kalonte brez pas brezi. Përballë, një minder i thjeshtë, por plot ngrohtësi, si dhe postaqiat ku ne përkuleshim në lutje, duke ndier qetësinë e namazit dhe praninë e Zotit. Afër tyre, dera e hyrjes, e cila çdo ditë hapej për miqtë, për të njohur e të panjohur, për ata që kërkonin këshillë e ngushëllim. Në të majtë, divanet ku uleshin burrat e urtë, aty ku bisedat e gjata mbushnin netët me këshilla, tregime e histori. Pranë tyre, koftori – aty ku zjarri bubulonte, ngrohte shpirtin dhe ndriçonte kujtimet tona. Në mur, një pikturë e vizatuar me përkushtim, paraqiste shtëpinë e bekuar të Zotit, Qabenë, një kujtim i përhershëm i besimit tonë. Ndërsa pranë saj, flamuri kuq e zi me shqiponjën dy krenare, i qëndisur me dashuri, qëndronte si një betim i pashuar për atdheun.



Kjo odë e burrave ishte vendi ku burrëria dhe urtësia merrnin formë. Në krye të vendit, baba hoxha, me mjekrën e tij të bardhë, priste mysafirë me buzëqeshje që e bënte të dukej si një dritë udhërrëfyese për ata që kërkonin ndihmë. Aty pajtoheshin gjaqe, shuheshin ngatërresa dhe diskutohej me pasion për çështje kombëtare dhe fetare.

Të paharrueshme ishin netët kur vinte muaji i Mevludit dhe kjo oda mbushej me një dritë të veçantë shpirtërore. Baba hoxha, së bashku me babanë, këndonin Mevludin dhe Kuranin me një zë të bukur e melodik, në mekamin tradicional. Ai lexonte Mevludin e Tahir efendi Popovës me grafi arabe, dhe unë, si fëmijë, e shikoja me kureshtje. Më dukej magjike si fjalët shqipe rridhnin nga një tekst i shkruar me shkronja arabe. Shpeshherë, i hapja qitapët e babës hoxhës, i shfletoja me duart e vogla, edhe pse nuk kuptoja gjë. Megjithatë, ndieja një kënaqësi të çuditshme, një lidhje të pashpjegueshme me ato fletë të zverdhura nga koha, sikur ato ruanin një botë të tërë që më priste ta zbuloja.

Qitapët e babës hoxhës, të shkruar në gjuhën arabe, osmane dhe shqipe me grafi arabe, nuk ishin thjesht libra, por një pasuri e çmuar që mbante brenda vetes dritën e dijes dhe shpirtin e një tradite të lashtë. Çdo faqe e tyre ruante mençurinë e brezave, një dëshmi e një kohe kur leximi dhe mësimi nuk ishin vetëm nevojë, por mënyrë jetese për njeriun e devotshëm. Në ato faqe gjendeshin jo vetëm fjalët, por edhe përkushtimi, besimi dhe përpjekja për të mbajtur gjallë diturinë, duke e përcjellë atë nga një brez në tjetrin.

Për një fëmijë si unë, këta libra të vjetër ishin një botë misterioze, një thesar i mbushur me shkronja të panjohura që më ngjallnin kureshtje dhe ma ndiznin imagjinatën. Falë këtij inspirimi, me kalimin e kohës, u përkushtova me pasion në studimin e gjuhës osmane dhe leximin e dorëshkrimeve të vjetra, me dëshirën për t'i dhënë zë një trashëgimie që ka mbetur e heshtur në pluhurin e kohës.


BABA HOXHË

Baba hoxhë, siç thirrej nga familjarët e të afërmit tanë, quhej Nezir Ali Llugiqi, e në popull njihej si Mulla Neza. Ka lindur në

Shpeshherë, i hapja qitapët e babës hoxhës, i shfletoja me duart e vogla, edhe pse nuk kuptoja gjë. Megjithatë, ndieja një kënaqësi të çuditshme, një lidhje të pashpjegueshme me ato fletë të zverdhura nga koha, sikur ato ruanin një botë të tërë që më priste ta zbuloja.

Dobrajë të Madhe – Lipjan me datën 15.02.1925. Shkollën fillore e kreu në Dobrajë të Madhe, më pas vazhdoi shkollimin në Medresenë e Ultë në Prizren. Më pas, në vitin 1938, vijoi mësimet në Medresenë “Pirinaz” në Prishtinë, të cilat i kishte përfunduar në vitin 1943 në Medresenë “Sulltan Selim”, te myderrizi i njohur, haxhi Iljas Hashani (Shasivari), ngase, siç dihet, sipas rregullores së vitit 1935 të Ulema Mexhllisit, në vendet ku kishte më shumë se një medrese, duhej të bëhej detyrimisht fuzionimi i tyre dhe të funksiononte vetëm një medrese, dhe në këtë mënyrë Medreseja “Sulltan Selim III” fuzionohet në Medresenë “Pirinaz” deri në vitin 1942. Pas vitit 1941, me krijimin e kushteve të reja, më të favorshme në Kosovë, dhe me formimin e “Shqipërisë Etnike”, Medreseja “Sulltan Selim III” e Prishtinës u rihap dhe u nda nga Medreseja “Pirinaz”, të cilat vepronin me të njëjtin planprogram, por me myderrizë të ndryshëm. Fuzionimi, e më pastaj edhe ndarja e Medresesë “Sulltan Selim” nga ajo “Pirinaz”, bëri që disa nxënës të kishin filluar njëren medrese, e pastaj të kishin kaluar në medresenë tjetër. Si duket, këtë fat e ka pasur e Mulla Neza, i cili kishte filluar mësimin në Medresenë “Pirinaz”, dhe e kishte përfunduar në Medresenë “Sulltan Selim”. Që ka diplomuar në Medresenë “Sulltan Selim” e vërteton edhe një dëshmi e lëshuar për Mulla Nezen nga myderrizi dhe drejtori i Medresesë “Sulltan Selim”, haxhi Iljas Hashani (Shasivari), si dhe një listë e hartuar po ashtu nga haxhi Iljas Hashani (Shasivari) në vitin 1943, ku në mes të 29 nxënësve është edhe Mulla Neza.

Pas diplomimit, Mulla Neza u angazhua si ofiqar në Hade të Obiliqit. Në vitin 1951, me vendim të Bashkësisë Islame të asaj kohe, u emërua imam i xhematit në fshatin e tij të lindjes, Dobrajë e Madhe. Në këtë fshat ai ushtroi funksionin e imamit deri në vitin 1956, kur autoritetet shtetërore të kohës, nën regjimin e Rankoviçit, e ndaluan nga ushtrimi i detyrës, e keqtrajtuat fizikisht me akuzën se përbënte rrezik për rendin shtetëror. Si pasojë, iu ndalua të vepronte më tej si imam. Në një dokument zyrtar të datës 20.9.1962, theksohet se Nezir Ali Llugiqi nuk e ushtron më funksionin e imamit. Megjithatë, pas një



periudhe, ai u emërua imam në fshatin Magurë të Lipjanit, ku shërbeu deri në daljen e tij në pension.

Përveç funksionit fetar, Mulla Neza dha një kontribut të rëndësishëm në edukimin shpirtëror, moral e kombëtar të xhematit, përmes këshillave, ligjëratave dhe derseve, duke ndikuar në formimin fetar të shumë gjeneratave. Ai la pas një trashëgimi të veçantë në kujtesën kolektive të besimtarëve, e cila reflekton përkushtimin e tij ndaj dijes, fesë dhe kombit.

Ai ndërroi jetë më 5.5.2008, në moshën 83-vjeçare.

ILAHIA

Në mesin e shumë qitapëve të vjetër, mes faqeve të zverdhura nga koha, gjendet një fletore e çmuar me dorëshkrime të babës hoxhë. Kjo fletore përmban lutje të ndryshme (dua) si dhe ilahi në gjuhën shqipe me grafi arabe, që kanë një rëndësi fetare e kulturore. Edhe pse autorësia e këtyre ilahive mbetet e panjohur, besohet se ato janë trashëguar nga hoxhallarët e vjetër dhe janë interpretuar në tubime fetare (mexhlise) dhe në ndeja tradicionale në odat shqiptare. Ndër këto ilahi, njëra dallohet në mënyrë të veçantë, pasi trajton obligushmërinë e namazit për besimtarët në natën e Miraxhit, duke vënë në dukje vlerën dhe rëndësinë që ka namazi në jetën shpirtërore të besimtarët.

*Naten e Miraxh u bo farz namazi,
Ekimu's-sala çonu ju xhemat
Pej huzure te Madhnija pes davet
Shum sajgi me knu Kuran
Ngo shka thon Kulli me Zot llaf po bon*

*Abdes emrin paq me kan
Nezafeti gjys iman
Lan gjynahe shum i rrzon
Si ni peme flet kur leshon*

*Dine hak hem n'kofshi islam
Me namaz boni ju ilam
Qyfrin Haku hem se dan
Ulemaja kshtu na than*

*Shyqer Zotit s'un i ban
Tona shyqret k'tu jon than
Xhemalullah ndash me pa
Fal namazin pa ja da*

*Kush fal namaz pa ja da
Dron e Zotit aj e ka
Dron e Zotit ndash me pas
Krejt braktisi prej dynjas*

*Tesbih tehnil tahmidat
Hamd thena tehijjat
Shka ka per Zot ibadat
N'tok te Zotit semavat*

*Xhem jon bo n'çat davet
Per hedije Muhamed
Shum nasib na kishem pas
Jem ymmeti Mustafas*

*Sa sevap kan krejt meleq't
Dine mir tri e pleg't
Ma shum ka, namaz kush fal
Tha Allahi zulxhelal*

*Pej ksaj shkalle dil perpjjet
Merri krahet bonu meleq
Met namazi per ymmet,
Kulli me Zot mu perkpjek.¹*

Sa sevap kan
krejt melek't
Dine mir tri e
pleq't
Ma shum ka,
namaz kush
fal
Tha Allahi
zulxhelal



PËRFUNDIM

Këta qitapë të vjetër e të çmuar në gjuhën arabe, osmane dhe shqipe me grafi arabe të bibliotekës së babës hoxhë janë dorëzuar në Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame (IHSI). Ky institut, që funksionon në kuadër të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës (BIK), ka ndërmarrë një iniciativë të rëndësishme për grumbullimin, ruajtjen dhe studimin e dorëshkrimeve dhe librave të vjetër, që kanë qenë në raftet e bibliotekave të hoxhallarëve ndër breza.

Ky proces përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të dokumentimit dhe arkivimit të trashëgimisë intelektuale islame, duke mundësuar qasje më të lehtë për studiuesit dhe akademikët që merren me historinë e mendimit islam dhe ndikimin e tij në hapësirën shqiptare. Përmes kësaj iniciative, synohet jo vetëm të mbrohet kjo pasuri e rrallë nga degradimi apo humbja, por edhe të nxitet një qasje më e strukturuar ndaj studimit të teksteve islame dhe rolin e tyre në formësimin e identitetit fetar dhe kulturor të shqiptarëve.

Koleksione të tilla përfaqësojnë dëshmi të rëndësishme të zhvillimit të dijes fetare dhe shkencore ndër shekuj, duke reflektuar ndikimet intelektuale dhe fetare që kanë pasur dijetarët islamë në trevat shqiptare. Në këtë kontekst, përpjekjet e IHSI-së për grumbullimin dhe trajtimin shkencor të këtyre burimeve janë një kontribut i vyer për studimet historike, gjuhësore dhe fetare, duke ofruar një pasqyrë më të plotë mbi traditën e shkruar islame në hapësirën shqiptare.

Me këtë rast, u bëj thirrje të gjithë familjarëve të hoxhallarëve të vjetër që të dorëzojnë librat dhe dorëshkrimet e bibliotekave të tyre në Institutin për Hulumtime dhe Studime Islame (IHSI). Kjo do të mundësojë që studiuesit të kenë qasje në këto burime të vlefshme, duke i studiuar dhe analizuar ato për të ruajtur dhe promovuar trashëgiminë e pasur fetare dhe kombëtare.

Lus Zotin e Madhërisë që të mëshirojë babën hoxhë dhe të gjithë hoxhallarët e vjetër, të cilët me përkushtim dhe devotshmëri kanë kontribuar në përhapjen e dijes dhe në shërbimin ndaj fesë dhe atdheut, dhe të bëjë që puna dhe mësimet e tyre të vazhdojnë të jenë dritë për ne dhe brezat që vijnë pas!

Fatiha për shpirtin e tyre!

1 Kjo ilahi është marrë nga fletorja e babës hoxhë, Mulla Nezës. Ajo është dhënë në versionin origjinal, ashtu siç është shkruar, pa ndonjë ndërrhyrje.

Referencat:

1. Arkivi i BIRK,
2. Arkivi i IHSI,
3. Mehmeti, Sadik. "Medreseja 'Pirinaz' në Prishtinë dhe aktiviteti i saj 1935–1945." Buletin i Fakultetit të Studimeve Islame, no. 2 (2012): 255–277.

Përfitimet shëndetësore të ullirit sipas Kuranit dhe haditheve të Pejgamberit a.s.

- Mr. Njomza Sadriu

Ulliri dhe pema e tij përmenden disa herë në Kuran, por gjithashtu edhe në hadithe. Ai cilësohet si një frutë i “bekuar” si dhe është burim i shkëlqyer ushqimi.

PËR ULLIRIN NË KURAN

“Për fikun dhe ullirin dhe (për) malin Sinai, dhe (për) këtë qytet të sigurt (Mekën). Vërtet, Ne e kemi krijuar njeriun në formën më të mirë.” (Et Tin, 1-4).

Ulliri është një dhuratë hyjnore për njerëzimin. Përveç hurmës së Arabisë, ulliri konsiderohet me rëndësi të madhe në Islam. Ulliri dhe pema e tij përmenden disa herë në Kuran, por gjithashtu edhe në hadithe. Ai

cilësohet si një frutë i “bekuar” dhe përveçse është burim i shkëlqyer ushqimi, përdoret edhe për qëllime shëndetësore dhe në trajtimin me rukje sherije.

Ulliri përmendet shtatë herë në Kuran, duke treguar vlerën që ka. Një nga ajetet që e përmend është: “Dhe Ai është që bën të rriten kopshte, të mbështetur dhe të pambështetur, dhe palma, dhe të mbjella me lloje të ndryshme ushqimesh, dhe ulliri dhe shega, të ngjashme



dhe të ndryshme. Hani nga frutat e tyre kur të japin fryte dhe jepni hakun e tij (zekatin) në ditën e korrjes. Dhe mos e teproni, vërtet, Allahu nuk i do ata që e teprojnë.” (El An'am, 141).

Në një ajet tjetër, Zoti i Madhëruar përmend cilësinë ndriçuese të vajit të ullirit, të cilën e përshkruan fuqishëm në Kuran: “Allahu është Drita e qiejve dhe e Tokës. Shembulli i dritës së Tij është si një kandil në të cilin është një llambë, llamba është brenda një xhami, xhami është si një yll i shndritshëm, i ndezur nga (vaji i) një peme të bekuar – pema e ullirit – që nuk është as lindore e as perëndimore, vaji i së cilës pothuajse shkëlqen edhe nëse nuk e ka prekur zjarri. Dritë mbi dritë. Allahu udhëzon drejt dritës së Tij kë të dojë. Dhe Allahu u sjell

Studime të mëtejshme sugjerojnë se vaji i ullirit ndihmon “për të përmirësuar balancën e yndyrave në gjak” (Adams, 2001), si dhe ndikon në uljen e kolesterolit.

Elementi	Përfitimet kryesore
Acidet yndyrore të pangopura (veçanërisht acidi oleik)	Përmirëson shëndetin e zemrës, ul kolesterolin e keq (LDL) dhe rrit kolesterolin e mirë (HDL)
Polifenolët	Ka veti të fuqishme antioksiduese dhe anti-inflamatore, ndihmon në mbrojtjen kundër sëmundjeve kronike.
Vitamina E	Mbron qelizat nga dëmtimet oksidative, përmirëson lëkurën dhe flokët.
Hekuri (Fe)	Ndihmon në prodhimin e qelizave të kuqe të gjakut, parandalon aneminë.
Kalcium (Ca)	Përmirëson shëndetin e kockave dhe dhëmbëve, ndihmon në funksionimin e muskujve dhe nervave.
Fibra dietike	Përmirëson tretjen dhe ndihmon në mbajtjen e një sistemi të shëndetshëm tretës.
Squalene	Përmirëson shëndetin e lëkurës, ka veti anti-inflamatore dhe mbrojtëse kundër kancerit.
Flavonoidët	Mbështesin sistemin imunitar dhe ndihmojnë në mbrojtjen nga infeksionet dhe inflamacionet.
Omega-3 dhe Omega-6	Mbështesin funksionin e trurit, reduktojnë inflamacionin dhe ndihmojnë në shëndetin e zemrës.

shembuj njerëzve, dhe Allahu është i Gjithëditur për çdo gjë.” (En Nur, 35).

Pema e ullirit, një nga begatitë e mbretërisë bimore, ka vlera jo vetëm ushqyese, mjekësore dhe kozmetike, por gjithashtu ka një funksion fetar si një shenjë (ajet) e Allahut

xh.sh.: “Me të (me ujin) Ai rrit për ju të mbjellat, ullirin, palmat, hardhitë dhe të gjitha llojet e frutave. Vërtet, në këtë ka një shenjë për njerëzit që mendojnë.” (En Nahl, 11).

ULLIRI NË HADITHET E PEJGAMBERIT A.S.



Në përputhje me mësimet islame dhe studimet shkencore, ulliri mbetet një nga frutat më të dobishme për shëndetin e njeriut.

Ulliri dhe vaji i tij kanë rëndësi të madhe në hadith. Profeti Muhamed a.s. ka thënë: “Hani vaj ulliri dhe përdoreni atë për flokët dhe lëkurën tuaj, sepse ai vjen nga një pemë e bekuar.” (Tirmidhiu, 1775).

Ai a.s. gjithashtu ka thënë: “Merrni vaj ulliri dhe masazhohuni me të – ai është një pemë e bekuar.” (Darimiu, 69:103).

ULLIRI NË STUDIME SHKENCORE

Ashtu si hurma e Arabisë, ulliri ka një vlerë të madhe si në kulturën e lashtë, ashtu edhe në atë moderne. Në kulturën e Mesdheut, “ai ka shërbyer si gjithçka, nga monedha deri te mjekësia për mijëra vjet.” (Zwingle, 1999).

Që nga vitet 50-ta, përfitimet e dietës mesdhetare, e pasur me vaj ulliri, janë lartësuar. Studime të mëtejshme sugjerojnë se vaji i ullirit ndihmon “për të përmirësuar balancën e yndyrave në gjak” (Adams, 2001), si dhe ndikon në uljen e kolesterolit.

Në përputhje me mësimet islame dhe studimet shkencore, ulliri mbetet një nga frutat më të dobishme për shëndetin e njeriut.

DISA NGA ELEMENTET KRYESORË TË PRANISHME NË

ULLINJ DHE PËRFITIMET E TYRE JANË:

Këta elementë e bëjnë ullirin një frutë të jashtëzakonshëm për shëndetin tonë dhe një përbërës të vlefshëm në dietën e përditshme. Bazuar në të gjitha këto, pra duhet të fillojmë të konsumojmë këtë frutë të bekuar dhe vajin e tij në jetën tonë të përditshme për të përfituar nga vlerat e shumta që ofron.

Allahu xh.sh. i dhëntë shëndet të mirë të gjithë myslimanëve!

“Dhe (Ne bëjmë të rritet) një pemë nga Mali Sinai, që prodhon vaj dhe është ushqim për ata që hanë.” (El Muminun, 20).

Referencat:

- “The Prophetic Medicine”, Ibn Qayyim al-Jawziyya, 2015.
- “Medicine of the Prophet” translated by Penelope Johnstone, <https://its.org.uk>, 2012.
- “Olive Health Benefits According to Quran and Hadith”, IslamicFinder, 2018.
- “Olive Oil - A Nutritious Wonder From the Qur'an and Sunnah!”, Muslim Hands UK, 2020.
- “Discover The Sunnah Benefits of Olives”, Muslim Girl, 2023.
- “Olives and Olive Oil in Health and Disease Prevention”, Victor R. Preedy and Ronald Ross Watson, 2010.
- “The Extra-Virgin Olive Oil Handbook”, Claudio Peri, John Wiley & Sons, Ltd, 2014.
- “Olive Oil: Chemistry and Technology”, Dimitrios Boskou, AOCS Publishing, New York, 2006.

“Në kërkim të identitetit – rrëfimi i jetës sime” – libri autobiografik i presidentit Anwar el Sadat

• **Nehat Islami**

Shumë të njohura e të panjohura për Lindjen e Mesme, luftërat e së kaluarës, që na ndihmojnë ta kuptojmë edhe të sotmen arabe, ngërthen libri autobiografik i ish-presidentit të vranë egjiptian, Anwar el Sadatit, i cili mbledhi fuqi të shkojë në Izrael (1977) për të bërë paqe, ndërsa historinë e themeluesve shqiptarë të Egjiptit modern e nxori nga errësira, ku e kishte futur paraardhësi i tij, Naseri.

Doli nga shtypi në Prishtinë libri autobiografik i ish-presidentit egjiptian Anwar

el Sadati, i cili hedh ditë mbi shumë ngjarje të historisë së Egjiptit dhe Lindjes së Mesme, që nga pas Lufta e Dytë Botërore. Pasi u përkthye në shumë gjuhë botërore, libri “Në kërkim të identitetit, rrëfimi i jetës sime”, doli edhe në gjuhën shqipe falë përkthyesve të njohur nga arabishtja, Ejup Ramadani dhe Resul Rexhepi.

Ky libër veçmas spikat rrethanat dhe Luftën izraelito-arabe të vitit 1967-1973, si dhe krizat e tjera të regjionit arab, ku Anwar el Sadati

Libri autobiografik i ish-presidentit të vranë egjiptian, Anwar el Sadatit, i cili mbledhi fuqi të shkojë në Izrael (1977) për të bërë paqe, ndërsa historinë e themeluesve shqiptarë të Egjiptit modern e nxori nga errësira, ku e kishte futur paraardhësi i tij, Naseri.





ishite personi kyç, jo vetëm në luftëra, por edhe për paqe me Izraelin. Kur të gjithë arabët ishin kundër, Anwar el Sadati mbodhi forcë dhe në nëntor të vitit 1977, shkoi në Izrael për të filluar një erë të re paqeje me këtë shtet, kundër të cilit zhvilloi pesë luftëra. Në fillim arabët e tjerë e bojkotuan, por më vonë, pas vrasjes së tij në atentat, në Kajro, 6 tetor 1981, disa shtete arabe vendosën marrëdhënie diplomatike me Izraelin.

Anwar el Sadati, do të mbahet mend nga shqiptarët edhe për një kthesë pozitive që bëri ndaj historisë dhe shëmbëlltyrës së Mehmet Ali Pashës dhe tërë asaj familje shqiptare që themeluan Egjiptin Modern përgjatë një shekulli e gjysmë.

Siç dihet, pas grushtshtetit të Naserit kundër mbretit Faruk, të fundit nga loza shqiptare në Egjipt, 1952, Naseri urdhëroi të hidhet në

Kur të gjithë arabët ishin kundër, Anwar el Sadati mbodhi forcë dhe në nëntor të vitit 1977, shkoi në Izrael për të filluar një erë të re paqeje me këtë shtet.

harresë tërë ajo pjesë e historisë shqiptare. Ashtu edhe ndodhi. U ndalua çdo shkrim për Mehmet Ali Pashën dhe të gjithë pasardhësit e tij. Pikërisht, Anwar el Sadati, që erdhi në pushtet pas vdekjes së Naserit, urdhëroi të kundërtën, që të hapeshin të gjitha burimet e mundshme për të ngritur në nivelin e duhur veprat e Mehmet Aliut, jo vetëm për Egjiptin, por për mbarë botën arabe. Këtë rrugë e ndoqi edhe pasardhësi i Sadatit, Hosni Mubaraku.

Andaj, ky libër që doli nga Shtëpia botuese “Dituria islame” plotëson ndër ne një boshllëk që ka munguar në gjuhën tonë mbi një periudhë shumë dramatike të Lindjes së Mesme. Duke e kuptuar të kaluarën e këtij regjioni, do të kuptohet më mirë edhe realiteti që aktualisht po e mundon regjionin në fjalë.

A mundet Islami ta balancojë etikën me progresin modern?¹

• Alizaman D. Gamon, Mariam S. Tagoranao

Në botën tonë, që po ndryshon me shpejtësi, sfidat me të cilat përballemi janë të ndërlikuara. Kjo gjë po kërkon një qasje gjithëpërfshirëse që e njeh rëndësinë e vlerave etike, shpirtërore dhe kulturore mes një mënyre jetese sekulare. Çdo besimtar mysliman ka përgjegjësinë të sigurojë që veprimet e tij të udhëhiqen nga një kuptim i thellë i ligjeve kombëtare, traditave të tyre dhe humanizmit të përbashkët që buron nga këndvështrimet dhe sistemet e besimit islam.

Gjatë dekadave të fundit, organizatat myslimane të angazhuara në mbarë botën islame kanë ofruar një plan veprimi për adresimin e çështjeve bashkëkohore, duke

theksuar mesazhin universal të Islamit si një forcë dinamike për ndërtimin e kombit dhe fuqizimin e shoqërisë.

Ndërsa janë hartuar iniciativa të ndryshme për të përcaktuar një rrugë drejt realizimit të vërtetë të fuqizimit dhe ndërtimit të kombit, myslimanët, pavarësisht racës dhe etnisë së tyre, duhet të përqafojnë bindjen se ideja e bashkëjetesës domethënëse duhet të artikulohet në mënyrë të thellë nga ata që mishërojnë drejtësinë, dhembshurinë dhe një ndjenjë të thellë përgjegjësie - vlera që Islami dhe qytetërimet e mëdha të historisë i kanë mbajtur si parime thelbësore.

Prandaj, është një sfidë e rëndësishme për të gjitha komunitetet myslimane që të zhvillojnë një kulturë dijeje, e cila ndërton kombe jo vetëm të begata, por edhe të drejta, gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në parime morale. Megjithatë pjesëmarrja aktive në sferat sociale është një masë e rëndësishme e fuqizimit, një qasje gjithëpërfshirëse ndaj fuqizimit shkon përtej suksesit material dhe përparimit teknik.

Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj fuqizimit, e cila përfshin dimensionet shpirtërore, etike dhe kulturore të jetës njerëzore, duhet të pasqyrohet në kulturën tonë të dijës. Për shkak të qasjes dualiste në arsim, shumë politikëbërës mund të vënë në dyshim ligjshmërinë e saj, pasi duket se bie në kundërshtim me kushtetutën që mbështet konceptin e ndarjes së fesë nga shteti.

Duke shkuar përtej diskursit të zakonshëm mbi bashkëjetesën paqësore, e cila kap thelbin e harmonisë sociale, promovimi i qeverisjes etike dhe krijimi i një mjedisi ku individët mund të zhvillohen jo vetëm si qytetarë të mirë,



por edhe si promovues moralë, shpesh pengohet nga një kulturë e dijes që përparon një qasje materialiste. Kjo qasje ka prirjen të anashkalojë aspektet më të thelluara dhe cilësore të bashkëjetesës – ato që lidhen me identitetin, udhëheqjen morale dhe drejtësinë sociale.

Duke qenë të vetëdijshëm për mangësitë e qasjes konvencionale ndaj bashkëjetesës, dijetarët myslimanë në rajon janë angazhuar me homologët e tyre për të rikontekstualizuar qeverisjen etike, e cila thekson vlerat morale, transparencën dhe llogaridhënien në sferën publike si një strategji për të nxitur një narrativë kombëtare për integrimin.

Përpjekjet e tyre të përbashkëta me organizatat joqeveritare për zbatimin e programeve të ndryshme që trajtojnë pabarazitë sociale, diferencat ekonomike dhe çështje të tjera që prekin komunitetet myslimane kanë ndihmuar në kapërcimin e përplasjes epistemologjike midis dy traditave të kundërta intelektuale. Për më tepër, ruajtja e kulturës dhe identitetit të komuniteteve myslimane në rajon është marrë seriozisht nga shumë avokatë të bashkëjetesës paqësore për të përmirësuar qasjen konvencionale ndaj ndërtimit të kombit.

Si përgjigje ndaj sfidave të arsimit modern si një instrument shtetëror për integrimin kombëtar, drejtuesit myslimanë të arsimit gjenden në një moment vendimtar për të pozicionuar arsimin mysliman. Ata ndajnë mendimin se adoptimi i një qasjeje holistike, siç është integrimi i parimeve islame në kurrikulën ekzistuese, do të forcojë aftësinë e tij për të formuar jo vetëm individë të mirë, por edhe qytetarë të përgjegjshëm.

Politika të ndryshme qeveritare janë miratuar nga liderë të përgjegjshëm për t'i kushtuar vëmendje të veçantë rritjes dhe zhvillimit të rinjve myslimanë, duke siguruar që ata të jenë të barabartë me bashkëmoshatarët e tyre jomyslimanë brenda infrastrukturës aktuale arsimore, veçanërisht në kontekstin më të gjerë të ndërtimit të kombit.

Për të garantuar që zërat e komuniteteve myslimane të dëgjohen në nivel kombëtar, gjuha islame dhe themelet filozofike të dialogut ndërfaqësor duhet të artikulojnë me

Për të siguruar që zërat e pakicave myslimane të dëgjohen, liderët e komunitetit duhet të jenë aktivisht të përfshirë në proceset e hartimit të politikave kombëtare që pasqyrojnë nevojat dhe aspiratat e ndryshme të komuniteteve myslimane. Kjo përfshirje do t'i shndërrojë komunitetet myslimane në aktorë të rëndësishëm për realizimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe harmonike.

kujdes nga intelektualët e duhur. Përpjekjet e tyre duhet të synojnë ndërtimin e urave dhe nxitjen e harmonisë sociale, duke adresuar keqkuptimet rreth Islamit, kulturës dhe praktikave të tij, si dhe rolin e tij në integrimin kombëtar.

Prandaj, për të siguruar që zërat e pakicave myslimane të dëgjohen, liderët e komunitetit duhet të jenë aktivisht të përfshirë në proceset e hartimit të politikave kombëtare që pasqyrojnë nevojat dhe aspiratat e ndryshme të komuniteteve myslimane. Kjo përfshirje do t'i shndërrojë komunitetet myslimane në aktorë të rëndësishëm për realizimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe harmonike.

Duke u mbështetur në parimet islame të konsultimit (*shura*), pajtimit (*sulh*) dhe mesatares së artë (*vasatijeh*) dhe duke i integruar gradualisht brenda sistemeve kombëtare, pritet që zërat e nën përfaqësuar në përpjekjet për ndërtimin e paqes, veçanërisht ata të rrënjësuar në traditat islame dhe praktikatat indigjene, të marrin njohjen që meritojnë.

Prandaj, është përgjegjësi kolektive e çdo komuniteti të informuar të rishpikë një kulturë dijes që nxit ndërgjegjësimin mbi humanizmin tonë të përbashkët, i cili shërben si themel i përpjekjeve globale për paqe dhe transformim të konflikteve. Ky moment i rëndësishëm në zhvillimin e studimeve mbi paqen dhe zgjidhjen e konflikteve pasuron teorinë dhe praktikatat aktuale, duke kontribuar në fuqizimin dhe ndërtimin e paqes të përqafuar nga bashkësia globale.

Mund të argumentojmë se një sintezë krijuese midis traditave të vjetra dhe qasjeve të reja për fuqizimin dhe ndërtimin e paqes do të ofronte përparësi të shumta për çdo komunitet. Është një sfidë monumentale për ne që të riangazhohim intelektualët dhe politikëbërësit në fushën e paqes dhe zhvillimit të qëndrueshëm, të mbështetur në themelet filozofike të mirëfillta që respektojnë historinë, identitetin dhe aspiratat e ardhshme të individit.

Arsimi mbetet thelbësor për ruajtjen e identitetit mysliman, me dijetarët islamë që mbrojnë një sistem që respekton traditën, ndërsa trajton sfidat e shkaktuara nga ndikimet laike. Roli i liderëve të komunitetit në



këtë përpjekje është jetik, pasi ata punojnë për të reformuar sistemin arsimor dhe për të korrigjuar padrejtësitë historike.

Ndërsa lundrojmë nëpër kompleksitetin e peizazhit tonë kulturor, është thelbësore të njohim rolin kritik që kultura luan në formësimin e sjelljes dhe besimeve njerëzore.

Në një shoqëri që mund të pasqyrojë paragjykimet e së kaluarës, është koha e duhur të përqijemi për të krijuar një mjedis gjithëpërfshirës që feston dallimet tona. Iniciativa të tilla mund të bazohen në konceptin kuranor të diversitetit të shprehur në parimin e *li tëarafu* (*jeni krijuar që të njiheni në mes vete*), i cili thekson unitetin e jetës dhe njeh natyrën e ndryshme të komuniteteve tona.

Prandaj, dijetarët myslimanë - të cilët janë shkencëtarë të mirëfilltë shoqërorë dhe “mjekë të vërtetë” për popullin - duhet të bashkohen për të gjetur zgjidhje që adresojnë rrënjët e përplasjes epistemologjike midis dy kulturave të kundërta në kontekstin tonë bashkëkohor.

Si liderët tradicionalë, ashtu edhe ata modernë myslimanë kanë paraqitur pikëpamjet e tyre mbi mënyrën se si mund të forcohen strategjitë qeveritare për menaxhimin efektiv të diversitetit kulturor përmes arsimit. Për shkak të përkushtimit të shtetit ndaj parimit të ndarjes së fesë nga shteti, përparimi i arsimit laik asimilues është adoptuar si një masë qeveritare për bashkëjetesën paqësore në rajonet myslimane.

Duke ndarë aspiratat e liderëve të komuniteteve shumicë-myslimane në rajon, intelektualët myslimanë kanë qenë të angazhuar në ridimensionimin e rolit të Islamit në shoqërinë bashkëkohore, duke u përqendruar në mënyrën se si ai mund

t'i shërbejë më së miri interesave të komuniteteve myslimane moderne.

Duke pasur parasysh ndërveprimet intelektuale midis dijetarëve myslimanë në rajon dhe botën më të gjerë islame, kemi qenë dëshmitarë të një dimensionit të ri të paqes dhe sigurisë, i cili mbështetet në objektivat e larta të ligjit islam (*Mekasid esh Sheriah*). Ky koncept synon ruajtjen e interesave thelbësore njerëzore: fesë (*din*), jetës (*nefs*), intelektit (*akl*), gjenealogjisë (*nesl*) dhe pasurisë (*maal*).

Megjithëse njohja e rëndësisë së këtyre parimeve mbetet ende në fazën e saj fillestare, nuk ka dyshim se zbatimi i tyre mund të luajë një rol vendimtar në arritjen e paqes së qëndrueshme dhe përmirësimin e sigurisë kombëtare, duke adresuar shkaqet rrënjësore të konfliktit dhe duke promovuar drejtësinë sociale, zhvillimin dhe harmoninë.

Duke pasur parasysh shkëmbimin intelektual midis liderëve të komunitetit në rajon, duket se përvoja unike e malajzianëve në kuptimin e diversitetit, dialogut ndërfaqësor, drejtësisë sociale dhe iniciativave për barazi, përfshirjes politike, demokracisë së udhëzuar dhe kultivimit të arsimit dhe ndërgjegjes kulturore gjithëpërfshirëse ka kontribuar në pasurimin e kornizës së liderëve të komunitetit, ndërsa ata rishikojnë qasjet e kaluara qeveritare për promovimin e përfshirjes dhe respektit të ndërsjellë midis komuniteteve të ndryshme myslimane në Filipine.

Krijimi i qytetarëve që mbajnë parimet e bashkimit kombëtar dhe që udhëhiqen nga mësimet e kulturës dhe traditës së tyre është shqetësimi i çdo mbrojtësi të paqes.

Në çdo komunitet, kontributet e liderëve të tij për historinë, kulturën dhe shoqërinë në përgjithësi duhet të njihen. Si të tillë, ato duhet të konsiderohen si institucione të respektuara kur të arrijnë kualifikimet e nevojshme të udhëheqjes, fuqizohen përmes mekanizmave formalë dhe fitojnë besimin e qeverisë në idetë e tyre. Për më tepër, ata disponojnë autoritetin moral për të kundërshtuar padrejtësinë dhe për të mundësuar pajtimin.

Iniciativat e fundit për zhvillimin e bankave islamike, financës dhe industrisë *hallall* në një shtet sekular kanë tërhequr vëmendjen e politikanëve, duke theksuar rëndësinë e liderëve dhe intelektualëve myslimanë në riformatimin e peizazhit ekonomik të vendit.

Është e rëndësishme të theksohet se janë organizuar disa dialogë ndërfetare dhe ndërkulturore si përgjigje ndaj dështimit të mekanizmave të qeverisë për integrimin kombëtar dhe iniciativat për paqen.

Duke parashikuar pasojat e një koncepti të ngushtë të paqes, si thjesht mungesa e luftës - pavarësisht nëse ajo është mes kombesh, grupeve, apo brenda një vendi - përveç trajtimit të problemeve më të thella të dhunës strukturore, shkeljes së të drejtave të njeriut, shfrytëzimit, marginalizimit dhe përjashtimit politik, ne kemi vërejtur një tendencë të re mendimi mes intelektualëve dhe liderëve të rinj.

Në ndjekjen e një diskursi për paqen dhe fuqizimin që mbështet parimet e civilizimit njerëzor, të cilat i japin merita paqes së qëndrueshme në vend të asaj të përkohshme, ka lindur nevoja që liderët e komunitetit mysliman të avancojnë kuptimin e reformës (*islah*), rinovimit (*texhdid*) dhe rindërtimit (*i'adatu'l-bina*) të dijes dhe shoqërisë bashkëkohore, duke ndjekur botëkuptimin e monoteizmit islam (*tevhid*) dhe mësimet e tij universale dhe koncepteve moderne të paqes.

Besoj se të gjithë e ndajmë mendimin se, përmes një sinergjie kuptimplotë të kulturave të dijes që theksojnë rëndësinë e fesë, pritët që si komunitetet myslimane, ashtu edhe ato jomyslimane në rajon të fuqizohen shpirtërisht dhe intelektualisht për ta kuptuar thelbin e marrëdhënies së tyre me Krijuesin, me bashkëkombësit e tyre, fqinjët, qytetarët e tjerë, të huajt, mjedisin natyror dhe me vetveten.

Ka qenë një sfidë e vërtetë për liderët e komunitetit mysliman dhe intelektualët që të riformulojnë një sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe një set të plotë ligjesh për të drejtuar çështjet e myslimanëve brenda një shteti sekular.

Megjithatë, për shkak të dobësisht të institucioneve islame dhe teprimit të besimit në idetë dhe qasjet sekulare, është shfaqur një vakum intelektual për shumë anëtarë të komunitetit në kërkimin e identitetit të tyre.

Sfida reale për çdo lider dhe intelektual të komunitetit në rajon është të identifikojë karakteristikat kryesore të arsimit

islam dhe sistemeve të dijes që mund të udhëheqë komunitetin global drejt rolit transformues të tij, siç u pa gjatë kulmeve kulturore të civilizimit islam.

Sigurisht, besimi i treguar nga shtetet anëtare të ASEAN në udhëheqjen e Malajzisë si kryetar i ASEAN 2025 mund të lidhet me shumë faktorë, një prej të cilëve është prania e një kulture njohurish që respekton pluralizmin dhe nxit bashkimin brenda diversitetit.

Duke pasur parasysh thellësinë dhe gjerësinë e sekularizmit, veçanërisht pasojat e tij për integrimin kombëtar, do të ishte më strategjike për qeverinë, intelektualët dhe politikanët të përqafojnë një sistem të balancuar drejtësisht që ishte shpërndarë zakonisht nga komunitetet myslimane në rajon para kolonializmit. Sfida reale është si të rishpikim një kulturë alternative të dijes brenda kontekstit të një shteti sekular, që do të ofronte privilegje për politikanët që të akomodojnë kuptimin e vërtetë të integritetit të shpirtit, intelektit dhe trupit përmes arsimit.

Politikat qeveritare të pazgjidhura me mangësitë e brendshme për shkak të paragjytimeve dhe diskriminimeve ndaj pakicave myslimane duhet të trajtohen objektivisht dhe me sinqeritet nga ana e qeverisë dhe komuniteteve myslimane.

Për të trajtuar integrimin social në tërësinë e tij, ne duhet të kemi një njohuri të shëndoshë të natyrës njerëzore, për të cilën perspektiva shariatike është një dimension i rëndësishëm; njohuri për pakicat kulturore dhe zhvillimin e tyre; njohuri për vërtetët e komuniteteve të tyre, dhe njëkohësisht për dobësitë e brendshme që mund të shfrytëzohen dhe korruptohen lehtësisht nga disa individë për qëllime të këqija.

Është e rëndësishme të theksohet se komunitetet myslimane janë në kërkim të vazhdueshëm të modeleve dhe mendimeve zhvillimore. Nëse atyre nuk u ofrohen modele gjithëpërfshirëse dhe perspektiva holistike të jetës, ata do të kërkojnë një model të gabuar dhe një sistem të rremë mendimi.

Në dritën e këtyre vëzhgimeve, të dyja palët, studiuesit dhe politikanët myslimanë dhe jomyslimanë në rajon duhet të përqafojnë një kuptim më të gjerë të integritetit, që mund të rezultojë në funksionimin e një shoqërie të balancuar drejtësisht në kohën dhe hapësirën e caktuar.

Përktheu me shkurtesa: Haki Sahitaj

1 Burimi <https://www.islamiccity.org/103397/can-islam-balance-ethics-and-modern-progress/>

Memetika hajdute e poetit Branko Radiçeviq

• Nexhat Ibrahim

JETA DHE EDUKIMI

Edhe pse në njëfarë mënyre jemi larguar nga serbët dhe politika e tyre e drejtpërdrejtë, megjithatë hija e tyre po na përcjell edhe aktualisht, 2022, në politikë, ekonomi, sport, kulturë etj.. Memeizmi¹ ishte aktiv edhe para 100 vjetësh, edhe tash, sepse ky ves i memeizmit po kalon në gjenetizmin biologjik. “Memot” dhe “gjenet” po përcillen në kulturën



serbe-malazeze, përgjithësisht sllave, ortodokse. Nuk është e rastit që trajtimi i Branko Radiçeviqit bëhet pikërisht në këtë frymë, sepse ai është prodhim i Petar P. Njegoshit, i cili është matrica e urrejtjes, skizofrenisë ndaj gjuhës tjetër, etnisë ndryshe, besimit ndryshe. Por, kush është Branko Radiçeviq?

Branko Radiçeviq lindi në Sllavonski Brod, atëherë në Austro-Hungarinë Habzburgiane, më 28 mars 1824, në familjen e Todor dhe Ruzha Radiçeviq. Emri i tij i lindjes ishte Aleksije, por ai e kishte kthyer atë në Branko. Kishte edhe një vëlla dhe një motër. Familja e tij ishte me prejardhje nga Kragujevci. Babai i Brankos, Todor ishte nëpunës. Por, në kohën e lirë merrej edhe me letërsi dhe përkthente nga gjermanishtja *William Tel*-in e Shilerit. Familja e Brankos në vitin 1830 nga S. Brod u shpërngul në Zemun, ku Branko mbaroi pesë klasë të shkollës fillore serbe dhe gjermane. Ai u regjistrua në shkollën e mesme në Sremski Karlovci në vitin 1836. Sremski Karlovci dhe Strazhillovo aty pranë patën një ndikim të madh në veprat e mëvonshme të Brankos, më të famshmet prej të cilave janë *Đački rastanak*, në të cilat ai shprehu dëshirën për t’u varrosur atje. Pas mbarimit të gjashtë klasave në Sremski Karlovci, ai mbaroi klasën e shtatë dhe të tetë në Timishoara, në Rumani, ku babai i tij u transferua në 1841. Në vitin 1843 u regjistrua në studimet për drejtësi në Vjenë, por pas tri vjetësh studime e la fakultetin. Miqësia e vjetër e Radiçeviqit me Vuk Karaxhiqin ishte rekomandimi më i mirë i Brankos për t’u bashkuar me bashkëpunëtorët dhe miqtë e Vukut. Kur vëllai i tij Stevani ndërroi jetë, Branko u miqësua me një tjetër ndjekës të ri të Vukut, Gjuro Daniçiq.

Branko Radiçeviq ishte një poet romantik serb. Ambicia e tij dhe rrethanat i mundësuan të mësojë gjuhët e huaja si:

gjermanisht, latinisht, greqisht, çekisht dhe sllovakisht. Së bashku me Gjuro Daniçiqin, Radiçeviqi ishte ndjekësi (transferuesi i memeve si gjene) më besnik i reformës së Vuk Karaxhiq në drejtshkrimin e gjuhës serbe dhe futjes së gjuhës popullore në letërsi. Vargjet e para Branko i shkroi kur ishte ende në gjimnazin e Karllovcit dhe i entuziazmuar nga reformat e Vukut, filloi të punonte më intensivisht me veprën letrare. Ai botoi librin e tij të parë me poezi në Vjenë më 1847, në gjuhën e pastër popullore në frymën e poezisë romantike moderne evropiane. Në të njëjtin vit u botua përkthimi i *Dhiatës së Re* nga Vuku, “Lufta për gjuhën dhe drejtshkrimin serb” të Daniçiq dhe “Kurora e maleve” të P. P. Njegosh, kështu që ai vit konsiderohet si viti i fitores jozyrtare të Vukut.

Për shkak të revolucionit që përfshiu monarkinë Habsburge, B. Radiçeviq u largua nga Vjena dhe jetoi në vende të ndryshme në Srem, Vojvodinë. Fama që i sollën këngët e para ishte e madhe edhe në Principatën e Serbisë, ku ai kishte ardhur disa herë. Nga frika se prania e tij do të shkaktonte trazira në mesin e të rinjve të shkollave të mesme, autoritetet e dëbuan atë nga Beogradi. Në atë kohë, ai filloi të vuante nga tuberkulozi. Pas kthimit në Vjenë më 1849, ai u regjistrua në studimet e mjekësisë, por vazhdoi të studionte letërsi dhe në 1851 botoi një përmbledhje tjetër me poezi. Një përmbledhje me poezi të tij u botua gradualisht post-mortum nga babai i tij në 1862.

Branko Radiçeviq vdiq më 1 korrik 1853 në një spital vjenez në duart e vajzës së Vukut, Ana, në moshën 29 vjeçare, nga pasojat e tuberkulozes. Rinia serbe plotësoi dëshirën e poetit dhe më 1883 transferoi eshtrat e tij nga Vjena në Strazhilovo në Sremski Karlovci.

Emri i tij sot përdoret për shumë institucione arsimore e shoqërore, si sheshet në Sremski Karlovci dhe Zemun, shkolla fillore në Vranjë, dhe në Smederevë. Atij iu ngrit një monument në Sllavonski Brod në vitin 1984 dhe dy shkolla në Sllavonski Brod morën emrin e tij. Emrin “Branko Radiçeviq” e mban Biblioteka në Leban, Kori Kishtar në Krushevc, Biblioteka Popullore në Derwentë, Shoqëria Kulturore Artistike në Zemun etj. Shkolla Fillore në Ilixhë të Sarajevës para

Ajo që neve na bie në sy në krijimtarinë e tij poetike është qëndrimi i Branko Radiçeviq ndaj Islamit dhe myslimanëve, sidomos atyre vendorë, duke përdorë shprehjet më të rënda, që kalojnë çdo kufij të lirisë letrare, artistike, dhe kalon në bindje patologjike, skizofrenike dhe për fat të keq, ai mësohet në shkolla, shumë institucione mbajnë emrin e tij dhe letërsia e shkenca serbe mburret me fjalët dhe veprat e tij.

Luftë mbante emrin e Radiçeviqit, kurse tash emrin e tij e mbanë një shkollë në Banja Llukë, kurse poezitë e tij mësohen përmendsh nga periudha e romantizmit. Kur këto poezi arrijnë në veshët e politikanëve dhe skizofrenëve sllavë, këto “meme” pësojnë mutacion dhe fitojmë Millosheviq, Sheshelja, Arkana, Dodika, Vuçiq të rinj.

KRIJIMTARIA

Me Branko Radiçeviqin në letërsinë kombëtare hynë për herë të parë këngët me motive dhe humor të theksuar lirike. Ato këngë kryesisht këndonin për gëzimet dhe bukuritë e rinisë. Mirëpo, shumicën e poezive të tij, si “Kad mlidija ‘umreti’ ose “Đački rastanak”, Radiçeviqi i ka shkruar si elegji (këngë të trishta). Në mes të polemikave të Vukut me kundërshtarët e reformës së gjuhës serbe, përmbledhja e parë e këngëve të Radiçeviqit dëshmoi se këngët artistike mund të këndohen edhe në gjuhën popullore.

Vepra më e njohur e Radiçeviqit është kënga *Đački rastanak*, në të cilën ai këndoi Sremske Karlovce, lojëra studentore dhe ligësi. Në këngë ai ka shprehur edhe idenë e Jugosllavisë. Elegjia “Kur qava (mendova) të vdes”, e botuar pas vdekjes së Radiçeviqit, është një nga elegjitë më të bukura të letërsisë serbe, në të cilën poeti parashikoi vdekjen e afërt.

Krahas këngëve lirike (54 poezi), dashuria e Radiçeviqit për poezinë popullore e shtyu atë të shkruante edhe këngë epike (7 poezi). Dy poema të pjesshme epike u botuan në 1851 si përmbledhja e dytë me poezi. Në koleksionin e vitit 1862 u botuan këngë të tjera të pabotuara. Branko Radiçeviq ishte frymëzuar kryesisht nga kënga popullore me dhjetë këngë dhe në disa vende nga George Bajron, por ai nuk arriti të krijonte vepra më serioze të artit, kështu që puna e tij nuk e përjetoi famën e këngëve të tij lirike.

Si përkrahës i pikëpamjeve të Vuk Karaxhiqit, Radiçeviq shkroi poemën alegoriko-satirike “Put” (*Rruga*), drejtuar kundër poezisë pseudoklasike dhe gjuhës së vjetër letrare. Në pjesën e parë të këngës, Radiçeviq tallet me kundërshtarin më të

madh të Vukut, Jovan Haxhiq, dhe në pjesën e dytë të këngës, lavdërohen reformat e Vuk Karaxhiqit.

BRANKO RADIČEVIQ DHE MYSLIMANËT

Ajo që neve na bie në sy në krijimtarinë e tij poetike është qëndrimi i Branko Radičević ndaj Islamit dhe myslimanëve, sidomos atyre vendorë, duke përdorë shprehjet më të rënda, që kalojnë çdo kufij të lirisë letrare, artistike, dhe kalon në bindje patologjike, skizofrenike dhe për fat të keq, ai mësohet në shkolla, shumë institucione mbajnë emrin e tij dhe letërsia e shkenca serbe mburret me fjalët dhe veprat e tij.

Ai përdhos moralin mysliman duke dhunuar, ai përdhos Librin e shenjtë Kuranin, duke e djegur për të vleruar një kafe, ai nuk pushon së lavdëruari me vrasjet se si do t'i stolis malet me kokat turke, plaçkitjet, torturat kundër myslimanëve (B. Radičević, *Pesme*, fq. 19-22).

Kur lexon njeriu vargjet e Radičevićit, gjaku në damar të ndalet, sepse jemi dëshmitarë të gjallë se këto “meme” u përsëritën në Bosnjë 1992-1995) dhe Kosovë (1998-1999), më e keqja, nxënësit çdo ditë nëpër shkolla, nga çerdhet në Akademi, veprojnë ngjashëm me Vukun, Brankon, Daniçiqin, Njegoshin e tjerë, derisa një ditë nuk shpërthejnë në gjenocidin e ri, sepse siç pamë të gjithë, virusi përgjatë kohës e vendit pëson mutacion, po aq e bile edhe më të dëmshëm se origjinali. Ata bëjnë gjenocidin e ri, pa e pranuar të parin, madje (për të mbuluar dëmet) shndërrohen në viktimë, të cilëve duhet dalë në ndihmë. Kjo ndodh për një arsye madhore, sepse shqiptarët dhe boshnjakët, kanë një të metë të madhe, nuk kanë “kible” autentike, vetjake, por çdo ditë ndërrojnë orientimin sipas tekeve e çastit, pa një program historik, konstruktiv e jo naiv. Harresa dhe naiviteti janë faktorët që e përsërisin fatkeqësinë, i hapin derën gjenocidit të ri, pa vetëdije i shprehin mirëseardhje shfarosjes vetjake.

Në fund, si shembull, do të ofrojmë pjesë nga poezia e tij, duke pasur parasysh mirëkuptimin tuaj se mund të ikë ndonjë gabim në përkthim, për shkak se gjuha e përdorur është tejet e vjetër, popullore, që është përdorë në Mesjetë:

AJDUKU

*Turqit i kemi prerë në Crnicë
dhe qytetin Besac me tokën e rrafshuam.
Për të pastruar tokën nga pakryqi,
Lufta jonë nuk do të ketë fund,
Deri në shfarosjen turke ose tonë.
Pakryqit i vjen erë fortë e keqe,
Hoxha gjëmon në Cetinjen e sheshtë,
Godit për kryqin, për fytyrën heroike,
Të pagëzosh jo me ujë, por me gjak!
Ta zhdukim lebrën nga torishta,*

*Dhe godit atë aq sa mundesh,
E mos të vij keq për asgjë në botë,
Gjithçka shkoi rrugës së djallit,
Kundërmon toka me Muhamed.*

.....
*Ai nuk kursen gjakun turk,
Kur shikoj bastardin turk,
Kur ta rruaj kokë qenin turk,
Dhe në kunj kur ta vendos,
Malin e stolis me koka turke,
O lumturi e mrekullueshme ajduki!
Pritë aga, çfarë takse,
Për t'i mposhtur kullat e bardh tua,
Ta vizitoj një ëndërr të lehtë,
Pranë bullës tënde besnike,
Lullën tënde, aga, ta pijë,
E me Kuran kafënë ta ngroh.*

Literatura:

- Branko Radičević, *Pesme*, në: *Antologija narodne književnosti*, 2009, fq. 19-22.
- Dragutin A. Stefanović, *Pregled jugoslovenske književnosti*, Zavod za izdavanje udžbenika, Beograd, 1962.
- Jovan Deretić, *Kratka istorija srpske književnosti*, Beograd, 1983, fq. 66-80.
- Michael Sells, *Christ Killer; Contagion Kremlin*, në: Michael Sells and Emran Qureshi (ed.), *The New Crusades: Constructing the Muslim Enemy*, New York, Columbia University Press, 2003, fq. 336-371.
- Mustafa Cerić, *(H)Ajdučka memetika, kao biološka genetika*, në: <http://www.bosnjaci.net/print.php?pid=66608>.
- Scott Davis (ed.), *Religion and Justice in the War over Bosnia*, Routledge, New York 1997, fq. 23-43.

1 Meme është një term që tregon një njësi informacioni kulturor, si një praktikë ose ide kulturore, që transmetohet me gojë ose duke përsëritur një veprim nga një mendje në tjetrën. Fjala është një shkurtime i fjalës mimeme (nga fjala greke mimēma që do të thotë diçka që imitohet). Krijuesi i fjalës, teoricieni i evolucionit Richard Dawkins, donte që fjala të kujtonte fjalën angleze gene (gjen), prandaj e shkurttoi atë. Ideja e tij ishte të krijonte një shprehje që do të nënkuptonte idenë e riprodhimit, veçanërisht në konotacionin që meme parazitizon te njerëzit duke i detyruar ata ta përhapin atë, siç bëjnë viruset. Memet mund të konsiderohen njësi të evolucionit kulturor. Idetë mund të evoluojnë në një mënyrë që është analoge me evolucionin biologjik. Disa ide mbijetojnë më mirë se sa të tjerat; idetë mund të ndryshojnë, për shembull, nëpërmjet keqkuptimeve; të dy idetë mund të bashkohen për të prodhuar një ide të re që përfshin elemente të të dy ideve prindërore. Shiko: Richard Dawkins, *The Selfish Gene*, botimi 2, Oxford University Press, 1989, fq. 186; „meme”, në: *The American Heritage® Dictionary of the English Language*, 4th ed., Dictionary.com.

VIZITA E REISIT TË BASHKËSISË ISLAME TË BOSNJE DHE HERCEGOVINËS, DR. HUSEIN EF. KAVAZOVIQ NË KOSOVË

Reisi i Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës, dr. Husein ef. Kavazović, më 9 dhe 10 prill 2025, zhvilloi një vizitë dy ditore në Kosovë.

PRITJA NGA MYFTIU I KOSOVËS, NAIM EF. TËRNAVA

e ruajtjes së kujtesës historike, duke rikujtuar të kaluarën e dhimbshme të përbashkët të të dy popujve.

“Bashkësia Islame e Kosovës është e gatshme për një bashkëpunim vëllazëror me Bashkësinë Islame të Bosnjës, ngase kemi shumë gjërat të cilat ne na bashkojnë nga e kaluara, siç është tra-

“Me lejen e Zotit, do ta vizitojmë Bosnjën në të ardhmen e afërt dhe do të njihemi më afër me zhvillimet e përgjithshme që janë në Bosnjë. Sigurisht, ajo që na ka bashkuar dhe na bashkon është edhe komuniteti i shqiptarëve që jetojnë në Bosnjë, dhe komuniteti i boshnjakëve që jetojnë në Kosovë. Këto minoritete shërbejnë si ura lidhëse mes dy kombeve dhe dy shteteve, që duhet t'i respektojmë.”

Ndërkohë, reisi i Bosnjës, dr. Husein ef. Kavazović, theksoi rëndësinë e lidhjeve të forta fetare, kulturore dhe vëllazërore mes dy vendeve:

“Ne besojmë se angazhimi ynë për ta ndërtuar këtë shtëpi së bashku në Ballkan është ajo që na obligon, pra t'i përkushtohemi qëllimeve të përbashkëta, dhe ky është gjithmonë qëllimi më i rëndësishëm për ne myslimanët, të bëjmë thirrje për të mirë dhe të largojmë nga ajo që është e keqe. Jemi veçanërisht të kënaqur me mikpritjen që na është bërë dhe me përkushtimin që kemi parë nga Myftiu Tërnavë dhe bashkëpunëtorët e tij për ruajtjen e vlerave tona të përbashkëta islame” – tha reisi Kavazović.

Ai theksoi se është arritur të rinovohet ajo që ishte shkatërruar dhe shkatërruar. “Natyrisht, kemi arritur të shërojmë plagët në popullin tonë, krimet e tmerrshme, krimin e gjenocidit që është kryer këtu dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe sot këto dy bashkësi ofrojnë duar pajtimi dhe lutën për paqe në këto hapësira dhe punojnë për paqe.”



Më 9 prill 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka mirëpritur në takim reisin e Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës, dr. Husein ef. Kavazovićin, i cili shoqërohej nga bashkëpunëtorët e tij.

Gjatë këtij takimi, të dy liderët fetarë shprehën gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme, me theks të veçantë në mbarëvajtjen e jetës fetare dhe në fushën e arsimit islam. Myftiu Tërnavë theksoi rëndësinë

shëgimie e përbashkët, një trashëgimi që e kemi pasur të përbashkët në të kaluarën islame fetare, e cila, fatkeqësisht në përmasa të mëdha është shkatërruar nga armiku i përbashkët i Bosnjës dhe i Kosovës nga ana e Serbisë, dhe në këtë fushë – segment ka shumë çka të flitet, pastaj një bashkëpunim në mes të institucioneve tona, siç janë medresetë, instituti etj.” – deklaroi ai.

Myftiu Tërnavë me këtë rast shprehu edhe gatishmërinë e tij që në një të ardhme ta vizitojë shtetin e Bosnjës.



PRITJA NGA KRYEMINISTRI I KOSOVËS, Z. ALBIN KURTI

Gjatë vizitës së tij zyrtare në Kosovë, reisi i Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës, dr. Husein ef. Kavazoviq, i shoqëruar edhe nga Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, është pritur në takim nga kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti.

Gjatë këtij takimi u diskutua për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Bosnje dhe Hercegovinës në fushën e jetës fetare dhe shoqërore.

Të dyja palët theksuan rëndësinë e ruajtjes së lirisë fetare për ndërtimin e një shoqërie me të mirë dhe më të konsoliduar.



VIZITA E XHAMIVE MONUMENTALE TË PRISHTINËS

Reisi i Bosnje dhe Hercegovinës, dr. Husein ef. Kavazoviq, i shoqëruar edhe nga Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, gjatë vizitës së tij zyrtare në Prishtinë, vizitoi pasdite tri xhamitë monumentale të Prishtinës, Xhaminë e Çarshisë, Xhaminë “Jashar Pasha” dhe Xhaminë “Sulltan Mehmet Fatih”.

Gjatë qëndrimit në këto xhami, reisi Kavazoviq, ka theksuar rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe historike, duke potencuar se këto objekte fetare, jo vetëm që janë vende të adhurimit, por janë edhe simbole të bashkëjetesës dhe unitetit. Ai i ka cilësuar këto xhami si simbole të përpjekjeve të vazhdueshme për t'i



ruajtur vlerat fetare dhe kulturore të myslimanëve të Kosovës.

Vizita e reisit Kavazoviq në këto xhami ka theksuar edhe njëherë rëndësinë e

bashkëpunimit dhe mirëkuptimit, duke hapur kështu një mundësi të re për forcimin e lidhjeve ndërmjet bashkësive islame të Kosovës dhe Bosnjës.

VIZITA NË KOMPLEKSIN MEMORIAL NË PREKAZ



Në ditën e dytë të qëndrimit në Kosovë, reisi i Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës, dr. Husein ef. Kavazoviq, i shoqëruar nga Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, vizitoi Kompleksin Memorial në Prekaz.

Ata, para varreve të familjes Jashari, kënduan nga një Fatiha dhe bënë lutje për shpirtat e dëshmorëve.

Prekazi dhe heroizmi i familjes Jashari u vlerësua jashtëzakonisht shumë nga reisi Husein ef. Kavazoviq, duke e



cilësuar kështu Prekazin si një vend të sakrificës dhe krenarisë.


Reisi i Bosnjës, dr. Husein ef. Kavazoviq, tha se populli i Kosovës dhe ai i Bosnjës ndajnë një histori të përbashkët dhimbjeje dhe sakrifice, por edhe një qëndresë të fortë për dinjitet, drejtësi dhe liri, andaj themi se Prekazi është një vend i heroizmit, jo vetëm për Kosovën, por për gjithë ata që respektojnë sakrificën për të ardhmen.

VIZITA NË QYTETIN E PRIZRENIT

Reisi i Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës, dr. Husein ef. Kavazoviq, i shoqëruar nga Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, qëndrimin e tij në Kosovë e përmbylli me vizitën në qytetin e Prizrenit.

Vizita filloi me një takim në Këshillin e Bashkësisë Islame të Prizrenit, ku delegacionin e priti kryetari i këtij Këshilli, Valon ef. Ibrahim. Në takim u diskutua për rolin e Prizrenit si qendër e rëndësishme fetare dhe historike, si dhe për bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve islame në rajon.

Në vijim, reisi Kavazoviq dhe Myftiu Tërnavë u takuan me imamët boshnjakë që veprojnë në Kosovë. Gjatë takimit, u trajtuan çështje që lidhen me sfidat dhe angazhimet e tyre në misionin fetar, përkushtimin ndaj shërbimit ndaj besimtarëve dhe rolin e



tyre në ruajtjen e harmonisë ndëretnike dhe ndërfetare.

Duke iu drejtuar imamëve, reisi Kavazoviq theksoi rëndësinë e unitetit dhe bashkëpunimit në kuadër të institucioneve përkatëse, duke përçar një mesazh të qartë për respektimin e Bashkësisë Islame të Kosovës si autoriteti zyrtar fetar në vend.

“Është me rëndësi që të jeni të bashkuar, të qëndroni pranë njëri-tjetrit dhe të kontribuoni në ruajtjen e harmonisë fetare në Kosovë. Bashkësia Islame e Kosovës është institucioni juaj dhe mbështetja ndaj saj është e domosdoshme për punën tuaj dhe për mbarëvajtjen e jetës fetare,” theksoi reisi Kavazoviq.

Pas takimeve, delegacioni vizitoi xhaminë “Sinan Pasha” në Prizren, ku reisi iu priu besimtarëve në namazin e drekës. Më pas, reisi Kavazoviq mbajti një ligjëratë të shkurtër para besimtarëve, ku falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, duke shprehur kështu gatishmërinë e tij për një bashkëpunim edhe më të madh në të ardhmen. Ai edhe njëherë i bëri ftesë zyrtare Myftiut Tërnavë që të vizitojë shtetin e Bosnjës, për të forcuar kështu edhe më shumë bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve.



MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA KRYETARI I AUTORITETIT TË PËRGJITHSHËM PËR ÇËSHTJET ISLAME, FONDET DHE ZEKATIT TË EBA-SË, DR. OMAR HABTOOR AL DAREI

Më 29 prill 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, qëndroi për vizitë zyrtare në Emiratet e Bashkuara Arabe, ku gjatë kësaj dite u prit në takim nga kryetari i Autoritetit të Përgjithshëm për Çështjet Islame, Fondet dhe Zekatin të Emirateve të Bashkuara Arabe, dr. Omar Habtoor al Darei.

Takimi u zhvillua në një atmosferë vëllazërore dhe miqësore, ku u diskutua për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe institucioneve përkatëse të Emirateve të Bashkuara Arabe në fusha të ndryshme, si edukimi fetar, ndihma humanitare dhe projektet sociale. U theksua rëndësia e shkëmbimit të përvojave institucionale dhe e mbështetjes së iniciativave që forcojnë rolin e fesë në ndërtimin e paqes, solidaritetit dhe zhvillimit shoqëror.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E FUSHË KOSOVËS, Z. BURIM BERISHA

Më 25 prill 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim kryetarin e Fushë Kosovës, z. Burim Berisha.

Gjatë takimit u diskutua për hapat konkretë në drejtim të zhvillimit dhe bashkëfinancimit të disa projekteve të përbashkëta për qytetarët e Fushë Kosovës, përfshirë ndërtimin e një shkolle të re në fshatin Lismir, xhamisë në Bresje dhe hapjen e një njësie në qytet për ofrimin e ushqimit dhe ndihmave për familjet në nevojë, e cila do të funksionojë në baza ditore.

Projektet do të shtrihen edhe në fushën e ambientit, përfshirë zonat e



fshatrave Lismir, Kuzmin dhe lagjet 028 e 029 të qytetit.

Ky bashkëpunim tregon se veprimi i përbashkët sjell projekte konkrete në

dobi të qytetarëve. Të dyja palët shprehën gatishmëri për vazhdimin e bashkëpunimit, në funksion të përmirësimit të jetës dhe zhvillimit të qëndrueshëm për komunitetin.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI QYTETIN E PODUJEVËS

Më 12 prill 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi qytetin e Podujevës për të parë nga afër ecurinë e punimeve në ndërtimin e Xhamisë së re të Merqezi.

Gjatë vizitës, Myftiu Tërnavë, shprehu kënaqësinë e tij për përparimin e deritanishëm të punimeve dhe vlerësoi angazhimin e të gjithë atyre që janë duke kontribuar në këtë projekt me rëndësi të madhe për komunitetin



lokal. Ai theksoi se ndërtimi i kësaj xhamie do t'i plotësojë nevojat e besimtarëve të kësaj ane për një hapësirë të përshtatshme për falje, edukim dhe aktivitete fetare.

Ai gjithashtu falënderoi donatorët që po kontribuojnë në ndërtimin e kësaj xhamie.

Myftiu Tërnavë më pas vazhdoi vizitën në objektin e hifzit, i cili është duke u ndërtuar në lagjen e Kuvajtit në Podujevë. Aty pa nga afër ecurinë e punimeve që po bëhen, teksa më pas pati një bashkëbisedim të hapur dhe vëllazëror me xhematin e xhamisë së lagjes së Kuvajtit në fshatin Ballovc, ku diskutuan për çështje të jetës fetare dhe sfidat e përditshme të besimtarëve.

Vizitën më pas Myftiu Tërnavë e vazhdoi në Xhaminë e fshatit Llugë.

Myftiu Tërnavë u zotua se Bashkësia Islame e Kosovës do të vazhdojë të mbështesë projektet që ndihmojnë për përmirësimin e infrastrukturës fetare dhe forcimin e jetës shpirtërore të besimtarëve në mbarë vendin.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DREJTORIN E NJËSISË PËR MONITORIMIN E NDËRMARRJEVE PUBLIKE, Z. VALON PREBREZA

Më 14 prill 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka prituri në takim drejtorin e Njesisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, z. Valon Prebreza, me të cilin diskutuan për bashkëpunimin ndërinstitucional, me theks të veçantë për projektet që janë duke u realizuar në komunën e Fushë Kosovës.

Të dy palët shprehën vullnetin për bashkëpunim të vazhdueshëm në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe fuqizimit të iniciativave që sjellin zhvillim dhe mirëqenie për të gjithë.



Myftiu Tërnavë falënderoi z. Prebreza për vizitën dhe angazhimin e tij në çështjet me rëndësi publike, teksa drejtori Prebreza vlerësoi rolin e

Bashkësisë Islame të Kosovës në ruajtjen e vlerave shoqërore dhe ndërtimin e dialogut ndërinstitucional.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM IMAMIN TAHIR EF. KUKAJ

Më 15 prill 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka prituri në takim imamin e njohur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Tahir ef. Kukaj, i cili shoqërohej nga sekretari i Qendrës Shqiptare Islame Kulturore në Nju Jork, z. Ferid ef. Bedrolli.

Gjatë këtij takimi u diskutua për organizimin fetar të komunitetit shqiptar në diasporë, me theks të veçantë për ruajtjen e identitetit fetar dhe kombëtar ndër breza, në veçanti në një realitet si ai amerikan, ku ndikimet e ndryshme kulturore dhe sociale janë të shumta dhe të fuqishme.

Myftiu Tërnavë vlerësoi lart kontributin e imamëve në mërgatë, duke theksuar se puna e tyre për ruajtjen e vlerave islame dhe shqiptare në një mjedis multikulturor si ShBA-ja është jo vetëm



e nevojshme, por edhe e lavdërueshme dhe e domosdoshme. Ai theksoi rëndësinë që kanë institucionet fetare në diasporë si pika referimi për bashkimin shpirtëror dhe kulturor të shqiptarëve jashtë vendit, dhe rolin që ato luajnë në edukimin dhe udhëzimin e gjeneratave të reja.

Nga ana e tij, imami Kukaj shprehu mirënjohjen e tij për mikpritjen dhe mbështetjen që Bashkësia Islame e

Kosovës u jep komuniteteve shqiptare jashtë vendit, duke theksuar se kjo lidhje institucionale dhe shpirtërore ndihmon në forcimin e unitetit kombëtar. Ai ritheksoi gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit me institucionet fetare në Kosovë përmes projekteve të përbashkëta në fushën e arsimit fetar, kulturës islame dhe aktiviteteve të përbashkëta që forcojnë lidhjen me atdheun.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETAREN E KOMITETIT PARALIMPIK TË KOSOVËS, ZNJ. NJOMZA EMINI

Më 17 prill 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetaren e Komitetit Paralimpik të Kosovës, znj. Njomza Eminin, e cila shoqërohej nga zëvendëspresidenti, z. Daut Tishuki.

Gjatë këtij takimi, u diskutua për rolin e Komitetit Paralimpik të Kosovës në mbështetjen dhe fuqizimin e sportistëve me aftësi të kufizuara, si dhe për rëndësinë që ka përfshirja dhe barazia në sport dhe shoqëri në përgjithësi.

Myftiu Tërnavë shprehu vlerësimin e tij të lartë për punën dhe përkushtimin e Komitetit Paralimpik, duke theksuar se Bashkësia Islame e Kosovës gjithmonë mbështet dhe inkurajon iniciativat që synojnë avancimin e të drejtave dhe dinjitetit të çdo qytetari, pa dallim.



Znj. Emini e informoi Myftiun Tërnavë për pjesëmarrjen e sportistëve paralimpikë nga Kosova në Lojërat Paralimpike “Paris 2024”, si dhe për sfidat dhe të arriturat e deritanishme të Komitetit.

Në përfundim të takimit, të dy palët u pajtuan për rëndësinë e bashkëpunimit institucional dhe u shprehën të gatshëm për të kontribuar në ngritjen e vetëdijes shoqërore dhe përkrahjen e vazhdueshme të sportistëve me aftësi të kufizuara.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DREJTORIN E DREJTORISË PËR MEDIA, Z. ABDULLAH YATEM ALANZ

Më 18 prill 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim drejtorin e Drejtorisë për Media, njëherësh zëdhënësin e Ministrisë së Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite, z. Abdullah Yatem Alanzi.

Gjatë këtij takimi u diskutua për organizimin e Garave Ndërkombëtare të Kuranit, të cilat do të mbahen në Republikën e Kosovës nga data 8 deri më 12 maj 2025. Në kuadër të bisedës u trajtua edhe realizimi i ekspozitës “Urat”, që për qëllim ka shpalosjen e kulturës dhe traditës arabe në vendin tonë.

Pjesë e diskutimit ishte edhe vizita e imamit të Qabesë në Kosovë, e cila vjen në kuadër të bashkëpunimit të mirë që



ka institucioni i Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Ministria e Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite.

Myftiu Tërnavë shprehu mirënjohje për përkrahjen e vazhdueshme të Mbretërisë së Arabisë Saudite në përpjekjet

për zhvillimin dhe avancimin e jetës fetare në Kosovë, duke vlerësuar lart gatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjellë në projekte me interes të përbashkët.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NËNKRYETARIN E XHAMISË “NURUL ISLAM”, Z. DUGAXHIN SHAMOLLI

Më 24 prill 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim nënkryetarin e Kryesisë së Xhamisë “Nurul Islam” në Monchegladbah të Gjermanisë, z. Dugaxhin Shamollin, i cili

shoqërohej nga sekretari i Këshillit të BI-së së Drenasit, Eset ef. Bajraktari.

Myftiu Tërnavë në këtë takim shprehu falënderime për veprimtarinë e anëtarëve të këtyre xhamive, por edhe të gjithë mërgatës sonë në diasporë për

punën dhe angazhimin e tyre që jeta fetare atje të zhvillohet ashtu siç është më së miri. Ai shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit të BIK-ut për bashkëpunim dhe për koordinim sa më të mirë të aktiviteteve edukativo-fetare.

Nga ana e tij, z. Shamolli falënderoi për zemërsisht Bashkësinë Islame të Kosovës dhe Drejtorinë e Diasporës për mikpritjen dhe gatishmërinë e tyre që të ketë një bashkëpunim sa më të mirë për të gjithë.

Në fund të këtij takimi, z. Shamolli, dorëzoi vitrat dhe zekatin e mbledhur nga mërgimtarët e xhamisë së tyre, për çka drejtori i Diasporës, Ekrem ef. Simnica, ndau një falënderim për kontributin e dhënë.



MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË KONFERENCËN E KËSHILLIT BOTËROR PËR SHOQËRITË MYSLIMANE

Më 30 prill 2025, me ftesë të Këshillit Botëror për Shoqëritë Myslimane, në Abu Dabi të Emirateve të Bashkuara Arabe, u mbajt Konferenca dy ditore me kryetarët e bashkësive islame të Ballkanit.

Pjesëmarrës në këtë Konferencë qe edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili shoqërohej nga shefi i kabinetit të tij, mr. Besim ef. Mehmeti.

Në këtë Konferencë u diskutuan tematika të ndryshme në dobi të shoqërive që jetojnë në shtetet e tyre, me theks të veçantë për vazhdimësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë mes Bashkësive Islame.



Palët pjesëmarrëse në këtë Konferencë, ranë dakord që të vazhdojnë përkushtimin e tyre në përhapjen e vlerave

të tolerancës, paqes, harmonisë, bashkëjetesës, dialogut dhe shtetndërtimit nëpër vendet e tyre.

U MBAJT PROVIMI VLERËSUES I KANDIDATËVE PËR PËRFAQËSIM NË GARAT NDËRKOMBËTARE TË KURANIT

Më 15 prill 2025, në ambientet e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, u mbajt provimi i kandidatëve për përfaqësim në Garat Ndërkombëtare të Kuranit.

bëtare të Kuranit, të cilat do të mbahen në Kosovë, në fillim të muajit maj.

Komisioni vlerësues i përbërë nga kryeimami i Bashkësisë Islame të

Kosovës, Vedat ef. Sahiti, hafëz Safet ef. Hoxha, hafëz Bali ef. Sadiku, si dhe zëvendëskryeimami Fatmir ef. Iljazi, vlerësuan aftësitë e kandidatëve në lexim dhe memorizim të pjesëve nga Kurani famëlartë.

Në këtë vlerësim morën pjesë gjithsej 100 kandidatë, teksa 41 prej tyre kaluan me sukses provimin dhe do të marrin pjesë në Garat Ndërkombëtare.

Këto gara do të mbahen nga data 8 deri më 12 maj në Kosovë dhe në to do të marrin pjesë përafërsisht rreth 200 garues nga vende të ndryshme të botës.



KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM SHEFEN E ZYRËS SË UNFPA-SË, ZNJ. VISARE MUJKO-NIMANI

Më 9 prill 2025, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, z. Vedat Sahiti, priti në takim shefen e Zyrës së UNFPA-së, znj. Visare Mujko-Nimani, me të cilën diskutuan për projektet vetëdijesuese që trajtojnë çështje shoqërore si dhuna me bazë gjinore, kanceri i gjirit dhe kujdesi për të moshuarit.

Kryeimami Sahiti theksoi rëndësinë e përfshirjes së komunitetit në luftimin e dhunës dhe promovimin e barazisë gjinore, duke theksuar përkushtimin e Bashkësisë Islame për të mbështetur nisma që garantojnë respekt për të gjithë.



Gjithashtu u diskutua fushata për vetëdijësimin kundër kancerit të gjirit, me theks te diagnostikimi i hershëm dhe edukimi shëndetësor, si dhe

rëndësia e mbështetjes për moshat e shtyra dhe krijimi i kushteve dinjitoze për jetesën e tyre.

KRYEIMAMI SAHITI TAKOI KËSHILLTAREN VENDORE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, ZNJ. VALBONA DËRMAKU

Më 15 prill 2025, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka pritur në takim znj. Valbona Dërmaku, këshilltare vendore për të Drejtat e Njeriut dhe bartëse e programit për dialog ndërfaqetarak pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë, e shoqëruar nga z. Alev Nuş nga Qendra Rajonale e Prishtinës.

Gjatë takimit u shkëmbyen ide dhe u diskutua mbi planin e bashkëpunimit për vitin 2025, me fokus në dialogun ndërfaqetarak, fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri dhe angazhimin e të rinjve në aktivitete me karakter edukativ dhe ndërfaqetarak.



Kryeimami Sahiti theksoi gatishmërinë dhe përkushtimin e Bashkësisë Islame të Kosovës për të bashkëpunuar ngushtë

me OSBE-në në promovimin e vlerave të përbashkëta, mirëkuptimit dhe tolerancës ndërfaqetare.

DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM IMAMIN HEKURAN EF. HELSHANI

Më 9 prill 2025, drejtori i Diasporës në Bashkësinë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, ka pritur në takim imamin e xhamisë “Diaspora” në Osnabrück të Gjermanisë, Hekuran ef. Helshanin.

Gjatë këtij takimi, drejtori Simnica, fillimisht e njohu imamin Helshani me aktivitetet dhe projektet që zhvillon Bashkësia Islame e Kosovës, më konkretisht Drejtoria e Diasporës. Ai tha se si Drejtori mbështet të përkushtuar për të thelluar angazhimin



në mbështetje të diasporës kosovare. Drejtori Simnica shprehu gatishmërinë për të mbështetur çdo iniciativë që ka si synim përmirësimin e kushteve dhe promovimin e vlerave islame mes diasporës.

Imami Helshani e falënderoi drejtorin Simnica për mbështetjen dhe shprehu dëshirën për të zhvilluar më tej bashkëpunimin me BIK-un, duke organizuar aktivitete të përbashkëta që do të ndihmojnë në forcimin e lidhjeve fetare

dhe kulturore mes Kosovës dhe diasporës.

Në fund të takimit, drejtori Simnica ndau një falënderim për xhaminë "Diaspora" për dorëzimin e mjeteve të sadakatul fitrit në Bashkësinë Islame të Kosovës.

DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM IMAMËT BURHAN MUSTAFA DHE ILIR IMERI

Më 18 prill 2025, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, ka pritur në takime të ndara imamën e xhamisë "Dituria" në Landskrona të Suedisë, Burhan ef. Mustafën dhe Ilir ef. Imerin nga xhamia shqiptare në Dusseldorf të Gjermanisë.

Gjatë këtyre takimeve u bisedua për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe qendrave dhe xhamive shqiptare në diasporë.

Drejtori Simnica me këtë rast falënderoi imamët për përkushtimin e tyre të treguar, duke shprehur kështu gatishmërinë për të mbështetur çdo iniciativë që ka si synim përmirësimin e kushteve dhe promovimin e vlerave islame në diasporës. Ai me këtë rast falënderoi imamët dhe qendrat e tyre për mbledhjen dhe dorëzimin e mjeteve financiare në emër të sadakatul fitrit për institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës.



DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM IMAMIN E XHAMISË "BESIMTARI", BUNJAMIN EF. AZIZIN



Më 22 prill 2025, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica,

priti në takim imamin e xhamisë "Besimtari" në Basel, Bunjamin ef. Azizi. Ata diskutuan për ruajtjen e

gjuhës, identitetit dhe vlerave fetare e kulturore në diasporë, me theks te edukimi i brezave të rinj. Drejtori Simnica vlerësoi rolin e imam Azizit dhe kontributin e xhamisë në jetën e komunitetit shqiptar në Zvicër.

Imami Azizi falënderoi për pritjen dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejshëm. Në fund, Simnica i dorëzoi atij një fletë falënderimi për kontributin e xhamisë në mbledhjen e sadakatul fitrit nga besimtarët në diasporë.

DREJTORI ROGOVA MBAJTI LIGJËRATË PARA STUDENTËVE TË FAKULTETIT EKONOMIK TË UP-SË

Më 22 prill 2025, drejtori i Financave në Bashkësinë Islame të Kosovës, z. Tanseli Rogova, para studentëve të Fakultetit Ekonomik, mbajti ligjëratën me temën: “Menaxhimi financiar në BIK: midis besimit publik dhe efikasitetit organizativ”.

Ligjëratë u fokusua në rolin kompleks të menaxhimit financiar brenda një institucioni me rëndësi të veçantë publike dhe shpirtërore siç është Bashkësia Islame e Kosovës.

Drejtori Rogova ndau me studentët përvojat praktike nga puna e tij në menaxhimin e burimeve financiare, sfidat e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe balancimin e efikasitetit organizativ me ruajtjen e besimit të komunitetit.

“Institucionet fetare sot përballen me nevojën për të qenë njëkohësisht të përgjegjshme, efikase dhe të hapura ndaj qytetarëve. Menaxhimi financiar në këtë kontekst kërkon jo vetëm njohuri profesionale, por edhe ndjeshmëri të



lartë etike dhe shoqërore,” u shpreh ndër të tjera z. Rogova gjatë ligjëratës.

Studentët e Fakultetit Ekonomik patën rastin të diskutojnë rreth praktikave të menaxhimit financiar në sektorin jo-fitimprurës, të mësojnë më shumë për strukturën organizative të Bashkësisë Islame, si dhe të bëjnë pyetje rreth sfidave dhe zgjidhjeve konkrete që ka përballuar institucioni në vite.

Në fund të ligjëratës, dekani i Fakultetit Ekonomik, prof. dr. Driton Balaj dhe prof. Liridon Veliu, falënderuan z. Rogova për ndarjen e përvojës së tij dhe theksoi se përfshirja e profesionistëve të tillë në aktivitetet akademike është thelbësore për përgatitjen e studentëve me njohuri të aplikuara dhe për kuptimin më të mirë të realitetit ekonomik në vend.

U HAP EKSPOZITA E ORGANIZUAR NGA SHOQATA HUMANITARE BAMIRËSE “BEREQETI”




Më 28 prill 2025, në ambientet e Fakultetit të Studimeve Islame u hap ekspozita e organizuar nga Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, me synim promovimin e veprimtarive bamirëse të saj ndër vite.

Në fjalën përshëndetëse, përgjegjësi i shoqatës, z. Xheladin Fazliu, theksoi rëndësinë e bamirësisë dhe u shpreh se ekspozita shërben si një urë lidhëse me përfituesit e ndihmës. Ai bëri të ditur se ekspozita do të vazhdojë edhe në

Medresenë “Alauddin” në Prishtinë, si dhe në paralelet e saj në Gjilan dhe Prizren.

Sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, prof. Ahmet ef. Sadriu, vlerësoi punën e shoqatës, duke e përgëzuar për përkushtimin dhe gatishmërinë për t'i ndihmuar ata që kanë më shumë nevojë. Ai tha se “Bereqeti” është shembull i solidaritetit dhe se Kryesia mbështet çdo nismë që synon përmirësimin e jetës së njerëzve në nevojë.

Ekspozita pasqyron përpjekjet dhe sakrificat e shoqatës për të sjellë ndryshim në jetën e nevojtarëve. Në hapje morën pjesë edhe ish-përgjegjësit e shoqatës, Behxhet ef. Ajvazi dhe Fitim ef. Flugaj.



**KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS
MEDRESEJA E MESME “ALAUDDIN” PRISHTINË**



KURBANJI 2025



180€

Porositë mund t'i bëni:

1. Në: Këshillat e Bashkësisë Islame
2. Bashkësia Islame e Kosovës
3. www.bislame.com

NLB Banka: IBAN XK05 1700200100103672 | SWIFT: NLPRXKPR

DITURIA ISLAME • Nr. 414 MAJ 2025